



Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti

**NJE VESHTRIM
HISTORIK
MBI ZHVILLIMIN E
FILANTROPISE NE
SHQIPERI**



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World



Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti

NJE VESHTRIM HISTORIK MBI ZHVILLIMIN E FILANTROPISE NE SHQIPERI

Punoi: Ma. Artan Hoxha

Asistoi: Ariola Agolli
Juliana Hoxha
Kostandina Keruti

Redaktor shkencor: Prof. Arben Puto
Reçensentë: Prof. Dr. Romeo Gurakuqi
Dr. Ermal Baze

Tiranë, 2011

Një vështrim historik mbi zhvillimin e filantropisë në Shqipëri

Ma. Artan Hoxha në bashkëpunim me Partnerët Shqipëri

Redaktor shkencor: Prof. Arben Puto

Reçensentë: Prof. Dr. Romeo Gurakuqi, Dr. Ermal Baze

Partnerët Shqipëri ruan të gjitha të drejtat e autorit në lidhje me këtë publikim.

ISBN 978-9928-4025-7-8

Të drejtat e Autorit © 2011 Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti

Rruga: “Muhamet Gjollesha”, Pall. 16/1, Hyrja 1, Ap.9, Tiranë

Kutia Postare 2418/1

Tel: +355 4 2254881

Faks: +355 4 2254883

E-mail: partners@partnersalbania.org

Website: www.partnersalbania.org

Studimi u mundësua falë mbështetjes së Fondit Rockefeller Brothers.

Opinionet e shprehura në studim nuk reflektojnë domosdoshmërisht këndvështrimin e Fondit Rockefeller Brothers.

Materiali në këtë botim është i mbrojtur nga të Drejtat e Autorit. Kopjimi dhe ose transmetimi i plotë ose i pjesshëm i këtij botimi mund të përbëjnë shkelje të ligjeve në fuqi.

Partnerët Shqipëri përkrah përhapjen e këtij publikimi dhe lejon për përdoruesit e këtij botimi, kopjimin e pjesshëm të tij për përdorim personal, por jo përdorimin tregtar, rishitjen, rishpërndarjen, ose rikrijimet nga ky material. Çdo kopjim ose përdorim tjetër i këtij botimi kërkon lejen paraprake me shkrim të Partnerëve Shqipëri.

Realizimi grafik: Creative Plus

PARATHENIE DHE MIRENJOHJE.....	V
HYRJE.....	1
I. FILANTROPIA DHE BAMIREsia NE SHQIPERI GJATE SHEKULLIT XIX DERI NE VITIN 1920	5
1.1 Faktori krahinor dhe gjeografik.....	11
1.2 Faktori klasor-shoqëror.....	13
1.3 Faktori fetar.....	17
1.4 Filantropë dhe bamirës të shquar.....	19
1.4.1 Krahina e Gjirokastrës.....	19
1.4.2 Krahina e Përmetit.....	22
1.4.3 Krahina e Korçës.....	24
1.4.4 Krahina e Vlorës.....	29
1.4.5 Krahina e Beratit.....	33
1.4.6 Krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe Qendrore.....	34
1.5 Shoqata bamirëse dhe filantropike.....	38
1.5.1 Shoqëri të themeluara në trevat shqiptare.....	39
1.5.1.1 Shoqëri të themeluara në Korçë.....	39
1.5.1.2 Shoqëri të themeluara në Përmet.....	42
1.5.1.3 Shoqëri bamirëse në Gjirokastrë.....	42
1.5.1.4 Shoqëri të themeluara në Vlorë.....	42
1.5.1.5 Shoqëri mirëbërëse të themeluara në Shkodër.....	43
1.5.2 Shoqëri të themeluara në diasporë.....	44
1.5.2.1 Shoqëri të themeluara në Rumani.....	44
1.5.2.2 Shoqëri bamirëse të themeluara në Bullgari.....	47
1.5.2.3 Shoqëritë mirëbërëse të themeluara në Evropën Perëndimore.....	47
1.5.2.4 Shoqëritë mirëbërëse të themeluara në Perandorinë Osmane.....	48
1.5.2.5 Shoqëritë bamirëse të themeluara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	49
II. FILANTROPIA DHE BAMIREsia NE VITET 1920–1990	54
2.1 Filantropia dhe bamirësia në vitet 1920–1939.....	54
2.2 Filantropë dhe bamirës të shquar në vitet 1920–1939.....	63
2.2.1 Filantropia dhe bamirësia në krahinën e Korçës.....	63
2.2.2 Filantropia dhe bamirësia në krahinat e Vlorës, Beratit dhe Gjirokastrës.....	68
2.2.3 Filantropë dhe mirëbërës nga krahina e Elbasanit.....	70
2.2.4 Bamirës dhe filantropë në krahinën e Tiranës.....	71
2.2.5 Bamirësia dhe filantropia në krahinën e Shkodrës.....	81
2.2.6 Mbështetja e diasporës për Kryqin e Kuq Shqiptar.....	82
2.2.7 Veprimtaria mirëbërëse dhe filantropike e diasporës shqiptare.....	83

2.3 Filantropia dhe bamirësia në vitet 1939–1944.	86
2.4 Filantropia dhe bamirësia në vitet 1945–1990.	97
III. FILANTROPIA DHE BAMIRESIA PAS VITEVE 1990.	103
3.1 Praktika nga aktiviteti filantropik i disa kompanive në Shqipëri. . .	104
MATERIALE SHTESE.	110
LENDA BURIMORE.	112

Studimi synon të japë një vështrim historik të zhvillimit të filantropisë në Shqipëri, në periudha të ndryshme historike, që prej shekullit të XIX e deri në kohët e sotme. Parashtrimi i fakteve është bërë bazuar në dokumentat ekzitues, që për hir të së vërtetës nuk ishin të shumta lidhur me këtë çështje. Studimi nuk është thelluar në analizimin e zhvillimit të filantropisë dhe bamirësisë në periudhën pas viteve 1990, duke qenë se kjo nuk ishte pjesë e qëllimit të këtij studimi. Periudha relativisht e afërt me kohën e kryerjes së këtij studimi, veprimtaria e vagët filantropike gjatë këtyre 20 viteve si dhe mungesa e dokumentimit të kësaj veprimtarie si nga ana e individit ashtu dhe nga ana e shtetit, kërkon një lloj tjetër përqasje studimore.

Partnerët Shqipëri duke e vlerësuar si shumë të rëndësishme analizën e veprimtarisë filantropike gjatë kësaj periudhe kohore, ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë studime më të thelluara në këtë fushë.

Falenderime të vecanta shkojnë për përfaqësuesit e biznesit që u përfshinë në studim, duke vlerësuar bashkëpunimin dhe kontributin e tyre.

Studimi u mundësua falë mbështetjes së Fondit Rockefeller Brothers. Opinionet e shprehura në studim nuk reflektojnë domosdoshmërisht këndvështrimin e Fondit Rockefeller Brothers.

Filantropia në Shqipëri ka një histori të sajën të veçantë dhe pazgjidhshmërisht të lidhur me kushtet shoqërore, ekonomike dhe historike nëpër të cilat ka kaluar popullsia shqiptare. Gjurmët e para të filantropisë ndër shqiptarët kanë rrënjë të hershme dhe shtrihen që në mesjetë. Mbështetja dhe ndihma e ndërsjellë mes njerëzve është në të vërtetë jo thjesht një dukuri shqiptare apo e rajonit ku jetojmë. Ajo është pjesë përbërëse e vetë natyrës njerëzore, e cila është shfaqur gjatë gjithë historisë së njerëzimit në forma të ndryshme, në periudha të ndryshme, në përputhje me shkallën e zhvillimit dhe periudhat historike nëpër të cilat ka kaluar shoqëria njerëzore. Në rastin e shqiptarëve, objekti i studimit të filantropisë dhe bamirësisë do të përfshijë periudhën prej shekullit XIX, periudhë gjatë së cilës veprimtaria bamirëse dhe filantropike fitojnë tipare të reja dhe të veçanta, duke kapërcyer skemat e vjetra brenda së cilës zhvilloj kjo veprimtari që më tepër se sa vendase i përket organizimit shoqëror otoman të periudhës mesjetare.

Tronditjet e mëdha që i shkaktoi shekulli XIX botës së vjetër, ndryshuan faqen e saj dhe përcaktuan proceset historike të të gjithë vendeve të Evropës e më gjerë. Këto ndryshime prekën të gjitha rrafshet e jetës përfshi edhe filantropinë dhe bamirësinë. Kjo është arsyeja pse pas analizimit të një lënde të vëllimshme mbi këtë çështje, ne pamë të arsyeshme që veprimtarinë filantropike dhe bamirëse në Shqipëri ta ndanim, në përputhje me tiparet që ajo merr, në dy etapa të veçanta: atë të shekullit XIX deri në vitin 1920 dhe atë pas saj. Gjatë pjesës më të madhe të periudhës së parë veprimtaria filantropike është bërë në kushtet kur vendi ishte në suazat administrative të Perandorisë Osmane duke marrë kështu tipare të dallueshme nga periudha që pasoi. Është e vërtetë që në vitin 1912 Shqipëria fitoi Pavarësinë, por shteti i mirëfilltë shqiptar nisi me Kongresin e Lushnjes dhe me qeverinë e dalë prej tij. Periudha kohore ndërmjet viteve 1912–1920 ka qenë një kohë paqartësish për fatin e Shqipërisë dhe për këtë arsye ajo ndryshon pak nga periudha që e parapriu. Kjo vazhdimësi mes periudhës otomane dhe tetë viteve që e pasuan atë do të reflektohet edhe në veprimtarinë bamirëse dhe filantropike. Në vija të përgjithshme tiparet e këtij aktiviteti ndryshuan fare pak, për të mos thënë aspak. Kjo është arsyeja pse vendosëm që si vijë ndarëse për strukturimin e këtij studimi të marrim vitin 1920. Pikërisht pas këtij viti do të shohim se ndodhin ndryshime të dukshme në këtë lloj veprimtarie shoqërore. Nëse në periudhën e parë veprimtaria filantropike kryhej nga shqiptarë të mërguar jashtë truallit të tyre amëtar, në periudhën e dytë, pavarësisht përfshirjes së diasporës, angazhimi i saj nisi të zbehej. Në vend të parë nisën të dalin persona të kamur me banim në Shqipëri.

Megjithatë krijimi i shtetit të pavarur shqiptar nuk çoi në një zgjerim të veprimtarisë bamirëse dhe filantropike. Në çastin kur shqiptarët patën një shtet të vetin, hodhi rrënjë mendimi se detyra që më parë bëhej nga shqiptarët e mërguar por edhe ata që banonin në vend, tanimë i takonte shtetit. Kjo përkon me triumfin e etatizmit në Shqipëri ku shteti shikohej si prindi i shoqërisë dhe jo si rregullatori i marrëdhënieve dhe garanti i ligjit në vend. Kjo mendësi do të përforcohej dhe më shumë pas ardhjes së komunizmit, kohë gjatë së cilës veprimtaria filantropike u zhduk krejtësisht. Duhet theksuar se shteti shqiptar, mes dy luftrave botërore u bë një nxitës i veprimtarisë bamirëse dhe filantropike. Kjo bëhej edhe më e vërtetë në kushtet kur shteti shqiptar kishte burime financiare të kufizuara dhe bamirësia e filantropia shiheshin si lehtësuese të një barre jashtëzakonisht të madhe që ai mbante në atë kohë mbi supë. Por kësaj grishjeje, shoqëria shqiptare nuk ju përgjigj në mënyrën e duhur.

Pjesa që trajton periudhën pas vitit 1920 do të ndahet në tre nënpjesë ku secila prej tyre do të mbulojë përkatësisht periudhat që shtrihen në vitet 1920–1939, 1939–1944 dhe 1944–1990. Sikurse shihet, ndarja kronologjike e këtyre pjesëve përputhet me periudhat historike nëpër të cilat kaloi shteti shqiptar në vitet 1920–1990. Në secilën prej këtyre periudhave, ndodhën ndryshime të rëndësishme historike që do të reflektoheshin patjetër edhe në veprimtarinë bamirëse dhe filantropike në Shqipëri.

Në fokusin e këtij studimi do të jetë veprimtaria bamirëse dhe filantropike e shqiptarëve që banonin brenda kufijve të shtetit shqiptar të sotëm por edhe e shqiptarëve që banonin në trojet që përbëjnë trungun historik shqiptar. Bamirësia dhe filantropia janë një dukuri që është zhvilluar sidomos në shekullin e XIX dhe dy dhjetvjeçarët e parë të shekullit XX prej shqiptarëve të diasporës. Për këtë arsye ky trajtim nuk do të kufizohet vetëm në veprimtarinë bamirëse dhe filantropike të shqiptarëve në Shqipëri. Nëse bëhej një gjë e tillë atëherë studimi do të ishte i mangët.

Me mjaft rëndësi për t'u nënvizuar është fakti se veprimtaria bamirëse dhe filantropike në më të shumtën e rasteve ka patur në qendër të saj mbështetjen e zhvillimit, modernizmit dhe emancipimit të popullit shqiptar. Bamirësia dhe filantropia kanë qenë gjerësisht të lidhura me lëvizjen kombëtare shqiptare. Përmes kësaj veprimtarie, shqiptarët janë përpjekur të zhvillojnë sidomos arsimin që ka qenë një nga detyrat kryesore të lëvizjes kombëtare shqiptare. Sikurse do të shihet më poshtë, *arsimi ka qenë objekti kryesor i veprimtarisë filantropike dhe bamirëse të zhvilluar ndër shqiptarët.*

Bamirësia dhe filantropia nuk kanë qenë të kufizuara në persona të veçantë por ato kanë qenë edhe veprimtari shoqatash mirëbërëse të themeluara enkas për këtë qëllim. Në shumicën e rasteve kjo veprimtari ka qenë e orientuar kah krahinës apo fshatit prej nga vinte bamirësi ose bamirësit, të cilët bashkoheshin nga prejardhja.

Në trajtimin e çështjes së filantropisë dhe bamirësisë ndër shqiptarët është e nevojshme së pari të sqarohet koncepti mbi këto dy veprimtari pasi për nga natyra që kanë shpesh bëhet e vështirë ndarja e prerë e tyre. Bamirësi në shqip është ekuivalentja e fjalës latine *caritas* që rrjedh prej fjalës *carus*, që do të thotë i dashur. Pra ajo nënkupton dashurinë ndaj të afërmit që i shtyn njerëzit të bëjnë mirë. Për sa i përket fjalës filantropi ajo rrjedh prej greqishtes së lashtë dhe nëse do ta shqipërojmë fjalë për fjalë do të thotë dashuri për njerëzimin. Pra ajo i kapërcen caqet e bamirësisë - *caritas*, pasi nëse me këtë të fundit ne kuptojmë ndihmë dhe mbështetje ndaj të dashurit, ndaj njerëzve që na gjenden pranë, filantropia shtrihet në një rrafsh shumë më të gjerë, rrok një mision shumë më të madh dhe vishet me një kuptim shumë më fisnik. Brenda suazave të filantropisë, i dashur, nuk është i afërmi por krejt njerëzimi. Si veprimtari ajo përfshin mbarë njerëzimin pa dallime fisnore, fetare, racore dhe çdo lloj dallimi tjetër. Pra filantropia është edhe një ideal, një qëllim, që kërkon përmirësimin e shoqërisë njerëzore.

Sikurse u përmend edhe më sipër, në pjesën më të madhe të rasteve veprimtaria bamirëse dhe filantropike ndër shqiptarët ka qenë e orientuar drejt nacionalizimit dhe krahinarizmit. Pra ajo kishte për qëllim që të ndihmonte ato grupe shoqërore që cilësoheshin si të dashur ose të lidhur ngushtë për nga gjaku, feja apo kombësia. Ato, me përjashtim të pak rasteve, nuk kishin në fokus njeriun si qenie dhe njerëzimin si shoqëri. Në kuptimin më të gjerë, ato kishin në fokus të tyrin shqiptarët. Kjo është arsyeja pse në rastin shqiptar fillimisht duket disi e vështirë të identifikojmë arketipin prometeian me të cilin lidhet veprimtaria filantropike, të ndërthurur me kuptimet moderne dhe bashkohore që ka marrë ky term. Hapsira brenda të cilave kjo veprimtari u zhvillua kishte caqe të ngushta. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se aktiviteti filantropik mungoi në hapësirën shqiptare dhe ndër shqiptarët. E vërteta është se edhe shqiptarët kanë patur prometejt e tyre.

Po të kemi parasysh kushtet e mjeruara, varfërinë dhe padijen e thellë të popullsisë shqiptare nga njëra anë dhe nga ana tjetër përpjekjet e filantropëve shqiptarë për të përhapur dijen përmes arsimit, e përdorimin e kësaj të fundit jo thjesht si një mjet për të shëruar plagët shoqërore të çastit por shndërrimin e saj në një mjet të fuqishëm, në një themel

të qëndrueshëm për një të ardhme më të mirë dhe të begatë, atëherë shohim se filantropët shqiptarë janë shumë pranë idealit prometeian.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh edhe kushtet në të cilat kanë jetuar shqiptarët dhe ekzigjencat e tyre historike, si filantropike do të quajmë veprimtarinë e atyre personave apo shoqërive që kishin në fokus të punës së tyre shqiptarët dhe që për nga problematika që mbuluan e ndihmat që dhanë, ndikuan gjerë në shoqërinë shqiptare. Gjithashtu filantropia nga bamirësia ndryshojnë edhe nga përmasat e donacioneve, *i.e.* parave, që janë vënë në dispozicion të një çështjeje të caktuar. Për këtë arsye një kriter tjetër për identifikimin e filantropisë nga bamirësia do të jetë edhe sasia e parave të dhuruara. Por këtu duhet bërë kujdes. Filantropike janë ato veprimtari që mundësojnë ndryshime të shënuara në jetën e shoqërisë. Kjo parakupton se një veprimtari të tillë që mund të japë të tilla rezultate mund ta bëjnë vetëm persona të pasur. Natyrshëm lind pyetja: a mund të shërbejë pasuria si kriter, në rastin shqiptar, për identifikimin e shoqërive apo personave që kanë kryer veprimtari filantropike? Nëse kriterit për ndryshime domethënëse shoqërore i duhet qëndruar besnik, nuk mund të pranojmë për të mirëqenë, kuptohet për rastin shqiptar, arsyetimin se pasuria është një kriter i nënkuptuar në identifikimin e filantropëve. Shpesh qëllimi dhe idetë triumfojnë mbi mundësitë e kufizuara financiare, pasi ato shërbejnë si një shembull, si një vision, që më pas mobilizon shoqërinë dhe e orienton atë drejt së ardhmes. Kjo bëhet më e vërtetë për Shqipërinë e varfër dhe të pazhvilluar. Për këtë arsye në pjesën e parë të studimit, që trajton kohën kur Shqipëria ishte pjesë e një shteti shumëkombësh, i cili bëri shumë pak për përmirësimin e jetesës së shqiptarëve, do të vlerësojmë edhe qëllimin dhe ky do të shërbejë shpesh si njësi matëse për të ndarë filantropinë nga bamirësia. Më pas, në pjesën e dytë, ku do të flitet për periudhën kur shqiptarët kishin shtetin e tyre, çënsi i pasurisë do të shërbejë si një instrument i rëndësishëm në identifikimin e filantropisë nga bamirësia.

Përveç shtrirjes së veprimtarisë dhe shumave të derdhura, një kriter tjetër në dallimin e filantropisë nga bamirësia do të jetë edhe vizioni i qëllimit të parashtruar nga veprimtaria. Filantropike do të cilësojmë edhe ato veprimtari të cilat kanë patur për qëllim t'i përgjigjen përpos nevojave të çastit edhe atyre të së ardhmes. Ndërsa bamirëse do të quajmë veprimtarinë që ka patur në qendër të saj interesa të ngushta lokale dhe që ka qenë e kufizuar në sasinë e dhurimeve e atë të qëllimeve.

I. FILANTROPIA DHE BAMIREsia NE SHQIPERI GJATE SHEKULLIT XIX DERI NE VITIN 1920

Zhvillimi i filantropisë dhe i bamirësisë përcaktohet nga dy elemente bazë që janë fuqia ekonomike dhe vlerat shoqërore. Për të kuptuar më mirë dinamikën e dukurisë filantropike ndër shqiptarët deri në vitin 1920 duhet të kuptohet paraprakisht terreni në të cilin u zhvillua kjo veprimtari. Duhet patur parasysh se bamirësia dhe filantropia në trevat shqiptare nuk lindën nga hiçi. Ato kanë një histori të vetën, një dinamikë evoluimi në përputhje me zhvillimet historike të trojeve shqiptare. Prej këtu lind nevoja e parashtrimit të një sfondi historik të Shqipërisë veçanërisht gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Analizimi i zhvillimeve historike të periudhës në fjalë do të na mundësojë të kuptojmë ndërveprimin e dy elementeve të sipërpërmendur, e prej këtej arsytet që përcaktuan shkallën e zhvillimit të filantropisë dhe bamirësisë.

Ndihma dhe mbështetja e njerëzve në nevojë ka qenë e pranishme në hapësirën shqiptare qysh herët. Gjatë mesjetës në themel të veprimtarisë mirëbërëse qëndronte Kisha, e cila gjatë kësaj kohe ishte strumbullari i gjithë jetës shoqërore, politike dhe ekonomike.¹ Institucionet kishtarë që ishin të angazhuara në këto veprimtari, ku spikasnin veçanërisht ato të Kishës Katolike, ndeshen në territorin shqiptar që në shekullin XIV si p.sh. urdhrat fetar benediktin dhe françeskan të lypsëve në qytetin e Shkodrës.² Prania e urdhrave fetarë të angazhuar në arsim, dhe sipas të gjitha gjasave edhe në punë mirëbërëse, vazhdon të jetë e pranishme në të njëjtin qytet edhe në shekullin XV me vëllazëritë e Shën Mërkurit dhe të Shën Barbarës.³

Pushtimi osman nuk shkaktoi një ndërprerje të veprimtarisë filantropike, ndonëse në shekujt e parë që e pasuan ajo nuk u ushtrua me ndonjë intensitet të madh. Rasti i vetëm që njohim është ai i Iljaz Bej Mirahorit, që ngriti në Korçë në fillim të shekullit XVI, një varg fondacionesh bamirëse myslimane të cilat u shndërruan në një faktor të rëndësishëm për thithjen e popullsisë me besim Islam nga fshatrat e krahinës drejt qytetit.⁴ Prej këtej mendojmë se në intensitetin e ulët të mirëbërësisë ka

1. Ermal Baze, *Qyteti i Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV*, disertacion për gradën Doktor pranë UT, 92.

2. *Po aty*, 97.

3. Injac Zamputi, *Regjistri i Kadastrës dhe i konçesioneve për rrethin e Shkodrës 1416–1417*, Tiranë: Akademia e Shkencave të RPSSH, 1977, 35.

4. Petraçq Pepo, *Materiale Dokumentare për Shqipërinë Juglindore të Shekullit XVIII–Fillimi i Shekullit XX (Kodiku i Korës dhe Selasforit)*, vëll. I, Tiranë: Akademia e Shkencave të RPSSH, 1981, 5–6.

ndikuar rënia e jetës qytetare që pasoi pushtimin osman të vendit, që i rrënoi plotësisht qytetet shqiptare shumica e të cilave përfunduan me një popullsi me përmasat e fshatrave.⁵ Për ripërtëritjen e jetës qytetare do të nevojitej më shumë se një shekull.⁶ Pikërisht gjatë këtij momenti dëshmitë e veprimtarisë mirëbërëse janë të pakta duke kapur pikën më të ulët në zhvillimin e kësaj veprimtarie. Prej fundit të shekullit XVI në qytetet shqiptare shfaqen shenjat e asaj metamorfoze që do t'i shndërronte dora-dorës ato nga qendra politiko-ushtarake në qendra ekonomiko-shoqërore.⁷ Tanimë qytetet rimarrin veten nga shkatërrimet dhe në to nisin të rishfaqen korporatat profesionale në formën orientale të esnafit. Bazat për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit ishin hedhur.⁸ Fundi i shekullit XVII dhe fillimi i shekullit XVIII do të karakterizoheshin nga fillimi i lulëzimit të jetës qytetare në trevat shqiptare.⁹ Nga ky moment të dhënat për veprimtaritë mirëbërëse shtohen. Kjo na shtyn në përfundimin se ekziston një lidhëz e fuqishme ndërmjet veprimtarisë filantropike dhe prodhimit industrial e shprehur dhe nëpërmjet lulëzimit të jetës qytetare. Diagrama e kurbës së ecurisë së jetës së qyteteve është shoqëruar nga i njëjti diagram edhe për mirëbërësinë dhe filantropinë. Në këto aktivitete do të shquhet veçanërisht treva korçare. Një nga personalitetet më të njohura në fushën e bamirësisë në këtë rajon ka qenë Joasaf Korçari nga Voskopoja. Ai jetoi në shekujt XVII–XVIII dhe punoi për ngritjen e shtypshkronjës së Voskopojes dhe shkollës “Akademia e Re”, e cila u ndërtua me të hollat e mbledhura nga qytetarët voskopojarë me qëllim ngritjen e një shkollë të tillë “që të mos e kishin të tjerët.”¹⁰ Ai ndihmoi gjithashtu Varoshin e Korçës të ngrinte në vitin 1725 një shkollë për djem ku kontribuan edhe banorët e Vithkuqit,¹¹ Boboshticës si dhe Kostandin Pano Kukuzeli.¹²

Lulëzimi i esnafëve në shekullin e XVIII krijoi një bazë të fortë ekonomike për zhvillimin e punës mirëbërëse në qytetet shqiptare pasi ato shpërndanin të holla për zhvillimin e arsimit dhe kulturës në qytetet përkatëse. Një shembull i tillë është vendimi që morën rufetet e

5. Selami Pulaha, “Qytetet shqiptare nën regjimin feudal ushtarak osman gjatë shekujve XV–XVI,” *Monumentet*, nr. 1, 1984: 17–18.

6. *Po aty*, 26.

7. *Po aty*, 25.

8. *Po aty*, 40.

9. Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë: Akademia e RPSSH, 1984, 6.

10. Aurel Plasari, *Fenomeni Voskopjës*, Tiranë: Phoenix & ShLK, 2000, 44.

11. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. I, dok. 12, 86–87.

12. *Po aty*, vëll. II, dok. 166, 169.

tabakëve, samarxhinjve, papuçinjve, kasapëve etj. të qytetit të Korçës në vitin 1738, për ngritjen e një shkolle në gjuhën greke për djem ku mund të arsimoheshin pa asnjë dallim të gjithë të rinjtë e qytetit.¹³ Ky rol i esnafëve në zhvillimin e arsimit dhe kulturës nuk ishte një dukuri e kufizuar vetëm në qytetin dhe krahinën e Korçës por edhe në qytete të tjera. Zhvillimi i arsimit pësoi një hov të vullshëm në një varg qendrash urbane të hapësirës shqiptare si Shkodra, Janina dhe Manastiri pikërisht nga zhvillimi i borgjezisë qytetare dhe financimeve të saj,¹⁴ që jepeshin në suazat e mirëbërësisë. Ne njohim edhe rastin e esnafëve të Gjirokastrës që ngritën në vitin 1756 një shkollë pranë pazarit të qytetit¹⁵ apo rastin tjetër të ndërtimit të një shkolle në Elbasan në vitin 1763 me shumat e mbledhura nga të krishterët e këtij qyteti.¹⁶ Në mungesë të institucioneve të rregullta bashkiake, rregullimi i hapësirës publike kryhej nga esnafet, të cilat përmes të ardhurave nga arka e tyre ndërtonin ura, rrugë, çezma, hapnin puse, pastronin tregun, hapnin vija uji etj.¹⁷ Esnafet kontribuonin gjithashtu në përmirësimin e urbanistikës së qytetit përmes ndërtimit të godinave të kultit si formë e përkrahjes së vazhdueshme që jepnin ndaj institucioneve klerikale. P.sh në Voskopojë pjesa më e madhe e kishave u ndërtua nga rufetet e këtij qyteti kurse Mitropolia e Korçës, e cila daton në vitin 1725, u ndërtua me paratë e mbledhura nga esnafet e qytetit.¹⁸ Nisur nga këto raste dalim në përfundimin se mirëbërësia nuk ka qenë e izoluar dhe patjetër që ka patur raste të ngjashme edhe në treva dhe qytete të tjera shqiptare por mungesa e burimeve nuk na lejon të bëjmë përgjithësime dhe analiza të hollësishme për periudhën që paraprin shekullin XIX. Por sidoqoftë ato janë një dëshmi e qartë e vazhdimësisë së bamirësisë ndërmjet periudhës që ka paraprirë pushtimin osman dhe periudhës që pasoi atë.

Një karakteristikë e veprimitarisë mirëbërëse të kësaj periudhe është kufizimi i saj brenda caqeve të solidaritetit fisnor dhe grupeve esnafore qytetare. Ato synonin të ruanin dhe të rritnin homogjenitetin e grupit apo anëtarëve të një bashkësie të caktuar sidomos në kuadrin e përballjeve me bashkësi apo grupe të tjera. Kjo del qartë p.sh në rastin e rufetit të bakejve të Voskopojës.¹⁹ Në grupet esnafore funksionet shoqërore

13. *Po aty*, vëll. I, dok. 71, 148–149.

14. Petrika Thëngjilli, *Historia e Popullit Shqiptar 395–1875*, Tiranë: ShBLU, 1999, 296.

15. Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë: Akademia e RPSSH, 1984, 73.

16. Petrika Thëngjilli, *vepër e përmendur*, 239.

17. Zija Shkodra, *Esnafet shqiptarë*, Tiranë: Akademia e RPSSH, 1973, 256–257.

18. *Po aty*, 238–239.

19. *Po aty*, 254.

të tyre kanë qenë të përcaktuara dhe të kodifikuara edhe në statutet përkatëse. Ata kryenin gjithashtu edhe funksione shoqërore që kishin për qëllim mbështetjen dhe ndihmën e anëtarëve dhe familjeve të tyre në rast nevojë apo fatkeqësish. Kjo mbështetje e ndërsjellë që e shndërronte esnafin në një familje të madhe është një tipar i shoqërive feudale, ku ai është shprehës i natyrës së mbyllur dhe kolektiviste të saj. Ndihma dhe mbështetja ishin të kufizuara në grupe të caktuara profesionale dhe nuk dilnin përtej tyre. Mbi të gjitha ky ishte një solidaritet dhe ndihmë e ndërsjellë në kuadrin e grupit në një shoqëri aspak individualiste sipas konceptit bashkëkohor, por individualiste në kuptimin feudal të fjalës, të copëzuar në grupe ku individët identifikoheshin nga bashkësia dhe ku marrëdhëniet mes bashkësive apo shtresave shoqërore ishin të kufizuara. Në këtë kuadër, mbështetja materiale dhe mirëbërja ishin të kufizuara brenda grupeve të ngushta dhe i shërbenin ruajtjes së homogjenitetit të tyre. Përveç esnafeve, të tjerë promotorë të veprimtarive të kësaj natyre ishin institucionet fetare, të cilat e kishin kryer historikisht këtë funksion. Por, edhe në këtë rast puna e tyre bamirëse karakterizohej nga e njëjta natyrë e mbyllur duke u përqëndruar brenda bashkësive fetare përkatëse.

Gjatë shekullit XIX nisën të merrnin jetë zhvillime të reja historike të cilat do të reflektoheshin edhe në shtrirjen dhe formën e veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike. Në këtë periudhë në trevat shqiptare do të ndodhnin ndryshime të diktuar nga zhvillimet që po përjetonte Evropa Perëndimore. Proçeset e reja historike do të ndihmonin në çarjen e ngadalëshme por të pandalur të guackës feudale, në të cilën jetonte e mbyllur shoqëria shqiptare. Kjo do të pasqyrohej më pas edhe në veprimtarinë bamirëse dhe filantropike ku do të shkriheshin elementët e së shkuarës me të rinj.

Shekulli XIX përfaqëson epokën e artë të Evropës Perëndimore. Duke nisur nga gjysma e dytë e këtij shekulli ajo ushtroi një ndikim dhe kontroll mbi krejt botën në një shkallë të panjohur më parë.²⁰ Evropa Perëndimore ishte qendra politike, ekonomike dhe kulturore e botës. Modelet dhe idetë që vinin prej saj do të ndikonin në mënyrë të pashmangshme historinë e shoqërive që jetonin në sinujdhesën ballkanike, një ndër rajonet e para që u ndikua nga zhvillimet e Perëndimit.²¹ Trojet shqiptare nuk bënë përjashtim nga ky rregull, vetëm se shkalla e këtyre ndikimeve

20. Donald Kagan, Frank M. Turner, Steven Ozment, *The Western Heritage*, vëll. II, New Jersey: Prentice Hall, 1998, 911.

21. Leften S. Stavrianos, "The influence of the West on the Balkans", në Charles and Barbara Jelavich, *The Balkans in Transition*, Los Angeles: University of California Press, 1963, 214.

do të ishte më e ngadaltë se në vendet e tjera të rajonit si dhe veç kësaj do të ndryshonte nga njëra krahinë në tjetrën, nga njëri grup shoqëror në tjetrin.

Këtu kishte ndikim struktura fetare e shqiptarëve. Besimi merrte mjaft rëndësi për shkak të rolit identitar që ai luante në Perandorinë Osmane. Kjo bënte që të krishterët shqiptarë të identifikoheshin si latin katolikë dhe si rum, ose e thënë ndryshe grek bizantin ortodoksë. Në këtë shtet shumëkombësh, shumëgjuhësh dhe multifetar besimi barazohej me përkatësinë kombëtare. Shumica e shqiptarëve të besimit mysliman ruanin në një shkallë të gjerë besnikërinë ndaj Sulltanit osman dhe orientimin kulturor e kishin të drejtuar kah Lindjes dhe jo Perëndimit.²² Ndërsa Porta e Lartë mbeti deri në fund një shtet mysliman, të krishterët shqiptarë, të cilët jetonin në një hapësirë ku pozita mes sundimtarit dhe të sunduarve përcaktohej pikërisht nga faktori fetar,²³ ishin më të hapur ndaj Perëndimit dhe të prirur që të përthithnin më lehtë modelet që vinin prej tij, ç'ka për shekullin XIX dhe fillimin e shekullit XX barazohej me modernitetin.

Në suazat e sistemit të administrimit osman, partikularizmi krahinor dhe lokal zhvillohej shumë dhe identifikimi i individit me grupin dhe identitetet kolektive të fshatit, krahinës, fisit, familjes, profesionit apo besimit, vazhduan të ruheshin ende të forta te shqiptarët deri në fillim të shekullit XX. Ruajtja dhe madje përforcimi i këtyre identiteteve do të pengonte seriozisht zhvillimin e individualizimit. Pikërisht ky tipar i rëndësishëm do të pasqyrohej edhe në veprimtarinë bamirëse dhe filantropike, pasi këto do të ruanin tiparet e mirëbërjes dhe ndihmës së ndërsjellë tipike të esnafit që zhvilloheshin brenda bashkësive të ndryshme. Kështu në shumicën e rasteve bamirësia apo filantropia do të shfaqeshin si mbështetje që anëtarët e një qendre të caktuar banimi, ç'ka lidhet me identitetin lokal, apo anëtarët e një bashkësie të caktuar fetare, që lidhet me identitetin fetar, i jepnin njëri-tjetrit. Mirëbërësia apo filantropia, që drejtohen ndaj njerëzve në përgjithësi, pavarësisht përkatësisë krahinore apo fetare, mbeti në këtë periudhë një dukuri e izoluar. Megjithatë duhet theksuar se që gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX filluan të shfaqen rastet e para të këtij lloji. Këto raste ishin këmbana që paralajmëronte fillimin e ndryshimeve në mendësi dhe në identite në gjirin e shoqërisë shqiptare.

22. Stavro Skëndi, *Zgjidhje kombëtar shqiptar*, Tiranë: Phoenix & ShLK, 2000, 420.

23. *Po aty*, 419.

Për sa i përket ekonomisë, ajo ishte thellësisht rurale dhe e prapambetur.²⁴ Vendi, edhe pse fizikisht ishte mjaft afër Perëndimit dhe rrugëve të mëdha të komunikimit, mbetej sa i varfër po aq edhe i izoluar nga pjesa tjetër e botës. Relievi i ashpër malor e ndihmonte edhe më tepër këtë izolim. Malet që kishin shërbyer si fortesa për shqiptarët për të ruajtur lirinë e bashkësive të tyre, tanimë ishin shndërruar në pengesa të mëdha për komunikimin dhe kontaktet me botën. Pa rrugë komunikimi, e varfër, rurale dhe me ekonomi familjare shpesh të vetmjaftueshme, dinamizmi shoqëror dhe kontaktet me jashtë mbetën në nivele shumë të ulta. Shqiptarët qëndruan të mbyllur në guackën e shoqërisë mesjetare për një kohë shumë të gjatë. Sikur të mos mjaftonte, pjesa më e madhe e tyre ishte e zhytur në padije. Sistemi arsimor në vend ishte shumë i prapambetur. Stambolli kishte mbështetur zhvillimin e shkollave fetare dhe kishte lënë krejt pas dore arsimin e përgjithshëm.²⁵ Varfëria dhe mungesa e zhvillimit nuk mund të krijonin terrenin e përshtatshëm për zhvillimin e bamirësisë dhe filantropisë por nga ana tjetër nevoja për aktivitetin filantropik dhe bamirës, në kushtet kur Porta e Lartë nuk shfaqte asnjë vullnet për të ndryshuar gjëndjen, bëhej shumë e madhe në kuadrin e sfidave të jashtëzakonshme me të cilat ballafaqohej shoqëria shqiptare.

Një shoqëri nuk është asnjëherë monolite dhe realitetet rajonale ndryshojnë. Edhe Shqipëria nuk bën përjashtim nga ky rregull, gjë që do të vihet re edhe në zhvillimin e veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike. Në disa krahina të Shqipërisë këto veprimtari ishin më të zhvilluara se sa në krahina të tjera. Kushtet dhe rrethanat e sipërpërmendura kanë përcaktuar këtë ndryshueshmëri të dendësisë së punës bamirëse dhe filantropike në hapësirën shqiptare. Por duhet patur parasysh se nëse rrethanat ekonomike, shoqërore dhe politike në trevat shqiptare nuk kanë qenë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë filantropike dhe mirëbërëse, ajo që ka përcaktuar zhvillimin e filantropisë ka qenë e gjerësisht e diktuar nga kontaktet me botën përtej hapësirës shqiptare. Kjo nuk do të thotë se filantropia u huazua prej shqiptarëve si praktikë.²⁶ Kontaktet me jashtë thjesht krijojnë rrethanat e duhura që kjo veprimtari të zhvillohej dhe të përshkallëzohej.

24. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë: Toena, 2002, 37.

25. *Po aty*, 39.

26. Këtu duhet theksuar mbi të gjitha nevoja e studimit të ndikimit të modelit të filantropisë greke, sidomos mbi veprimtarinë filantropike të shqiptarëve ortodoksë. Por nga ana tjetër mendojmë se ky ndikim nuk duhet mbivlerësuar pasi mirëbërësia dhe filantropia në Greqi është ushtruar më shumë se kushdo tjetër nga ortodoksët e Epirit dhe në shumicën e rasteve këta mirëbërës dhe filantropë ishin me prejardhje shqiptare.

Dinamizmi shoqëror dhe pranimi i ndryshimit nga anëtarët e grupeve shoqërore ka shërbyer si një pikënisje për kryerjen e këtij aktiviteti, synimi kryesor i të cilit është ndryshimi pozitiv i shoqërisë, domethënë përparimi. Pra zhvillimi dhe dendësia e aktivitetit filantropik nuk përcaktohej nga mungesa apo prania e prirjes apo e traditës së një pjese të shqiptarëve për të kryer këtë lloj veprimtarie, por me disa parakushte të nevojshme për ta kryer atë. Kjo ndryshueshmëri që përmendëm më sipër do të përcaktohej në një shkallë të gjerë nga shkalla a marrëdhënieve me hapsira të tjera më të zhvilluara se sa ajo shqiptare. Mobiliteti dhe lëvizshmëria ishin faktorë të rëndësishëm që ndihmuan në fuqizimin dhe zhvillimin e filantropisë në trevat shqiptare. Kjo është arsyeja pse në përgjithësi pjesa dërrmuese e mirëbërësve dhe filantropëve shqiptarë, gjatë periudhës që trajton kjo pjesë e këtij studimi kanë qenë emigrant. Pra *emigracioni ka qenë një faktor i rëndësishëm që ka ndihmuar zhvillimin e filantropisë*. Pas qëmtimit të burimeve arritëm në përfundimin se mekanizimi i analizës së studimit të arsyeve dhe premisave që kanë përcaktuar shkallën dhe shtrirjen e aktivitetit mirëbërës dhe filantropik, për periudhën që mbulon kjo pjesë e këtij studimi, është diktuar nga faktorët krahinor–gjeografik, klasor–shoqëror dhe fetar.

1.1 Faktori krahinor dhe gjeografik

Kur flasim për faktorin krahinor dhe gjeografik duhet patur parasysh mbi të gjitha pozicioni i krahinave të caktuara karshi hapjes me botën dhe sidomos me Perëndimin, me modernitetin dhe me idetë që e kishin burimin te ky i fundit. Në përgjithësi Shqipëria e Jugut, në krahasim me atë të Veriut, ka qenë gjeografikisht më e hapur ndaj ndikimeve të huaja.²⁷ Relievi gjeografik më i butë dhe mjetet më të mira të komunikimit dhe me një prani më të madhe të kontrollit të pushtetit qëndror, shoqëria fisnore në jugun e vendit, me pak përjashtime, ishte shthurur prej kohësh²⁸ duke bërë që jugu i vendit të ishte më i përparuar se veriu dhe të kishte një klasë më të madhe njerëzish të arsimuar.²⁹ Në mënyrë të veçantë dallonte Shqipëria Juglindore që ishte më e hapur ndaj kontakteve me jashtë. Të ndodhura më pranë rrugëve tregtare që prisnin tërthor Ballkanin, krahinat e këtij rajoni ishin më të hapura ndaj lëvizjes së mallrave, njerëzve dhe ideve. Kjo hapje më e madhe me botën detyrimisht do ta çante më shpejtë unazën e jetës së mbyllur feudale. Popullsia e këtyre rajoneve do të ishte e para që do të

27. Eqrem Çabej, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit*, Tiranë: Çabej, 1994, 22.

28. Stavro Skëndi, *vepër e përmendur*, 25.

29. *Po aty*, 419.

emigronte. Kështu korçarët do të emigronin në Egjipt për t'u marrë me tregti qysh në vitin 1800.³⁰ Kjo lëvizshmëri do të kishte efektet e saj në të gjitha rrafshet e jetës ekonomike, shoqërore dhe kulturore dhe do të pasqyrohej edhe në veprimtarinë bamirëse dhe filantropike, e cila do të shprehej në ndihmat që emigrantët më të suksesshëm të këtyre zonave do të bënin për zhvillimin e bashkësive prej nga vinin. Ky kontribut do të pasqyrohej në përpjekjet e tyre për të modernizuar dhe përmirësuar jetën e bashkëfshatarëve ose bashkëqytetarëve të vet në përputhje me modelet që ata merrnin nga vendet ku kishin emigruar. Qendrat kryesore të emigrimit shqiptar ishin Greqia, Rumania, Bullgaria, Egjipti, ku shqiptarët gjenin mbështetje nga dinastia e kedivëve egjiptianë që ishin me prejardhje shqiptare, dhe më vonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.³¹ Në këto vende ata ranë në kontakt me një botë më të zhvilluar se sa ajo e vendlindjes së tyre. Përveç mundësive të pasurimit, emigrantëve shqiptarë u shtoheshin edhe mundësitë që të zgjeronin horizontin e tyre. Ata ranë në kontakt me ideologjitë dhe rrymat e mendimit politik të Evropës, ku nacionalizmi zinte një vend shumë të rëndësishëm. Ndikimet perëndimore do të përcilleshin në sinujdhesën e Evropës Juglindore edhe përmes emigracionit, i cili ushtroi një ndikim të fuqishëm kulturor dhe e bëri të njohur Perëndimin në rajon veçanërisht nëpërmjet emigrantëve të rikthyer në atdhe.³² Kështu, emigrantët shqiptarë, do të bëheshin edhe mbështetësit e parë të nacionalizmit shqiptar. Pra ata shpesh do të shndërroheshin në nationalsitë dhe në modernizues. Variabli i bashkëveprimit të këtyre dy aktiviteteve ka ndryshuar sipas individëve. Ajo që ka rëndësi në këtë rast është se emigracioni nuk është vetëm një fidanishte e nacionalizmit, ai është edhe një serë ku kultivohet modernizmi. Emigrantët, edhe atëherë kur nuk u shndërruan në nationalistë, u kthyen në promotorë të zhvillimit të lokalitetit prej nga vinin. Emigracioni fuqizoi tek ta ndjenjën e solidaritetit fisnor dhe krahinor dhe prej kësaj edhe dëshirën për të përmirësuar dhe zhvilluar bashkësinë e origjinës së tyre. Në këtë mënyrë zënë fill veprat bamirëse të emigrantëve shqiptar, të cilat para së gjithash ishin të orientuara në mbështetje të fshatit apo qytetit prej nga ata vinin.

30. AQSh, fondi 97, viti 1928, d. 22, fl. 1.

31. *Historia e Popullit...*, 69–70.

32. Leften S. Stavrianos, *vepër e përmendur*, 206.

1.2 Faktori klasor-shoqëror

Me faktorin klasor-shoqëror merret parasysh se kujt grupi social-ekonomik i përkiste shumica e atyre njerëzve që u vunë në qendër të veprimtarisë filantropike dhe bamirëse. Së pari, që të kryhet veprimtaria filantropike duhet patur si fillim, po jo domosdoshmërisht, një bazë e fuqishme ekonomike në mënyrë që përmes përdorimit të saj të vihen në jetë projekte, të cilat në plan afatgjatë do të japin efekte në shoqëri. Por që pasuria të vihet në funksion të shoqërisë shërbejnë edhe një korpus vlerash, që jo domosdoshmërisht janë të pandryshueshme. Megjithatë kultura kapitaliste e investimit dhe ideja e përmirësimit qëndrojnë në themel të shtysave që nxisin këtë veprimtari. Filantropia ka për qëllim ndryshimin. Ajo që filantropët në përgjithësi nuk pranojnë është pikërisht ruajtja e gjendjes aktuale, të cilën ata përpiqen ta ndryshojnë duke ndjekur një vizion dhe një strategji. Por jo të gjitha grupet shoqërore ndajnë të njëjtat vlera, të njëjtin vizion. Grupet që në përgjithësi janë më të prirura për të pranuar ndryshimin janë ato që i përkasin shtresës së mesme. Te ky grup shoqëror vlerat, mendësia dhe pasuria ndërthuren në funksion të filantropisë në mënyrë më të ngushtë se sa në grupet e tjera shoqërore. Shtresa e mesme, veçanërisht tregtarët e mëdhenj janë kozmopolit nga natyra. Kontaktet e dendura me Evropën Perëndimore dhe Qendrore, të cilat qysh prej fundit të shekullit XVIII po përjetonin një rritje shumë të shpejtë ekonomike dhe që nevoja për lëndë të para i shtynte të vendosnin marrëdhënie tregtare me Ballkanin³³ do të shkaktonin zhvillime të pakthyeshme në këtë të fundit. Këto lidhje do të ushtroheshin kryesisht nëpërmjet tregtarëve të krishterë ortodoksë, të cilët kryenin pjesën kryesore të veprimtarisë së tyre me pjesët perëndimore dhe qendrore të Kontinentit të Vjetër. Këta tregtarë do të kishin një ndikim revolucionar në sinujdhesë.³⁴ Edhe në rastin e Shqipërisë, angazhimi mbizotërues i kësaj shtrese ku bënin pjesë bërthamat e borgjezisë qytetare dhe fshatarët e pasuruar në emigrim, në veprimtari filantropike dhe mirëbërëse, është i dukshëm. Duke qenë më e lidhur me modernitetin dhe me investimin, ky grup e kuptoi me herët se gjithë të tjerët vlerën e arsimit dhe dijes, rrugëve të komunikimit dhe mbi të gjitha rroku i pari idenë pozitiviste të përparimit. Tradita dhe ruajtja e gjendjes ekzistuese binin ndesh me vetë interesat dhe vlerat e këtij grupi. *Filantropia në Shqipëri, gjatë kësaj kohe ishte e lidhur ngushtë me procesin dhe përpjekjet për modernizim.* Në kuadrin e temës që po trajtojmë, brenda shtresës së mesme ka

33. Charles & Barbara Jelavich, *Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit 1804–1920*, Tiranë: Dituria, 2004, 21.

34. *Po aty*, 23.

dallime në angazhimin në veprimtarinë filantropike dhe mirëbërëse. Nëse borgjezia qytetare shqiptare vazhdonte të ishte e mbyllur brenda unazës së mendësisë së izoluar të esnafit, normat e të cilit vazhdonin ende të ishin të forta në qytetet shqiptare,³⁵ elementet e pasuruar në emigracion dallonin mbi të tjerët pasi tek ata ndoshta mendësia dhe pasuria ndërthureshin më mirë në funksion të zhvillimit të filantropisë. Këta ishin të ashtuquajturit *the self-made man*, ata që pasurimin e tyre nuk ja detyronin familjes dhe prejardhjes apo arsimit formal. Pasurimi i këtyre njerëzve ishte frut i talentit, energjisë, mprehtësisë, punës së palodhur dhe dëshirës për pasuri. Mundësitë e pasurimit ishin krijuar falë një shoqërie aspak statike sikurse kishte qenë përpara shekullit XIX shoqëria evropiane.³⁶ Këta njerëz të ardhur nga hiçi u shndërruan në kundërshtarët të vendosur të shoqërisë arsitokratike³⁷ duke u kthyer në maratonmak të së resë dhe flamurtar të luftës kundër së vjetrës. Në rastin shqiptar ky grup përfaqësohej nga emigrantët e pasur shqiptarë me prejardhje modeste. Edhe ata, si homologët e tyre evropianë ishin simboli i epokës së re që po trokiste. Të përfshirë nga dëshira për të modernizuar vendlindjen ata u bënë nismëtarët e veprimtarisë së mirëfilltë filantropike në Shqipëri. Këto aktivitete, të nisura nga këta burra jashtëzakonisht të pasur dhe të suksesshëm, mund të cilësohen edhe si një përgjigje e tyre, c'ka mund të quhet edhe si vizioni i tyre, ndaj dy mënyrave kryesore të ndërtimit të traditës në shoqërinë perëndimore të kohës, që bashkvepronin paralelisht me njëra-tjetrën dhe që ishin: e para, ndryshimi i peisazhit shoqëror kërkonte mjete të reja për të garantuar kohezionin e grupeve; dhe e dyta, dinamizmi në rritje i shoqërive kërkonte edhe forma të reja të drejtimit politik që shpinin në krizë hierarkitë tradicionale që kishin udhëhequr shoqërinë deri në atë kohë.³⁸ Ne mund të gjejmë në veprimtarinë e tyre filantropike të dy këta element pasi ata do të luftonin paralelisht kundër organizimit të vjetër duke kërkuar të fusin forma të reja të kohezionit shoqëror, siç ishte kombi si qëllim e nacionalizmi si ideologji³⁹ dhe përmbysja ose riformatimi i strukturave arkaike politike që kontrollonin shoqërinë shqiptare deri në atë kohë. Kështu ndryshimet politike dhe ato shoqërore përputheshin duke e bërë veprimtarinë filantropike dhe mirëbërëse një mjet të

35. *Historia e Popullit...*, 38.

36. Eric Hobsbawm, *The age of revolution*, New York: Vintage Books, 1996, 189.

37. *Po aty*, 185.

38. Eric Hobsbawm & Terence Ranger, *The invention of tradition*, New York: Cambridge University Press, 2010, 262.

39. Kur flasim për përqafimin e nacionalizimit nga këta element nuk nënkuptohet domosdoshmërisht vetëm ai shqiptar por edhe përqafimi i nacionalizmave të tjerë si ai grek, sikurse ndoshi p.sh. me kushurinjtë Vangjel dhe Kostandin Zhapa apo Kristaq Zografin.

fuqishëm për përmbushjen e këtyre qëllimeve. Këtu arsimiti merrte një vlerë qendrore, pasi në një shoqëri moderne dija është pushtet.

Sidoqoftë veprimtaria e tyre filantropike mbante vulën e mendësisë dhe shoqërisë shqiptare dhe asaj ballkanase të kësaj periudhe, prej së cilave ata nuk u çliruan asnjëherë. Ata nuk u shkëputën dot prej grupit nga vinin dhe për rrjedhojë kjo do të reflektohej edhe në punën e tyre mirëbërëse dhe filantropike, e cila në përgjithësi u kufizua në bashkësi të caktuara krahinore apo fetare. Këtë do ta vinte re me mjaft mprehtësi edhe Faik Konica, i cili do të shkruante p.sh. se në radhët e korçarëve nacionalizimi, me të cilin aktiviteti filantropik dhe mirëbërës ishte i lidhur ngushtësisht, kishte natyrë bashkiake pasi të gjitha përpjekjet e tyre ishin të përqëndruara vetëm për të garantuar të ardhmen kombëtare të qytetit të Korçës.⁴⁰

Megjithatë, duhet nënvizuar se emigrantët që mundën të vinin pasuri nuk ishin të vetmit që zhvilluan veprimtari filantropike dhe mirëbërëse. Angazhimi drejt veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike përshkoi një pjesë të mirë të emigracionit shqiptar, i cili e kreu këtë veprimtari nëpërmjet shoqatave. Fillimisht veprimtaria e këtyre shoqatave ishte e lidhur me vendlindjen në kuptimin më të ngushtë të fjalës, pra me fshatin, qytetin ose krahinën. Emigrantët nuk kërkonin të përmirësonin jetesën e bashkëkombasve por të bashkëfshatarëve, bashkëqytetasve ose të grupit fetar që ata bënë pjesë. Pra qëllimi vetëm në pak raste ishte filantropik. Madje shumë shoqata mirëbërëse të themeluara nga emigrantët shqiptarë u ngritën mbi bazën e solidaritet lokal. Emigrantët që vinin nga një fshat apo qytet i caktuar përpiqeshin që përmes këtyre shoqatave të ndihmonin njëri-tjetrin në një vend krejtësisht të huaj dhe ku nuk kishin mbështetje. Këto shoqata ishin të ngjashme me esnafin dhe funksionet shoqërore të tij. Ato i ngjasonin një familjeje të madhe që shërbente si mbrojtje për ta. Ishte një shëmbëlltje dhe riprodhuese e marrëdhënieve të vendlindjes në dhe të huaj. Sikurse shihet, këto shoqata mirëbërëse mbartnin brenda vetes një dualitet të fortë. Përpos modernizimit të vendlindjes sipas shëmbëlltyrës së vendit ku kishin emigruar, pra përveçse importuese modelesh dhe pjesë e mekanizmit të difuzionit të kulturës, këto shoqata ishin edhe eksportuese modelesh në drejtim të kundërt, pasi ato përpiqeshin të krijonin shëmbëlltjën e mikrokozmosit shqiptar në gjirin e bashkësive shqiptare në metropolet evropiane dhe ato amerikane. Ky dualitet nuk është gjë tjetër veçse tregues i një nacionalizmi në fazë embrionale ku modernizmi dhe dashuria për vendlindjen në kuptimin e ngushtë krahinor bashkëjetonin pa e përjashtuar njëri-tjetrin.

40. Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar. Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Tiranë: Përpjekja, 2009, 276.

Në këtë mënyrë elementët nga klasa e mesme dhe veçanërisht ata të pasuruar në emigracion, ishin shumë më të prirur të investonin pa interes, pra të kryenin punë bamirëse dhe filantropike, në vendlindjen e vet me qëllim aftësimin e bashkësive prej nga vinin, për t'u përfshirë në shoqëritë më të përparuara. Këta elementë të pasuruar në vende ku një gjë e tillë bëhej e mundur nga aftësitë dhe jo nga statusi shoqëror apo besimi, prireshin të krijonin në vendlindjet e tyre një shëmbëlltë të vogël të vendit ku ishin pasuruar. Kjo nuk do të thotë që grupet apo shtresat e tjera shoqërore ishin të zhveshura nga ndjenjat njerëzore dhe se ato rrinin shpërfillëse ndaj kësaj veprimtarie por angazhimi i tyre ishte më i kufizuar se ai i klasës së mesme. Në dallim nga kjo shtresë, klasa e bejlerëve, e cila i kishte mundësitë ekonomike për të kryer veprimtari bamirëse dhe filantropike ishte shumë më pak e angazhuar. Në të vërtetë shpirti dhe etika kapitaliste e investimit ishte më e vakët në këtë segment të shoqërisë shqiptare. Të mësuar që pasurinë ta kishin të mbështetur te tradita dhe statusi shoqëror, pjesa kryesore e këtij grupi ishte më pak e prirur të kryente veprimtari filantropike, aktivitet ky që kishte për synim ndryshimin. Në të vërtetë moderniteti, dinamizmi dhe ndryshimi nuk i shërbente këtij grupi, pasi pasuria e tij ishte e mbështetur te tradita.

Përsa i përket fshatarësisë shqiptare, asaj i mungonte si pasuria ashtu edhe vlerat e nevojshme për të kryer një veprimtari të tillë. Fshatari shqiptar jetonte në një botë të ngushtë, ishte krejt i paditur dhe shpesh shumë i varfër. Kjo shtresë ishte krejt e huaj ndaj idealit të zhvillimit dhe përparimit e për rrjedhojë krejt e huaj edhe ndaj veprimtarisë filantropike. E shumta që ai mund të bënte ishte ndihma e ndërsjelltë ndaj pjestarëve të bashkësisë dhe kjo kryhej në kuadrin e solidaritet fisnor, i cili vështirë se mund të quhet bamirësi apo akoma më tej, filantropi. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë disa fshatra të krahinës së Korçës, të cilat nuk ishin fshatra klasike të hapësirës ballkanase. Qendra të tilla si Vithkuqi, Drenova, Mborja, Boboshtica etj. ishin edhe qendra të rëndësishme tregtare jo vetëm për hapësirën shqiptare por edhe përtej saj. Vetëm për të dhënë një fakt domethënës, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX kazaja Korçës me 168 fshatra kishte në total 1175 dyqane,⁴¹ ç'ka tregon qartazi zhvillimin e tregut në këtë hapësirë, e për rrjedhojë edhe lidhjet e gjera që ajo kishte me hapësirën shqiptare e atë jo shqiptare. Veç kësaj në këto qendra ishte shumë e zhvilluar dukuria e emigrimit. Tek zhvillimi i procesit të urbanizimit dhe emigracionit, qëndron arsyeja pse në këto fshatra u krijuan shoqata mirëbërëse që kishin për qëllim zhvillimin e arsimit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së fshatit.

41. *Historia e Popullit...*, 51.

1.3 Faktori fetar

Kurse kur marrim si kriter faktorin fetar këtu duhet theksuar se në asnjë rast katër besimet në të cilat kanë qenë të ndarë shqiptarët nuk e kanë penguar këtë veprimtari, madje përkundrazi, si Islami ashtu edhe Krishtërimi, në degëzimet përkatëse që janë të përçafuara nga shqiptarët, mirëbërjen e kanë në themel të tyrin pasi janë fe që mbi të gjitha frymëzojnë vëllazërimin mes njerëzve dhe theksojnë vlerat njerëzore. Pra me këtë kriter nuk merret parasysh roli që ka luajtur besimi fetar si nxitës i filantropisë dhe mirëbërësisë, por roli që ka patur përkatësia fetare gjatë kësaj periudhe në vendosjen e kontakteve me shoqërinë perëndimore. Duhet thënë se të krishterët ishin të parët që emigruan duke u përfshirë në një dinamizëm shoqëror më të dendur se sa pjesa tjetër e bashkombasve të vet. Megjithatë, edhe midis tyre kontaktet më intensive me Perëndimin i kishin shqiptarët e krahinave të Shqipërisë Juglindore që i përkisnin besimit ortodoks.

Një gjë e rëndësishme që duhet theksuar është se nëse veprimtaria mirëbërëse dhe filantropike në radhët e shqiptarëve ortodoksë kryhej nga persona laikë në radhët e shqiptarëve katolikë kjo veprimtari kryhej nga institucionet klerikale të Kishës Katolike. Në të vërtetë Kisha Katolike kishte patur qysh në mesjetë insitucione të fuqishme mirëbërëse, të cilat u fuqizuan veçanërisht pas reformës që pasoi Koncilin e Trentos pas krijimit të disa urdhrave fetarë, si Urdhri Jezuit, Oratorian apo i motrave Ursuline, thellësisht të angazhuar në aktivitete filantropike.⁴² Ky aksion ishte një gur i rëndësishëm themeli në punën dhe politikat që bënte Vatikani për forcimin e besimit katolik dhe përhapjen e tij. Kjo Kishë e ruajti pozitën e saj të fortë në këtë veprimtari përgjatë gjithë Kohës së Re e deri sot. Prej këtej mund të arrijmë në përfundimin se veprimtaria mirëbërëse dhe filantropike u krye prej individësh të veçantë apo prej shoqatash mirëbërëse të krijuara rishtas atje ku institucionet tradicionale që e kishin kryer historikisht këtë veprimtari ishin shturur apo nuk po e kryenin më atë. Rënia e esnafëve dhe mos kryerja e veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike prej Kishës Ortodokse në jug të vendit i la hapësirë veprimtarisë së individëve të veçantë apo shoqatave mirëbërëse të krijuara me nismën e bashkësive të ndryshme. Kurse atje ku institucionet tradicionale mbetën të forta, veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike të individëve u mbeti pak hapësirë. Kjo shpjegon pse në Shkodër dhe rrethinat e saj kjo veprimtari u drejtua prej institucioneve tradicionale, sikurse Kisha Katolike. Kjo nuk do të thotë që individë të veçantë nuk kanë kontribuar në këtë aktivitet por ndihmat e tyre duhet të jenë kanalizuar përmes Kishës Katolike. Ndërkaq dokumentacioni që zotërojmë nuk na lejon të gjurmojmë veprimtarinë mirëbërëse dhe filantropike të institucioneve fetare myslimane. Megjithatë

42. Robert Roswell Palmer & Joel Colton, *A History of the modern World*, New York: Alfred A. Knopff, 1983, 89.

bazuar në të dhënat ekzistuese institucionet fetare myslimane ashtu si dhe ato ortodokse mbetën shumë pak të angazhuara në fushën e filantropisë. Në radhët e popullsisë myslimane pati raste të shumta të aktivitetit mirëbërës dhe filantropik por në raport me numrin që zinte popullsia myslimane ajo mbeti në përgjithësi pak e angazhuar.

Si përfundim, filantropia dhe veprimtaria mirëbërëse përgjatë shekullit XIX deri në vitin 1920, gjeti një zhvillim më të madh ndër ortodoksët e Shqipërisë Juglindore për shkak të hapjes së tyre ndaj ndikimeve perëndimore. Këta u përfshinë më herët në procesin e modernizimit dhe elementë të dalë nga gjiri i këtij grupi siguruan të ardhura të nevojshme që mund t'i përdornin në veprimtaritë filantropike dhe bamirëse. Pra në radhët e ortodoksëve të Shqipërisë Juglindore ndodhi një përputhje mes vlerave të nevojshme dhe mundësive ekonomike që aktiviteti filantropik dhe mirëbërës të merrnin një zhvillim të spikatur dhe të dalluar. Kjo simbiozë në hapsirat e tjera të vendit, gjatë periudhës në fjalë, ndodhi më rrallë dhe do të zgjerohej vetëm në periudhat e mëvonshme.

Së fundi, duhet theksuar se analiza dhe skema e shpjegimit të kushteve që ndihmuan apo penguan zhvillimin e veprimtarisë filantropike dhe bamirëse ndër shqiptarët, është e kushtëzuar nga burimet mbi këtë çështje. Kjo analizë me daljen e burimeve të reja mund të përmbysët krejtësisht. Ndërkaq lënda që kemi në dorë na çon në përfundimet e sipërpërmendura. Është jashtë çdo dyshimi se mirëbërësia ka qenë e pranishme në krejt truallin shqiptar pasi ajo është një gur themeli për të gjitha besimet fetare të përçafuara nga popullsia shqiptare. Shumë kontribute janë dhënë për institucionet fetare dhe për të vobektit. Kjo mund të verifikohet fare mirë përmes 'Kodikut të Korçës dhe Selasforit', që fatkeqësisht është e vetmja përmbledhje dokumentare e periudhës së shekujve XVII–XIX që flet për ndihma të shumta mirëbërësie të dhëna nga popullsia e krishterë ortodokse e Korçës. Por kjo nuk ka qenë absolutisht një dukuri vetëm e kësaj pjese të popullsisë në krahinën në fjalë. Nuk ka dyshim se edhe pjesët e tjera të shoqërisë shqiptare, pavarësisht krahinës dhe besimit, kur kishin mundësi bënin dhurime të tilla pranë institucioneve fetare, për më tepër që ky aktivitet ka qenë një shtyllë e besimeve fetare të pranishme ndër shqiptarët. Por mungesa e dokumentacionit e bën të vështirë evidentimin e rasteve dhe analizën e veprimtarisë filantropike në segmente të tjera të shoqërisë shqiptare. Ngritja e kësaj veprimtarie nga shkalla e mirëbërësisë në atë të filantropisë përbën një çështje më pak të diskutueshme për shkak se veprimtaria filantropike është e lidhur me një varg procesesh modernizuese ndaj të cilave jo të gjitha trevat shqiptare u hapën njëlloj, në të njëjtën mënyrë, në të njëjtën kohë.

1.4.1 Krahina e Gjirokastrës

Një ndër filantropët më të shquar me prejardhje shqiptare është Vangjel Zhapa nga fshati Labovë e Madhe në Gjirokastrë. I lindur në vitin 1800 në një familje të varfër Vangjel Zhapa migroi fillimisht në moshën 14 vjeçare në Janinë, ku gjeti mbështetje te kushëriri i tij Vangjel Meksi, mjek i njohur në këtë qytet. Aty mësoi të fshehtat e mjeksisë, të cilat do t'i shërbenin në të ardhmen. Pas shpërthimit të Revolucionit Grek, Vangjeli u përfshi në ushtrinë greke ku fitoi edhe disa medalje për trimëri. Pas krijimit të shtetit helen ai u emërua oficer në ushtrinë greke, por Vangjeli vendosi të lëvizte prej Greqisë dhe në vitin 1830 do të emigronte në Rumani ku edhe do t'i buzëqeshte fati. Aty si pasojë e ushtrimit të detyrës së mjekut do të shtinte në dorë pasuri të patundshme, të cilat do t'i administronte me mjaft aftësi. Fitimet e jashtëzakonshme ai i investoi dhe përmes mprehtësisë që kishte në sipërmarrje i zgjeroi pronat duke u shndërruar në një nga njerëzit më të pasur të Rumanisë. Beqar i përjetëshëm, Vangjel Zhapa vendosi që pasurinë e tij ta përdorte për vepra bamirësie dhe filantropike.

Aktiviteti i tij filantropik u shtri në Rumani, Shqipërinë e Jugut, Perandorinë Osmane dhe mbi të gjitha në Greqi. Në qendër të kësaj veprimtarie ishin popullsitë ortodokse. Mecenat i artit dhe i shkencës, mbështetës i lëvizjeve revolucionare në Ballkan që synonin çlirimin e popullsisë të krishtera të Ballkanit, aktiviteti i Vangjel Zhapës është jashtëzakonisht i gjerë.



Në këtë kuadër, ai nuk qëndroi mospërfillës edhe ndaj nacionalistëve shqiptarë që kërkonin zhvillimin e kulturës dhe arsimit shqiptar. Kështu ai financoi botimin e abetares së parë shqiptare të bërë nga Naum Veqilharxhi, mbështetësi krijimit të një alfabeti të shqipes mbi baza të alfabetit grek, të gazetës shqip *Pellazgu* në Lamia të Greqisë,⁴³ financoi çeljen e shkollave në një varg fshatrash ortodokse në krahinën e Gjirokastrës dhe Vlorës, si në Labov, Dervičan, Lekël, Dhruvjan,


43. Qirjako Hila, *Vangjel Zhapa*, Tiranë: Iliria, 2003, 38.



Naum Veqilharxhi

Bubës, Hundkuq, Piqeras, Nivicë, Delvinë, Përmet, Nivan, Karjan, Filat e Qeparo. Në fokus ishte veçanërisht fshati i tij i lindjes, Labova, ku hapi edhe një shkollë profesionale për vjaza, ngriti tre çezma dhe shtroi rrugët e fshatit.

Përveç të tjerash Vangjel Zhapa financoi edhe çeljen e shkollave femërore edhe në Adrianopojë dhe Kostandinopojë, ndërtimin e Universitetit të Bukureshtit, Akademisë së Shkencave Rumune, pallatin e eksopozitave në Athinë, ndërtimin e stadiumit Olimpik në Athinë.⁴⁴



Ai financoi gjithashtu edhe rifillimin e lojrave Olimpike në Greqi,⁴⁵ punë që do të vazhdohej me nxitjen e një shqiptari tjetër nga fshati Qestorat po nga krahina e Gjirokastrës, Kristaq Zografi,⁴⁶ i cili ishte një nga njerëzit më të pasur në Greqi. Vangjel Zhapa bashkë me shumë shqiptarë të tjerë të pasur me prejardhje nga Shqipëria e Jugut

44. Iljaz Goga, *Mirëbërës shqiptarë të arsimit*, Tiranë: Albin, 2003, 111-115.

45. Qirjako Hila, *vepër e përmendur*, 29.

46. *Po aty*, 33.

si Apostol Arsaqi, Simon Sina, Jani Banga, Jani Dhima etj. ndihmuan financiarisht ndërtimin e veprave të rëndësishme publike në Athinë si Universitetin e Athinës, Bibliotekën Kombëtare dhe Akademinë greke.⁴⁷ Sikurse do të shkruante një historian grek: “asnjë copë e tokës greke nuk lindi kaq bamirës sa Epiri.”⁴⁸ Në të vërtetë, tokat e mëtuara si greke janë shqiptare dhe nëse shkojmë përtej ligjërimit ultranacionalist grek, bamirësit e mëdhenj që emërtohen si grek në shumicë ishin shqiptarë ortodoksë, të cilët për arsye të lidhjeve fetare ndihmonin dhe mbështetnin zhvillimin dhe fuqizimin e shtetit grek.

Jashtë fokusit të punës filantropike të Vangjel Zhapës nuk mbetën as objektet e kultit. Kështu në trevat shqiptare ai ndërtoi me shpenzimet e veta kishën e Leklit, atë të Papandisë në Labovë, manastirin e Tërbuqit dhe xhaminë e Hormovës kurse jashtë kësaj hapsire ndërtoi kishën e madhe të Shën Triadhës në Kostandinopojë dhe atë të Shën Vangjelizmoit në Broshteni, Rumani.⁴⁹

Sipas vullnetit të tij të përcaktuar në testamentin që ai e hartoi vetë në vitin 1860 pasuria e tij do të përdorej për vepra filantropike ku një vend të posaçëm zinte edhe Labova dhe një varg fshatrash të tjera ortodokse shqiptare, për zhvillimin e arsimit në të cilat do të përdorej pasuria e Zhapës. Për administrimin e trashëgimisë së tij u krijua në Athinë një komision, i cili nuk e kreu asnjëherë detyrën e tij. Në fakt, fatin e pasurisë së Vangjel Zhapës e pësuan edhe pasuritë e shqiptarëve të tjerë që kishin depozituar fonde në bankat greke për t'i përdorur për vepra bamirësie në vendlindje. Në pjesën dërrmuese të rasteve dëshira e tyre nuk u vërtetësua asnjëherë. Madje ato u përdorën nga Sillogu grek në dëm të çështjes kombëtare shqiptare. Mungesa e një shteti shqiptar do t'i shtynte shumë prej këtyre emigrantëve që t'i mbyllnin paratë në banka të huaja, veçanërisht greke, duke pësuar abuzime prej këtyre të fundit. Për këtë arsye një pjesë e mirë e tyre do të shndërroheshin në filantropë dhe bamirës në tentative, pasi shumë pak gjëra u ndërtuan pasi pasuria e tyre nuk u lejua të përdorej.

Nga letërkëmbimet e zhvilluara ndërmjet Ministrisë së Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme në vitin 1923 dalin edhe mirëbërës të tjerë nga fshatrat e krishtera të Gjirokastrës, të cilët kishin depozituar para në Bankën Kombëtare të Greqisë për të ngritur shkolla në fshatin Dhruvjan dhe Livinë. Ndër ta dalloheshin Qirjako Llapa dhe Petro Packa nga

47. *Po aty*, 44

48. *Po aty*, 46

49. *Po aty*, 48.

Dhruvjani si dhe ai i Dhimitër Elimit nga Livina që kishin depozituar në bankën e përmendur më sipër shifra të konsiderueshme.⁵⁰

Bamirës të tjerë nga kjo krahinë kanë qenë edhe Llukan Koçi nga Labova e Vogël, i cili kishte emigruar në Rumani dhe Ilia Harito nga Nivani. Në testamentin e tij, të hartuar në vitin 1894, Llukan Koçi caktonte një shumë prej 1000 frangash ari për mbajtjen e mësuesit të shkollës së fshatit të tij të lindjes si dhe një shumë prej 1200 frangash ari për të martuar vajzat e varfra të fshatit⁵¹ dhe 200 napolona për të ndërtuar një shkollë në fshatin e tij të lindjes⁵², ndërsa Ilia Harito e vinte pasurinë e tij në dispozicion të hapjes së një shkolle profesionale për vajza në Nivan.⁵³ Por edhe në këtë rast nuk dihet se si përfundoi çështja e përbushjes së dëshirës së këtyre dy emigrantëve shqiptarë. Në labirintin e dokumentave të kohës nuk del asgje e qartë.

1.4.2 Krahina e Përmetit

Përmeti në raport me popullsinë dhe shtrirjen territoriale është ndër trevat shqiptare, një nga rrethet që ka nxjerrë më shumë mirëbërës për arsimin.⁵⁴ Një nga mirëbërësit e parë të kësaj krahine ka qenë Pano Zoto, tregtar i madh përmetar që bënte tregti me Austrinë. Ai qysh më 1778–ën ngriti një shkollë shtatë klasëshe⁵⁵ ndërsa në vitin 1785 themeloi Llason e Përmetit përmes depozitimit në një bankë të Vjenës të një shume prej 50 mijë monedhash floriri austriake⁵⁶ nga kamata e të cilave do të ngriheshin shkolla në gjuhën greke në Përmet si dhe do të ndihmoheshin për tu martuar vajzat e varfra përmetare dhe do të mbështeteshin familjet e sakatëve.⁵⁷ Bashkëkohës i Pano Zotos ka qenë edhe Arsaq Hotova, i cili në vitin 1788 caktoi një shumë të konsiderueshme për hapjen në Përmet të një shkolle bujqësore⁵⁸ si dhe çeli një shkollë në fshatin e Hotovës, që mbahej me paratë e mbyllura në bankë prej tij.⁵⁹ Një tjetër mirëbërës përmetar që ka dhënë një ndihmë

50. AQSH, fondi 151, viti 1923, d. 54, fl. 25.

51. AQSh, fondi 195, viti 1923, d. 125, fl. 8.

52. *Po aty*, fl. 2.

53. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 119-120.

54. *Po aty*, 129

55. *Po aty*.

56. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. II, dok. 199, 99–100.

57. AQSH, fondi 151, viti 1923, d. 54, fl. 29.

58. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 134.

59. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. II, dok. 194, 96.

jo të vogël për Llason e qytetit të tij ka qenë edhe Thanas Panajoti, që më 1859—ën në testamentin e tij, i dhuroi arsimin në vendlindje një shumë prej 10.000 groshësh.⁶⁰ Arqimandriti Agathangjel është një tjetër mirëbërës i shquar përmetar, i cili në vitin 1864 i dhuroi arkës për arsimin, gjithë pasurinë e tij me një vlerë prej 20.000 groshësh.⁶¹ Stathaq Duka, tregtar dhe zejtar nga i njëjti qytet, la me testament që pasuria e tij të përdorej për të dërguar me bursa djem përmetarë të arsimoheshin në universitet dhe për të ndihmuar të vobektit.⁶² Mirëbërësi për zhvillimin e arsimit në këtë krahinë la edhe Kostandin Kena, nga fshati Lavidhi. Kena, emigruar në Egjipt, kishtë lënë me testament në vitin 1913, një shumë prej 20 mijë lirash egjiptiane të depozituar në një bankë greke, për hapje shkollash në Përmet.⁶³ Nuk kemi të dhëna se çfarë ndodhi me këtë shumë. Qeveria shqiptare, e shtyrë edhe nga problemet e mëdha financiare, nisi në vitin 1923 të interesohej për të grumbulluar paratë e lëna nga emigrantët shqiptarë për zhvillimin e arsimit në Shqipëri. Por nuk dimë se ç'hapa u ndërmorrën për të marrë pasurinë e Kostandin Kenës dhe si përfundoi kjo çështje. Të tjerë mirëbërës kanë qenë Josif Fane, që i dhuroi një shtëpi bashkësisë ortodokse në Përmet për ta shndërruar në shkollë, si dhe Petro Moçka, Dhimitraq Anastasi dhe Paskal Çali, të cilët dhanë kontribute modeste me qëllime bamirësie dhe sidomos në mbështetje të arsimit.⁶⁴ Po në funksion të arsimit bashkësia ortodokse e Përmetit kishte grumbulluar fonde për ngritjen e një shkolle për djem dhe një shkolle për vajza.⁶⁵

Një kontribut të rëndësishëm në fushën e bamirësisë ka dhënë edhe kleri bektashian por në këtë drejtim ka boshllëk dokumentacioni. Një ndër klerikët bamirës bektashian ka qenë edhe Baba Kamber Sadiku nga Përmeti. I lidhur që në shekullin XIX me Lëvizjen Kombëtare, gjatë pushtimit të Shqipërisë së Jugut në vitin 1913 prej ushtrive greke, ai u largua në Rumani ku qëndroi gjatë kohës së Luftës I Botërore. Aty ai u vra prej disa grabitësve që e kishin marrë për një njeri të pasur. Përpara se të vdiste ai la me testament që gjithë pasuria e tij të përdorej për çeljen e një shkolle fillore në teqenë e Derbendit për të mësuar dervishët, muhibët dhe fëmijët e tyre si dhe hapjen e një shkolle profesionale.⁶⁶

60. *Po aty*, dok. 199, 100.

61. *Po aty*.

62. AQSH, fondi 151, viti 1923, d. 54, fl. 29.

63. *Po aty*, fl. 11.

64. *Po aty*.

65. *Po aty*, fl. 30.

66. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 132–133.

1.4.3 Krahina e Korçës

Në fushën e mirëbërësisë dhe filantropisë krahina e Korçës zë një vend nderi. Korçarët qenë ndër të parët që filluan të emigronin jashtë trevave shqiptare dhe për rrjedhojë ndër të parët që njohën dhe kuptuan rëndësinë e zhvillimeve që po përjetonte Evropa. Në shumë raste emigrantët korçarë patën mjaft sukses në veprimtarinë sipërmarrëse duke u pasuruar shumë. Në këtë mënyrë ndërthurjen e dy elementeve bazë, pasurisë dhe vlerave, e ndeshim shpesh në radhët e tyre. Kjo bëhej edhe më e vërtetë po të merret parasysh edhe numri i madh i emigrantëve që vinin nga kjo trevë.

Por, sikurse e vërtetojnë edhe dokumentat, tradita e mirëbërësisë ka qenë fuqimisht e pranishme në krahinën e Korçës qysh prej shekullit XVIII ku popullsia e qytetit dhe e rrethinave i jepte në mënyrë të vazhdueshme ndihma institucioneve klerikale për zhvillimin e veprimtarive të tyre si dhe për ndërtimin e një vargu veprash artistike të kultit.⁶⁷ Po të marrim parasysh se në këto dokumenta është pasqyruar vetëm kontributi i pjesës së krishterë ortodokse të popullsisë së kësaj krahine atëherë e të shtojmë edhe mirëbërësinë e pjesës myslimane, që fatkeqësisht deri më tani nuk kemi dokumenta për ta verifikuar, arrijmë në përfundimin që mirëbërërisa ka qenë shumë e zhvilluar në këtë trevë. Ajo që të bën përshtypje është edhe angazhimi i madh i grave në këtë veprimtari. Këto dhurata do të vazhdonin me të njëjtin intensitet edhe në shekullin XIX.⁶⁸

Në këtë atmosferë që mbizotëronte në qendrën e madhe juglindore patjetër që do të kishte individë që do të dalloheshin për dhuratat që jepnin. Qysh në vitin 1801, ndërmjet një grupi mirëbërësish nga krahina e Korçës spikat emri i Pavllo Molenckit, tregtar voskopoari vendosur në Poloni, i cili dhuroi shuma të konsiderueshme për kishat e qytetit të Korçës dhe shkollën greke që ndodhesh aty.⁶⁹ Ai përmendet sërish në vitin 1860 për ndihmën e vazhdueshme financiare që jepte, këtë radhë nga Rusia, për shkollën e qytetit të Korçës dhe për institucionet klerikale ortodokse të këtij qyteti.⁷⁰ Ndërsa në vitin 1832 Limon Doda i bëri dhuratë shkollës së qytetit një dyqan dhe një numër të madh

67. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. I, dok. 6, 79; dok. 7, 79–82; dok. 8, 82–83; dok. 9, 83–84; dok. 12, 85–89; dok. 13, 90–94; dok. 14, 94–95; dok. 15, 95–97; dok. 16, 97–98; dok. 17, 98–101; dok. 18, 101–106; dok. 72, 149; dok. 73, 149–150; dok. 75, 151.

68. *Po aty*, vëll. I, dok. 19, 106–110; dok. 20, 110; dok. 29, 115–117; dok. 31, 117–118; dok. 66, 143–144; dok. 109, 187–188; dok. 110, 188–189; *Po aty*, vëll. II, dok. 135, 29–30; dok. 138, 31; dok. 139, 31–32; dok. 149, 39;

69. *Po aty*, vëll. I, dok. 8, 82.

70. *Po aty*, dok. 110, 188–189.

të obligacioneve të tij tregtare.⁷¹ Në vitin 1839 Anastas Bogdan Cali i dhuron shkollës së qytetit dyqane, ara dhe vreshta⁷² kurse në vitin 1849 Vasil Shrono, emigrant në Sistovë të Bullgarisë i dhuron shkollës greke të qytetit një shumë prej 1000 groshësh.⁷³

Për tu përmendur është edhe kontributi që dhanë pashallarët e derës Plasa për furnizimin e Korçës me ujë të pishëm. Kështu në vitin 1799 Mehmet Pashë Plasa ndërtoi depo uji në afërsi të Drenovës dhe më pas i shpërndau ato në lagjet e qytetit, të cilat mirëmbaheshin me shpenzimet e djemve të tij.⁷⁴



Një nga bamirësit më të njohur prej kësaj krahinë është Anastas Avram Lakçe. I lindur në qytetin e Korçës më 1820, Lakçe emigroi qysh herët në Rumani ku u pasurua shumë përmes tregtisë. Ai u tregua shumë aktiv në mbështetjen e shoqatave nacionaliste shqiptare të krijuara në kryeqytetin rumun duke financuar aktivitetet e tyre.

Ndër të tjera ai financoi botimin e disa veprave të Naim Frashërit, mes të cilave edhe *Bagëti e bujqësi*.

Lakçe dhuroi mjaft të holla edhe për ngritjen e shkollave shqipe në Korçë dhe për arsimin në përgjithësi në këtë qytet. Kështu në vitin 1863, ai së bashku me të vëllanë, Dhimitrin, i dhuruan Llasos së Korçës 300 lira turke për ngritjen e një shkolle të re.⁷⁵ Si pasojë e kësaj veprimtarie që e shihte arsimin të pandarë nga çështja kombëtare, ai u përplas me Kishën Ortodokse dhe me grekomanët e këtij qyteti.⁷⁶ Pas vdekjes, më 1890-ën, duke ndjekur vullnetin e tij, të shprehur në testamentin që ai kishte lënë, pasuria e vet u depozitua në Bankën Kombëtare Greke në Athinë. Kjo pasuri do të përdorej për një varg qëllimesh filantropike që

71. *Po aty*, dok. 25, 113.

72. *Po aty*, dok. 34, 119–120.

73. *Po aty*, dok. 86, 162–165.

74. *Po aty*, vëll. II, dok. 185, 91.

75. *Po aty*, dok. 169, 70.

76. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 26-28.

shtriheshin nga ngritja e një shkolle profesionale në Korçë, në ndërtimin e objekteve të kultit në vendlindje e në Bukuresht, për mbështetjen e klerit ortodoks në Korçë, për një spital në Athinë dhe për të ndihmuar vajzat e varfra korçare për tu martuar.⁷⁷ Por dëshira e Anastas Lakçes nuk u vërtetësua asnjëherë pasi paratë e lëna prej tij humbën në të njëjtën mënyrë si edhe ato të shumë shqiptarëve të tjerë. Në fakt, bankat greke bënë të pamundurën për të penguar investimin e këtyre të hollave në truallin shqiptar pasi një gjë e tillë binte ndesh me qëllimet dhe politikat e Athinës zyrtare.

Një tjetër korçar i njohur në punën bamirëse dhe filantropike gjatë shekullit XIX ka qenë edhe Jovan Banka, i lindur vitin në një nga familjet e parisë së këtij qyteti. Emigron që në moshën 20 vjeçare në Egjipt ku bëri pasuri të madhe me bujqësi.⁷⁸ Më pas largohet në Rumani ku e vazhdoi sipërmarrjen e tij në shtetin e ri ballkanas. Aty Jovan Banka u lidh edhe me shqiptarin tjetër të njohur, Vangjel Zhapën. Në moshë të shkuar ai do të lëvizte përfundimisht në Greqi ku do të ndërtonte një varg hotelesh të mëdha në Athinë.⁷⁹ Një pjesë të mirë të pasurisë ai e përdori që në të gjallë të tij për të përmirësuar hapësirën publike të qytetit të Korçës. Kështu ai ndërtoi ujësjellësin dhe një varg çezmash, që do të njiheshin në qytet si çezmat e Bankës⁸⁰ si dhe një gjimnaz që do të njihet deri vonë me emrin “Liceu i Bankës.”⁸¹ Ai përmendet edhe për një shumë prej 25.000 groshësh dhuruar kishës së Korçës.⁸² Përpara se të vdiste, më 1905, Banka shkruajti testamentin e tij, sipas të cilit pasuria e tij do të depozitohej në Bankën Kombëtare të Athinës dhe nga interesat e saj do të mbaheshin një numër shtretërisht në dy spitale të Athinës për të sëmurët korçarë, do të financohej një jetimore greke me qëllim që aty të strehoeshin edhe vajza korçare, si mbajtja e gjimnazit Bangjion në Korçë. Por edhe një herë tjetër paratë nuk përfunduan në destinacion dhe u keqpërdorën prej bankës greke.⁸³ Edhe vëllai i madh i Jovanit, Jorgji Banka, i cili shoqëroi të vëllanë në Egjipt, ka zhvilluar një veprimtari të gjerë mirëbërëse. Pasi vdiq në mërgim, në vitin 1859, ai i dhuroi nga pasuria e tij Mitropolisë së Korçës të holla prej një vlere prej 25.000 groshësh,⁸⁴ 50.000 groshë shkollave të Korçës dhe 25.000 të tjera qytetit të Athinës.⁸⁵

77. *Po aty*, 30-31.

78. *Po aty*, 34-35.

79. *Po aty*, 36.

80. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. II, dok. 180, 87.

81. *Po aty*, 34-36.

82. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. I, dok. 9, 83.

83. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 38-41.

84. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. I, dok. 110, 188.

85. *Po aty*, dok. 43, 123.

Po në Egjypt emigroi që në moshë fare të re Petro Kostandin Tokli, lindur në Korçë në vitin 1832. I vendosur në Kajro, ai ushtroi zejen e terziut dhe u morr me tregti. Në vitin 1872, kur ishte në moshën 40 vjeçare, për shkak të gjendjes së tij jo të mirë shëndetësore ai hartoi tetamentin ku një pjesë të pasurisë së vet ja dhuronte Llasos së Korçës për të ndihmuar vajzat e varfra korçare për t'u martuar dhe për shkollat e vendlindjes. Një pjesë tjetër të pasurisë ja dhuronte kishës së Korçës dhe jetimores së Athinës. Testamenti i tij u mbyll në Konsullatën e Mbretërisë Greke në Kajro⁸⁶ por nuk dimë asgjë mbi zbatimin e dëshirës së tij.

Ndër emigrantët korçarë të emigruar në Egjypt dhe që kontribuan në veprimtarinë mirëbërëse janë edhe Sotir Naso Poti, Jovan Cico Gjançi, Naum Mborja, Grigor Sotir Mborja, Angjelina Kostari, Kostandin Filipi e Vasil Prifti.⁸⁷

Një tjetër korçar i njohur në fushën e filantropisë është edhe Mandi Tërpo. Bashkë me vëllezërit e tij Mandi emigroi në Vllahi ku u morr me tregti. Të përfshirë në grupet nacionaliste të shqiptarëve të Bukureshtit, vëllezërit Tërpo nuk u kursyen në mbështetjen ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.⁸⁸ Mbi të gjithë ata sidoqoftë u shqua Mandi. Do të ishte pikërisht shtëpia e tij vendi ku do të çelej shkolla e parë shqipe.⁸⁹ Në testamentin që hartoi në vitin 1892 kur ishte në moshën 48 vjeçare, dy vjet para se të vdiste, ai, pjesën më të madhe të pasurisë së tij, një shumë që kapërcente vlerën e 143 mijë frangash ari, ja kushtoi botimit të librave në shqip dhe zhvillimit të gjuhës shqipe.⁹⁰ Ky është rasti i parë që njohim kur një emigrant shqiptar kapërcen caqet lokale dhe e shtrin vizionin e veprimtarisë së tij në një rrafsh shumë më të gjerë se kaq, në një plan kombëtar. Por edhe një here, për shkak të abuzimeve të të afërmëve të tij dhe bllokimit të këtyre shumave prej Parlamentit rumun, shqiptarët dhe çështja e tyre kombëtare nuk përfituan asgjë prej pasurisë së këtij patrioti.

Në listën e gjatë të mirëbërësve korçarë hyjnë edhe ata të emigruar në Greqi, si Vasil Caci, emigrant në Pire, i cili i dhuroi Llasos së Korçës në vitin 1873 një shumë prej 100 lirash angleze për çeljen e një shkolle

86. *Po aty*, vëll. II, dok. 135, 42–46.

87. *Po aty*, dok. 180, 87–88.

88. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 43–44.

89. *Po aty*, 45.

90. *Po aty*, 97.

fillore në qytet,⁹¹ vëllezërit Pandeli dhe Kostandin Cale, emigrant në Lamia, që i dhuruan në vitin 1873 shoqatës “Vëllazëria e Miqve të të Vobektëve” 1000 lira turke si dhe Ilia Cale, edhe ai emigrant në Lamia, i cili i la pas vdekjes Llasos së Korçës 100 lira.⁹²

Përveç këtyre figurave të shquara në Korçë dhe rrethinat e saj ka patur edhe një sërë figurash të tjera, të cilat kanë dhënë një kontribut jo të vogël në fushën e bamirësisë. Ndër këta mund të përmendim Irakli Duron nga Drenova, i cili ndërtoi një shkollë për vajza në qytetin e Korçës si dhe u bë nismëtari i themelimit të shoqatës mirëbërëse “Drenova”, që kishte për qëllim të ndihmonte mëkëmbjen e vendlindjes së tyre dhe me testament la 25 mijë franga ari për ndërtimin e një spitali në qytetin e Korçës, dëshirë kjo e fundit që nuk u realizua dot për shkak të abuzimeve që u kryen me pasurinë e lënë prej tij.⁹³ Po nga Drenova ishte Nikolla Kristo, klerik me funksionin protopapë, dhe i nipi Efthim Kristo, lanë 3500 lira turke nga pasuria e tyre në shërbim të fshatit të lindjes, nga të cilat 2500 do të shpërndaheshin për të varfrit dhe 1000 të tjera u mbyllën në një bankë në Bukuresht dhe me kamatën e saj do mbuloheshin shpenzimet e shkollës së fshatit.⁹⁴ Nga krahinat që bënin pjesë në qarkun e Korçës me emër të madh ka qenë edhe Kolonja, banorët e së cilës kanë shkëlqyer në shumë drejtime përfshi këtu edhe humanizmin dhe bamirësinë. Llazar Gjergj Qiriazhi, nga fshati Sorkovot, ishte një nga kolonjarët e shumtë që emigruan gjatë shekullit XIX në Rumani. Pas vdekjes së tij, në vitin 1915, ai la me testament një dhuratë prej 100 mijë lei për të ngritur një shkollë në fshatin e tij të lindjes.⁹⁵ Po nga një krahinë tjetër e qarkut të Korçës, Pogradeci, ka dalë një tjetër mirëbërës, Ali Zenel Dibra. Duke jetuar në një mjedis arsimdashës, Dibra dhuroi, menjëherë pas mbarimit të Luftës I Botërore, një pjesë të pasurisë së tij për nevojat e arsimit në qytetin e tij.⁹⁶

Kristo Kotadi është një tjetër korçar që ka dhënë një ndihmë jo të vogël në zhvillimin dhe përparimin e qytetit të tij të lindjes. I emigruar që fëmijë në Rumani ai arriti të pasurohej shumë. Megjithatë tregtia nuk ishin e vetmja veprimtari për të cilën ai ishte i interesuar. Aty ai u përfshi atje në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare me qendër në Bukuresht. Këtu Kristoja do të jepte një ndihmë të madhe në themelimin e Kishës Ortodokse Shqiptare. Në vitin 1918, pak përpara se të vdiste ai la me testament

91. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. II, dok. 169, 62.

92. *Po aty*, dok. 180, 87.

93. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 50-52.

94. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. II, dok. 190, 189.

95. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 60.

96. *Po aty*, 58.

12 mijë napolona për ndërtimin e një spitali në Korçë, të cilave ju shtuan edhe 20 mijë napolona të tjera të lëna nga kunati i tij Irakli Duro. Por këto para u bllokuan nga e motra e Kristo Kotadit dhe fondi nuk u përdor dot për qëllimin që i kishin paracaktuar këta bamirës.⁹⁷ Një tjetër emigrant korçar në Rumani, që e la pasurinë për vepra bamirëse ka qenë edhe Dhionis Naum Ndine. Në testamentin që kishte bërë përpara se të vdiste, në vitin 1917, Ndine kishte destinuar një pjesë të pasurisë së tij për të vobektit e Korçës. Në vitin 1922, Bashkia e këtij qyteti vendosi ta mbante këtë shumë të mbyllur në një bankë të sigurtë deri sa të ngrihej vlefata e leit, që kishte rënë shumë ndërkohë.⁹⁸ Tjetër bamirës nga Korça ka qenë edhe Gaqo Avramushi. Emigrant në Egjipt, Avramushi la pas vdekjes një testament ku jepte 1000 lira stërlina për ndërtimin e një spitali në Korçë.⁹⁹ Në fillim të viteve 20 të shekullit të shkuar disa shqiptarë me banim në Egjipt u përpoqën që të nxisnin bashkinë e Korçës që të merrej me çështjen e testamentit të Gaqo Avramushit, por këto përçapje nuk kishin patur sukses.¹⁰⁰ Kjo çështje do të zgjidhej në vitin 1937 kur në korrik të këtij viti Këshilli i Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi, e pranoi këtë dhuratë por me ndryshimin që në vend të spitalit, i cili ndërkaq ishte ndërtuar në këtë qytet, të ngrihej një laborator bakteorologjik.¹⁰¹ (Foto në faqen 31,32) Kjo traditë me rrënjë të hershme në Korçë do të vijonte me të njëjtin vrull edhe në periudhën që pasoi. Gjatë kësaj kohe Korça vazhdoi të ishte një nga qendrat më të fuqishme kulturore të Shqipërisë dhe mbi të gjitha shembulli kryesor dhe më i mirë i emancipimit shoqëror dhe humanizmit.

1.4.4 Krahina e Vlorës

Mirëbërësit nuk kanë munguar edhe nga krahina e Vlorës. Në veprimtarinë mirëbërëse është dalluar veçanërisht Himara. Banorët e Bregut ishin të parët nga kjo krahinë që rrahën emigracionin. E lidhur historikisht me Perëndimin, dhe posaçërisht me Italinë, qysh prej shekullit XV Himara ka qenë në mënyrë të vazhdueshme e lidhur me botën e huaj shumë më tepër se sa pjesët e tjera të krahinës së Vlorës. Ashtu si dhe në Korçë e Gjirokastër, banorët e Bregut mundën të pasuroheshin në pjesë të ndryshme të Evropës dhe në Egjipt. Aty ata mundën të binin në kontakt me zhvillimin e arsimit dhe shkencës duke kuptuar që herët vlerën e tyre.

97. *Po aty*, 55–56.

98. AQSH, fondi 151, viti 1923, d. 54, fl. 2.

99. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 52.

100. AQSH, fondi 424, viti 1923, d. 301, fl. 40.

101. *Fletorja Zyrtare*, nr. 59, 19 korrik 1937, 2.

Ndër fshatrat e Himarës spikat veçanërisht Vunoit. Vetëm nga ky fshat kanë dalë tre mirëbërës të njohur, si Gjik Bixhili, i emigruar në Rusi ku u pasurua me tregti. Që prej fundit të shekullit XIX kishte ndërtuar një shkollë në fshatin e tij të lindjes si dhe mbante me shpenzimet e veta edhe mësuesin e kësaj shkolle. Ai kishte krijuar një fond, të depozituar në një bankë greke për mirëbërësi të shumta për fshatin e Vunoit, por ashtu si edhe në raste të tjera, ky fond nuk u përdor për të përmbushur qëllimet e Bixhilit.¹⁰²

Tjetër vunoqar i njohur që u përfshi në veprimtari mirëbërëse ka qenë edhe Nase Sheti, i cili në prag të shpalljes së Pavarësisë depozitoi në Bankën Kombëtare të Greqisë për të ndihmuar institucionet fetare të Vunoit dhe hapjen e shkollave në fshatin e tij të lindjes. Edhe një herë për fat të keq këto para nuk do të përdreshin dhe në mesin e viteve '30 të shekullit të shkuar, pas shumë kërkesave të dështuara të banorëve të Vunoit për të shtënë në dorë pasurinë kjo çështje u mbyll në heshtje.¹⁰³Jani Dhima është një tjetër himariot që përmes testamentit, ja kushtoi pasurinë e tij, 80 mijë franga ari të depozituar në Bankën Kombëtare të Greqisë, veprimtarisë mirëbërëse në Himarë me fokus arsimin. Por testamenti u zhduk dhe pasuria e tij u përvetësua me qëllim mos zhvillimin e arsimit në këtë pjesë të Shqipërisë.¹⁰⁴

102. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 189.

103. *Po aty*, 189-190.

104. *Po aty*, 191.

Fletorja Zyrtare

Paftime : Per një mot në Shqipëri	Fr. ari 12
Jashta	» » 30
Një copë e javës	» » 0,30
» » » kalueme	» » 1
Për numrat special caktobet herë pas here	
Lajmerim	» » 10
Shpallje	» » 10
Shpallje ankandi per një kolonë	» » 5

Drejtimi : Ministria së P. të Mbrodshme
Redaksia së Fletorës Zyrtare

TIRANË

Telef. Gjindarmëria Nr. 14

Redaktor : ZEF M. DAJÇI

Ministri kompetent ngarkohet me shpalljen dhe
Urdhënohet për zbatimin e këtij Dekreti.

Durrës me 9 Korrik 1937.

Z O G U L

Kryeministria:

K. Kotta d. v.

Ministri i Financave:

K. Thaçi d. v.

Pranim Dhurate

Këshilli Ministruer

Vendim Nr. 74: me 2.7.1937

Këshilli Ministruer në mbledhjen e Tij të sotshme të mbajtur nën Kryesinë e Z. Koço Kotta, Kryeministër e Zv. Ministri i P. Botorë, me anizër Z. Z. Thoma Orologa, Ministri i Drejtësisë, Ekrem Libohova, Ministri P. të Jashtme, Musa Juka, Ministri P. të Mbrodshme, Kol Thaçi, Ministri i Financave, Faik Shaku, Ministri i Arsimit, Terenc Toçi, Ministri i Ekonomisë Kombëtare, pati në bledim shkresën Nr. 14/17 datë 24-VI-1937 të Drejtorisë P. të Shëndetësisë përçelë me shkresën Nr. 5866 datë 28.VI.1937 të Ministrisë së P. të Mbrodshme, me të cilën tregon se i ndëri Gaqi Avramushi, nga Korça, e banuar në Kairo, në kohën e

fundit të jetës së tij me një shpirtë madhëri dhe me ndjenjat e patriotizmes humanitare me testament të posaçëm ka dhuruar nga pasunija e tij një mijë lira sterline për ngrehjen dhe pajisjen e një Laboratoiri Bakteriologjik në qytetin e Korçës në vend lindjen e tij, tue shenue si ekzekutor per keto testament vllanë e tij Vangjel Avramushi dhe ky i fundit ka emose përfaqësues dhandrin e tij Z. Vasil Avramia Dupulet i Korçës, dhe sikundër dhëti 1000 lira sterline vllanë aproksimativisht 750 napolona, e prej kësuaj shume do të zbriten taksat relative të caktueme n'atë vend mbi trashigimin e dhuruar, dhe me këto baza në marrëveshje me Institutin Bakteriologjik të qendrës e me përfaqësuesin e ekzekutorit, e me një ingjiner kompetent, asht perplue plani i dukus ndertimi i të cillit nuk i kapërcen në 7000 fr. ari, dhe me tjerat do të kompletet me veglat dhe instrumentat e nevojshme, e ma në fund për realizimin e këtij qëllimi kërkon :

I. Pranimin e kësaj dhurate;

II. Lejimin që kjo ndërtesë të ngrehet në tokat Shtetnore në zotëimin e shtetit të Spitalit;

III. Për ngrehjen e kësaj godine të formohet një komision nën kryesinë e Prefektit, me anizër Kryetarin e Bashkisë, Drejtorin e Spitalit dhe Z. Vasil Avramit ose prej atij që ky do të delegojë;

IV. Ky komision të ketë të drejtë me adjudikuar ose me leqitasion privat, ose si t'a shofin t'arsyeshme të kujdesat për ngrehjen e kësaj godine;

V. Për shenjë mirënjohëjeje dhe për ankurazhimin ner veprat të këllija bamirësije, në godinën që do ngrehet të shenohet në një pllakë të veçantë ngjitur në hyrje emri i dhuruesit të kësaj vepre,

V e n d o s i t

Pranimimin e kësaj dhurate, dhe ia parashtron këtë Vendim Nalt Madhëris së Tij Mbretit për dekretim, dhe mbasi të dekretohet autorizon Drejtorin e P. të Shëndetësisë me vepre si ma sipër për ngrehjen dhe kompletimin me instrumentat e nevojshme të Institutit të shpër-permendon.

Z O G U L

Mbreti i Shqiptarve

Tue pamë vendimin Nr. 741 datë 2.VII.1937 të

Evidenca në lidhje me testamentin e Gaqo Avramushit, marrë nga Fletorja Zyrtare, nr. 52, 19 korrik 1937, 2.

Këshillit Ministruar, paraqite me shkresën Nr. 1672 datë 5.7.937 të Kryeministrit,

DEKRETON

Aprovimin e vendimit të sipër përmendur të Këshillit Ministruar, mbi pranimin e një dhuratie prej 1.000 (një mijë) lira sterline, në formën me testament prej të ndjerit Gaqi Avramushi nga Korça, i cili banonte në Kairo, për ngrehjen dhe kompletimin e një laboratorit Bakteriologjik në Korçë dhe Urdhënon zbatimin e tij.

Durrës, me 9 Korrik 1937.

Z O G d. v.

Kryeministri:

K. Kotta d. v.

Ministri i P. Mbrodshme

Musa Juka d. v.

Shpërblim i njihershëm

Z O G U I

Mbreti i Shqipëtarve

Tue pamë vendimin 219 datë 18 VI-937 të Komisionit Pensioneve, paraqite me shkresën Nr. 1256/L datë 2-VII-937 të Kryesis së Këshillit Ministruar, si dhe art. 1 të Dekret Ligjës datë 1-II-937 dhe art. 55 të ligjës së pensioneve civilë dhe ushtarake me datë 20 VI-934,

DEKRETON

Aprovimin e vendimit të sipër përmendur të Komisionit të Pensioneve, mbi acordimin e shpërblimit të njihershëm prej fr.ari 1500. njëmijë e pesë qind), Z- Hamdi Qeskuq, ish polie i mbetur jashtë kështit në Qershuar 1935 dhe i vuem në disponibilitet dhe urdhënon zbatimin e tij.

Durrës, me 9 Korrik 1937.

Z O G d. v.

Kryeministri:

K. Kotta d. v.

Ministri i Financave:

Kol Thaçi d. v.

Shpërblim i njihershëm

Këshilli Ministruar

Vendim Nr. 750 me 7-VII-937

Këshilli Ministruar në mbledhjen e Tij të sotshme të mbajtur nën Kryesinë e Z. Koço Kotta, Kryeministër e Zv. Ministri P. Botoze, me anëtarë Z.Z. Thoma Orologa, Ministri i Drejtësisë, Ekrem Libohova, Ministri i P. të Jashtme, Musa Juka, Ministri P. të Mbrodshme, Kol Thaçi, Ministri i Financave, Faik Shatku, Ministri i Arsimit, Terenc Toçi, Ministri Ekonomis Kombtare, pati në bisedim shkresën Nr. 9254/II ex. 36 datë 7 VII-1937 të Ministrit të P. të Mbrodshme, me të cilën tregon se, Z. Hajredin Shehu, ish Kryetar i Komunes Këlcyrës, i mbetur jashtë kështit, nuk do të merret me në shpërblim prej asaj Ministrije, proponon që të përmenduarit t'i akordohet shpërblimi i njihershëm, mbasi e ka plotësuar kohën e shpërblimit të lypur prej ligjës së pensioneve për këtë qëllim.

V e n d o s i r

Pranimin e kësaj propozimi, tue konstatue në bazë të propozimit të sipër-përmendur të Ministrin të P. të Mbrodshme se, i nën-përmendur nuk do të merret me në shpërblim të Shtetit, dhe autorizon Drejtorin e Pensioneve me shqyrtuem imëtishtë dokumentat e shpërblimit të tij, dhe në rast se ka gjithë konditat ligjore të lypura, me kryem veprimet e duhuna për t'i akorduem shpërblimin e njihershëm.

PROGRAM - PUNIMI

i

Ministrit të Ekonomis Kombtare

mbas

Buxhetit të Jashtzakonshëm

1. Bonifikime e vadije (Kap. 7 i Buxhetit)

Për bonifikime e vadije parashikohen veprimet për t'u krye e për të cilat janë në mbarim studimet, si dhe studime që kanë me fillue ndër ato vise ku popullsia vuanet nga mungesa e prodhimit. Tue pasq për bazë këtë parim, shtet fillue nga pasirimi e ndreqja e kanalit Krasniqes. Nikaj-Merter; ate të kanalit të Qashit të gjitha këtu në Pre-

Evidenca në lidhje me testamentin e Gaqi Avramushit, marrë nga Fletorja Zyrtare, nr. 52, 19 korrik 1937, 3.

1.4.5 Krahina e Beratit

Edhe nga krahina e Beratit në këtë periudhë ka patur një varg mirëbërësish të dëgjuar. Më i hershmi ndër këta mirëbërës ka qenë Abdulla Bej Koprencka, që dha një ndihmë të madhe në të holla për zhvillimin e arsimit në Berat.¹⁰⁵ Një ndër këta bamirës ka qenë edhe atdhetari i shquar Jorgji Karbunara i njohur ndryshe edhe si Bab Dud Karbunara, tregtar i madh beratas, i cili kishte vënë një pasuri të paluajtshme me vlerë 13 mijë franga ari, që kishte në Vlorë, në shërbim të shkollës në lagjen Kala të Beratit.¹⁰⁶



Monumenti i Bab Dud Karbunares, Berat

Nga dokumentat del se ndër mirëbërësit beratas, përpara fitores së Pavarësisë janë edhe Thanas Gega, që kishte dhuruar një furrë të ardhurat e së cilës të përdorëshin për shkollat e Beratit, dhe Harallambi Tutulani, që kishte dhuruar një magazinë për të njëjtin qëllim.¹⁰⁷ Por edhe emigrantët beratas kanë kryer

bamirësi, sidomos në fushën e arsimit. Kol Poshnja, emigrant në Egjipt, ka qenë një prej tyre. Ai kishte lënë të depozituar në një bankë greke një shumë të konsiderueshme për arsimin në Berat.¹⁰⁸ Ndërsa në vitin 1919 një grup qytetarësh beratas si Azis Pashë Vrioni, Sami Bej Vrioni, Faik Sanxhaktari, Teki Selenica, Qani Bej Zhabokika, Veli Libohova, Vasil Nushi, Thoma Çapo, Vasil Bakalli etj. kishin dhënë një shumë prej 275 korona ari me qëllim përmirësimin e hapësirës publike në qytetin e Beratit.¹⁰⁹

105. *Po aty*, 148–149.

106. *Po aty*, 148.

107. AQSh, fondi 195, viti 1926, d. 25, fl. 47.

108. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 149–150.

109. AQSh, fondi 195, viti 1919, d. 31, fl.1.

1.4.6 Krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe Qendrore

Fatkeqësisht dhe ndoshta edhe për mungesë dokumentacioni, shohim se në veri të krahinave që trajtuam më sipër, gjatë kësaj periudhe që po trajtojmë veprimtaria mirëbërëse bie ndjeshëm. Kjo mund të jetë, sikurse e shpjegoam në hyrje të këtij shtjellimi, pasojë e një strukture ekonomike dhe shoqërore që nuk e ndihmonte zhvillimin e kësaj veprimtarie. Popullsia në këtë pjesë të Shqipërisë, me përjashtim të qytetit të Shkodrës, nuk kishte atë lëvizshmëri sikurse edhe në jug të vendit. Përpjekjet për ndryshim ishin më të vakta. Popullsia ishte më konservatore dhe shumë më skeptike në përqaftimin e modernitetit. Këtu, me disa përjashtime si Elbasani dhe Shkodra, Lëvizja Kombëtare dhe përpjekjet për emancipim kulturor ishin më të zbehta. Kjo, e ndërthurur me rolin jashtëzakonisht të rëndësishëm që luanin në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike bejlerët, bajraktarët dhe kleri mysliman konservator, transformoheshin në pengesa serioze për çuarjen përpara të këtyre proçeseve në Shqipërinë Qendrore dhe të Epërme. Në kushtet kur veprimtaria bamirëse në këtë periudhë ka qenë ngushtësisht e lidhur me modernizimin dhe nacionalizmin, kuptohet që veprimtaria e individëve të veçantë për të kryer punë bamirëse apo filantropike ishte shumë e vështirë, për më tepër po të kemi parasysh se këta elementë vinin në përgjithësi nga shtresa e mesme e sipërmarrësve e cila në këto anë të Shqipërisë, me disa përjashtime, ishte krejt e pazhvilluar dhe për rrjedhojë krejt e paaftë për të ndryshuar gjendjen ekzistuese. Madje në mjaft raste ajo ishte po aq konservatore sa edhe shtresat e tjera të popullsisë. Asaj i mungonte si forca financiare ashtu edhe kozmopolitanizmi.

Nga Elbasani spikat emri i Ali Adil Agjah Bej Biçakçiu që është mirëbërsi më i madh dhe i hershëm elbasanas.¹¹⁰ Korife i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Ali Bej Biçakçiu u ndoq nga Esat Pashë Toptani në vitin 1914 dhe i'u drejtua Italisë. I sëmurë rëndë kthehet në Vlorë në vitin 1918, ku edhe vdes. Në testamentin që e hartoi në Romë në 4 qershor të vitit 1918, ia dhuroi gjithë pasurinë e tij arsimit kombëtar shqiptar duke nxitur edhe trashëgimtarët e tij që të hiqnin dorë nga pasuria në emër të këtij qëllimi.¹¹¹ (Foto në faqen 35) Ky është i pari dhe i fundit rast filantropie i përmasave të tilla. Është i pari rast kur një shqiptar ja kushton gjithë pasurinë e tij arsimit dhe i pari rast kur e gjithë pasuria lihet për arsimin kombëtar. Kjo merr një rëndësi edhe më të madhe po të kemi parasysh se Ali Adil Agjah Bej Biçakçiu vinte nga radhët e bejlerëve.

110. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 152.

111. AQSh, fondi 195, viti 1918, d. 62, fl. 1.

për Arsimia komotar.

I lutem kujt do qi pas ligjës mundet me i përime ndo
nji trashigim nga malli i em,të heqë dorë tyke u bashkue eune
ai në qellimin e sheajtë qi më shtyni mue me lanë kste testament.

Në qoftë se shqiparja ka me pasë frezikan me hje non
szgjedhën e nji shtati të huej i cilli nuk ka me dhanë leje për
shkolla kombtare ky testament s'do të ketë as nji vjeftë,do të
qunet sikur s'është fare.

komë,4 qershor 1918.

Testamedari

Ali Agjah

Për dëshmie

Mustafa Asim Kruja,

Gostadin Kotte,

~~Leon MDSHJE,~~

Kostantin Cipjs,

Sif Nosi.

*Vertetohet njësia
me origjinalin
Ali Agjah
shkruar në 4 qershor 1918.*

Testamenti i Ali Adil Agjah Bej Biçakçiu, marrë nga AQSh, fondi 195, viti 1918,
d. 62, fl. 1.

Nga të dhënat që zotërojmë në vitin 1909, Haxhi Ahmeti nga Durrësi la një të tretën e pasurisë së tij për zhvillimin e arsimit kombëtar në qytetin e tij.¹¹² Tirana ka raste më të shënuara si ai pinjollëve të familjes Toptani, Sermedi Said Toptani dhe Murat Toptani. I pari i arsimuar në Paris dhe i dyti piktor nuk ishin përfaqësues tipik të shtresës prej nga e cila rridhnin. Me një largapamësi shumë më të spikatur se sa shumë prej bashkohësve të vet, ata ndihmuan zhvillimin e arsimit në krahinën e Tiranës dhe në vise të tjera të Shqipërisë si p.sh. në Shkodër.



Murati do të financonte botimin e abetareve në Manastir dhe mbështeti pa rezerva shoqatën nacionaliste shqiptare “Bashkimi”. Veç kësaj, të dy këta eksponentë të familjes së njohur tiranase, kryen bamirësi për familjet e varfra tiranase.¹¹³ Të tjerë bamires në Tiranë kanë qenë edhe Jusuf dhe Osman Elezi, që rridhnin nga një familje e pasur tregtarësh e këtij qyteti. Të lidhur me Lëvizjen Kombëtare dhe mbështetës të modernizimit të vendit dhe sidomos zhvillimit të arsimit kombëtar dy kushërinjtë financuan ngritjen e disa shkollave shqipe, ndër të cilat një shkollë për vajza,¹¹⁴ c’ka nuk ishte diçka e pakët për mentalitetin e mbyllur dhe konservator në Tiranën e kohës. Ndërsa Osmani do ta vazhdonte edhe në vitet e mëvonshme veprimtarinë e tij mirëbërëse, Jusufi i përfshirë në politikë kaloi nëpër një kalvar të tërë peripecish, të cilat e penguan të vazhdonte aktivitetin mirëbërës. Tjetër personalitet i njohur është edhe Hoxha Zyber Hallulli, i cili, me detyrën e kryetarit të bashkisë së Tiranës, krijoi, me mbështetjen e autoriteteve austriake që kontrollonin këtë pjesë të Shqipërisë në atë kohë, në 28 nëntor të vitit 1917 jetimoren e parë në Shqipëri.¹¹⁵


112. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 151.

113. *Po aty*, 172-173.

114. *Po aty*, 174.

115. Pirro Gjerasi, *Jetimoren e Shqipërisë*, Tiranë: FLESH, 1999, 14.

Nga krahina e Dibrës për periudhën në fjalë kemi Ismail Pashën, deputet i Dibrës në Parlamentin turk, i cili dhuroi në vitin 1909 një shumë prej 2000 lirash turke për zhvillimin e arsimit në krahinën e Dibrës. Ndërsa nga rajonet e Kosovës kemi atdhetarin e shquar Hasan Bej Prishtina, i cili në vitin 1909 la 5% të ardhurave nga pronat e tij dhe rrogën që merrte si deputet për zhvillimin e arsimit në Shqipëri. Këtë



Hasan Prishtina

veprimtari, Hasan Prishtina do ta kryente edhe në vitet e mëvonshme në mbështetje të arsimit shqip sidomos në Kosovë.¹¹⁶

Sikurse shihet në Shqipërinë Qendrore dhe të Epërme ndeshim raste kur pinjollë të familjeve të mëdha bejlerësh janë përfshirë në fushën e mirëbërësisë. Por këta ishin pikërisht pjesë e grupit të nacionalistëve dhe puna e tyre mirëbërëse ka qenë ngushtësisht e lidhur me idealin e tyre për pavarësinë e Shqipërisë dhe zhvillimin e saj si shtet i pavarur.



Hasan Prishtina me Ismail Qemalin dhe Qazim bej Vlora

Në krahinën e Shkodrës me emër në fushën e mirëbërësisë ka qenë familja e shquar Kazazi, të cilët kanë dhënë një mbështetje të vazhdueshme për familjet e varfra të qytetit të Shkodrës. Të tjerë bamirës shkodranë kanë qenë edhe Kulaç Begu e Zef Zorba, që kanë financuar ndërtime urash, shtrime rrugësh, meremetime kalldrëmësh apo Kol Kryqiti dhe Filip Pema, të cilët kanë kontribuar në ndërtim e një spitali në Shkodër.¹¹⁷ Por në Shkodër kanë qenë shumë aktive sidomos shoqëritë mirëbërëse të organizuara nga kleri katolik.

116. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 167.

117. *Po aty*, 168-169.

1.5 Shoqata bamirëse dhe filantropike

Përpara se të shtjellojmë veprimtarinë e shoqërive bamirëse duhet të sqarojmë paraprakisht disa kriterë që janë marrë për bazë në përzgjedhjen e tyre ndër një shumësi shoqërisht të themeluar gjatë kësaj periudhe. Së pari në një masë të gjerë shoqëritë e themeluara në diasporë dhe brenda vendit kishin karakter politik. Ato ishin të lidhura me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare e cila u bë strumbullari i gjithë jetës kulturore dhe politike të shqiptarëve gjatë kësaj periudhe. Veprimtaria bamirëse dhe filantropike nuk mund të bënte përjashtim. Në vargun e gjatë të shoqërive të themeluara gjatë kësaj kohe janë përzgjedhur ato shoqëri, veprimtaria e të cilave ka qenë përveçse politike edhe kulturore dhe shoqërore. Jo të gjitha shoqëritë nacionaliste kryenin veprimtari mirëbërëse. Vetëm një pjesë e tyre ishin të angazhuara në këtë drejtim. Një pjesë e madhe përpiqeshin të organizonin luftë të armatosur, një pjesë tjetër aksione politike e kështu me radhë. Shoqëritë e përzgjedhura kanë qenë ato të cilat në programin e tyre kishin të përcaktuar edhe ndërtimin e atyre institucioneve, si shkollat, si dhe zhvillimin e atyre veprimtarive, si përhapjen e librave dhe zhvillimin e letërsisë shqiptare, impakti pozitiv i të cilave në jetën e shqiptarëve të thjeshtë do të ishte shumë i madh. Ato do të ndryshonin në mënyrë rrënjësore jetën e mbyllur dhe rurale që ata, shqiptarët, kishin patur deri atëherë.

Në dinamikën e zhvillimit të shoqërive të themeluara në diasporë shohim se në pjesën më të madhe të rasteve, përse kohë themeloheshin me nismën e emigrantëve të cilët lidheshin me njëri-tjetrin mbi bazën e afrisë fisnore apo krahinore, këto shoqëri i kishin të kufizuara qëllimet e tyre në një hapësirë të ngushtë gjeografike që përputhej me fshatin apo qytetin e tyre të lindjes. Duhet patur parasysh se në përgjithësi këta emigrantë ishin të paarsimuar dhe për rrjedhojë horizonti i tyre ishte mjaft i ngushtë. Këto shoqëri merrnin një karakter kombëtar atëherë kur ato krijoheshin me nismën e intelektualëve nacionalistë shqiptarë, të cilët kishin aftësinë të hapnin horizontin e ngushtë të emigrantëve, të ndiznin tek ata entuziazmin nacionalist, duke e kanalizuar punën e këtyre shoqërive në funksion të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Në këtë shtjellim do të përqëndrohemi tek identifikimi dhe shpalosja e qëllimeve të këtyre shoqërive. Nëse thellohemi më tej në veprimtarinë e kryer nga ato, do të kalonim caqet si përse i përket përmasave ashtu edhe qëllimit të këtij studimi.

Së fundmi është për t'u vënë në dukje se mjetet financiare këto shoqëri i siguronin përmes kuotave të anëtarësisë, nga dhurimet që u bëheshin si dhe nga përqindjet që merrnin në banka pas depozitimit aty të fondeve të mbledhura. Kjo është dalluese për të gjitha shoqëritë prandaj kjo çështje nuk do të adresohet më poshtë në studim.

1.5.1 Shoqëri të themeluara në trevat shqiptare

Themelimi i shoqërive mirëbërëse në trevat shqiptare nuk përbënte ndonjë risi. Tradita e këtyre shoqërive ekzistonte që herët, sidomos në qendrat urbane, ku esnafet kishin arka të tyre për këto qëllime. Edhe pse, në kuadrin e esnafit ku veprimtaria bamirëse ishte e kufizuar brenda kuadrin të grupeve të caktuara profesionale, ato shërbenin si një bazë e fortë për kapërcimin e kësaj guacke dhe për shtrirjen e tyre brenda një kuadri më të gjerë. Një rast i tillë është i dokumentuar në qytetin e Korçës që në vitin 1758 kur një varg esnafësh grumbulluan një fond që do ta përdornin për çeljen e një shkolle të përbashkët për djem ku mund të studionte kushdo.¹¹⁸ Në hapjen e kësaj shkolle ndihmoi edhe paria e Korçës.¹¹⁹ Kështu veprimtaria mirëbërëse dhe filantropike për arsimin shërbeu si një nga nga format e para për bashkërendimin e veprimtarisë bamirëse ndërmjet grupeve të ndryshme profesionale, c'ka shënonte, ose më mirë pasqyronte, fillimin e ndryshimeve në jetën qytetare, në strukturën shoqërore të popullsisë urbane dhe për rrjedhojë edhe identitetit të grupeve. Brenda këtij kuadri do të zhvilloheshin edhe shoqëritë e ndryshme bamirëse që u themeluan gjatë shekullit XIX.

Në përgjithësi këto shoqëri do të krijoheshin në qendrat urbane apo pranë tyre, në fshatra të lidhura me tregun qytetar apo në ata me emigracion të spikatur. Pra në ato qendra që kishin kapërcyer ekonominë natyrore dhe ishin përfshirë në ekonominë e mallrave. Kjo u siguronte atyre mundësi për të akumuluar kapital dhe për të krijuar fonde që mund t'i përdornin për veprimtari bamirëse. Duhet theksuar gjithashtu se në shumë raste, këto shoqëri e ruajtën karakterin e ngushtë lokal ose fetar si nga përbërja ashtu edhe shtrirja e veprimtarisë. Nuk munguan edhe shoqëritë mirëbërëse të themeluara nga institucione fetare, por duhet theksuar se ato u kufizuan vetëm në radhët e Kishës Katolike.

1.5.1.1 Shoqëri të themeluara në Korçë

Edhe në themelimin e shoqërive mirëbërëse, krahina e Korçës zë një vend nderi. Dhuratat dhe ndihmat e vazhdueshme për përmirësimin e jetës së qytetit ishin të zhvilluara që në shekullin e XVIII dhe do të vazhdonin edhe gjatë shekullit që vijoi. Në vitin 1831 banorët e varoshit të Korçës morën përsipër që paratë që do të merrnin nga kamata vjetore e huasë së dhënë kishës t'i përdornin për shkollën e qytetit¹²⁰ kurse

118. *Po aty*, 25.

119. *Po aty*, 26.

120. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. I, dok. 21, 111.

më 1857 komuniteti ortodoks korçar grumbulloi fonde për ndërtimin e një shkolle për vajza.¹²¹ Nga të dhënat që kemi, shumica e këtyre shoqërive kanë dalë pikërisht nga kjo hapësirë. E para ndër to ka qenë arka popullore e Korçës, e njohur me emrin Llaso, e themeluar nga komuniteti ortodoks i këtij qyteti.¹²² Mbledhja e parë e dokumentuar e kësaj shoqërie është mbajtur në vitin 1849¹²³ por sipas kujtimeve ajo është themeluar qysh në vitin 1830.¹²⁴ Ndërkaq statuti i saj që kemi në dorë është i vitit 1875.¹²⁵ Detyrat e Llasos ishin mbulimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen e shkollave të qytetit,¹²⁶ i pagesave të mësuesve¹²⁷ dhe përhapja e arsimit në gjuhën greke në të gjitha shtresat dhe gjinitë e qytetit.¹²⁸ Me qëllim pasurimin e arkës dhe mbulimin e të gjitha shpenzimeve dhe zbatimin e krejt projekteve, Llasua gëzonte të drejtën të vinte dorë mbi tepricat e krijuara nga dhuratat që u bësheshin institucioneve fetare ortodokse.¹²⁹ Në arkë depozitoheshin të holla dhe prona të patundshme nga pjesa më e madhe e bashkësisë ortodokse korçare dhe thuajse gjithë të moshuarit linin pas vdekjes, me testament, shuma të hollash për Llason.¹³⁰ Në grumbullimin e fondeve ishte parashikuar të kontribuonin edhe emigrantët korçarë në Egjipt.¹³¹ Po në fushën e arsimit kjo shoqëri hartoi edhe një statut për shkollat, sipas të cilit ajo do të kujdesej të çelte në qytetin e Korçës shkolla të të gjitha niveleve¹³²si dhe në bashkpunim me mësuesit të hartonte programin mësimor¹³³.

Nga dokumentat del se edhe diaspora voskopjare, e cila ruajti një pozitë të fuqishme ekonomike edhe pas shkatërrimit të qytetit, depozitoi në Bankën e Sinës në Vjenë një shumë të hollash nga kamata e të cilave do të mbaheshin shkollat e Korçës, të ardhura këto që nuk u përdorën asnjëherë për qëllimin në fjalë pasi banka vjeneze nuk i çliroi fondet dhe nuk lejoi përdorimin e tyre.¹³⁴

121. *Po aty*, dok. 45, 125.

122. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 21.

123. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. I, dok. 46, 125.

124. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 21.

125. Petraq Pepo, Mihallaq Pela, *Kanunorë të shoqërive shqiptare [1870–1936]*, Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 2007, dok. 3, 27.

126. *Po aty*, neni 1, 23.

127. *Po aty*, neni 9, 24.

128. *Po aty*, neni 2, 23.

129. *Po aty*, neni 9, 24.

130. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 21.

131. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. I, dok. 46, 125.

132. P. Pepo, M. Pela, *vepër e përmendur*, dok. 3, neni 1, 25.

133. *Po aty*, neni 8, 26.

134. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. II, dok. 189, 93.

Në vitin 1870 në qytetin e Korçës themelohet shoqëria “Vëllazëria e miqve të të vobektëve” që kishte për qëllim ndihmën e të vobektëve pavarësisht nga feja apo kombësia.¹³⁵ Mungesa e dallimeve të tilla për grupin që synonte të mbështeste do të shprehej edhe në përbërje. Kështu anëtarësimi në këtë vëllazëri nuk kushtëzohej nga profesioni apo feja,¹³⁶ c’ka e bënte atë një shoqëri të vërtetë filantropike. Veprimtaria e saj nuk do të kufizohej vetëm në ndihmën ndaj të mjerëve por edhe në mbështetjen për hapjen e shumë shkollave në krahinës së Korçës.¹³⁷

Revolucioni xhonturk në vitin 1908 krijoi ndër atdhetarët shqiptarë iluzionin se që prej atij çasti ishin hapur rrugë të mëdha për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe. Shpallja e Kushtetutës dhe rrëzimi i Sulltan Abdylhamitit II ishin sinjalet e ndryshimeve të mëdha në jetën e popujve të Perandorisë Osmane. Këtyre ndryshimeve ju përgjigjën menjëherë në trevat shqiptare. U krijuan një varg shoqëriësh arsimore dhe atdhetare ndërmjet të cilave kishte edhe nga ato me natyrë hibride ku qëllimet arsimore dhe atdhetare ndërthureshin me ato mirëbërëse. I tillë ishte “Klubi i diturisë shqipe” themeluar në 15 shtator të vitit 1908, qëllimi i të cilit ishte hapja e shkollave shqipe në mbarë vendin dhe shtypja e librave për to.¹³⁸ E ngjashme me “Klubin e diturisë shqipe” ishte edhe shoqëria tjetër arsimore dhe bamirëse korçare “Përparimi”, që kishte për qëllim të zbatonte vendimet e Kongresit të Elbasanit për hapjen e shkollave shqipe në qytetin e Korçës.¹³⁹ Një tjetër shoqëri bamirëse dhe arsimore me karakter lokal ishte edhe “Shoqëria shkollore e Korçës” e themeluar në 5 tetor 1911. Qëllimi i saj ishte ngritja e shkollave të mesme me karakter të përgjithshëm, tregtar dhe bujqësor, shkollave fillore në fshatrat e Korçës si dhe dërgimi i studentëve shqiptarë me studime në universitetet evropiane për drejtimet pedagogji, filologji, tregti dhe bujqësi.¹⁴⁰ Kjo shoqëri ishte e hapur ndaj të gjithë atyre, përfshi edhe të huaj, që dëshironin arsimimin e të rinjve shqiptarë.¹⁴¹ Po në vitin 1911 në Drenovë themelohet vëllazëria mirëbërëse e rinisë së Drenovës “Shën Kolli”, e cila kishte si qëllim mirëmbajtjen e shkollave të fshatit, kishave si dhe përmirësimin e hapësirës publike të tij.¹⁴² Anëtarësimi në këtë shoqëri ishte i hapur për të gjithë ortodoksët që banonin në krahinën e Korçës.¹⁴³

135. P. Pepo, M. Pela, *vepër e përmendur*, dok. 1, neni 1, 15.

136. *Po aty*, neni 3, 15.

137. *Po aty*, 18.

138. *Po aty*, dok. 34, neni 30 & 35, 123.

139. *Po aty*, dok. 43, nyja 2, 147.

140. *Po aty*, dok. 54, nyja 2, 187.

141. *Po aty*, nyja 3, 187.

142. *Po aty*, dok. 55, nyja 1, 191.

143. *Po aty*, nyja 5, 191.

1.5.1.2 Shoqëri të themeluara në Përmet

Sikurse u përmend edhe më sipër Përmeti ka qenë një zonë arsimdashëse. Varfëria e krahinës e pengonte zhvillimin e arsimit dhe ngritjen e shkollave¹⁴⁴ por kjo nuk i ndali përmetarët të mbledhnin fonde për këtë qëllim. Në këtë kuadër, falë ndihmës dhe mbështetjes së filantropit përmetar Pano Zoto në vitin 1785 u themelua llasua e këtij qyteti.¹⁴⁵ Në arkën e Llasos derdhën të holla një varg mërgimtarësh përmetar, të cilëve u priu fati jashtë vendit. Por llasua nuk u mbajt vetëm me shumat e derdhura prej tyre. Në vitin 1874 banorët e qytetit grumbulluan të holla dhe ngritën edhe një shkollë për vajza, në ngritjen e së cilës ndihmuan edhe përmetarët e emigruar në Stamboll.¹⁴⁶

1.5.1.3 Shoqëri bamirëse në Gjirokastrë

Përsa i takon Gjirokastrës kemi informacion vetëm për një shoqëri mirëbërëse e cila ishte gjithashtu një qendër e lëvizjes atdhetare në krahinën e këtij qyteti. Ajo u formua duke patur si shembull klubin “Bashkimi” të Manastirit. Ajo dha një ndihmesë të rëndësishme në zhvillimin e arsimit dhe kulturës në Gjirokastrë.¹⁴⁷

1.5.1.4 Shoqëri të themeluara në Vlorë

Lufta Ballkanike jo vetëm i ktheu trojet shqiptare në një arenë lufte, por popullsia shqiptare u bë pre e masakrave të pashembullta, përballë të cilave bota e qytetëruar qëndroi shpërfillëse. Popullsia e Shqipërisë së Jugut u vu në shënjestrën e ushtrive greke, të cilat donin të aneksonin krahina të tëra të jugut të vendit. Duke ndjekur politikën e zjarrit dhe të fushës djegur nën presionin e bajonetave dhe trupave të parregullta të thirrura enkas për të kryer spatriim etnik, një pjesë e madhe e banorëve të krahinës së Korçës u larguan dhe u vendosën në Vlorë, ku u strehuan për shumë muaj. Kushtet e tyre të mjeruara mobilizuan gratë vlonjate që të themelonin në atë kohë një shoqëri mirëbërëse Zonjash, kryetare e së cilës ishte e shoqja e Syrja Bej Vlorës. Kjo shoqëri kishte për qëllim grumbullimin e ndihmave për bashkëkombasit e tyre, të vendosur në Vlorë nga anët e tjera të Shqipërisë së Jugut, të cilët ndodheshin në një gjendje të mjerë.¹⁴⁸

144. Petraq Pepo, *vepër e përmendur*, vëll. II, dok. 198, 98.

145. *Po aty*, dok. 199, 99.

146. *Po aty*, dok. 198, 99.

147. *Shoqëritë patriotike shqiptare jashtë atdheut për arsimin dhe kulturën kombëtare [1879 – 1912]*, Tiranë: 8 nëntori, 1987, dok. 229, 307.

148. AQSh, fondi 447, viti 1914, d. 205, fl. 1.

1.5.1.5 Shoqëri mirëbërëse të themeluara në Shkodër

Në Shkodër, në fushën e veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike spikasin shoqëritë e ngritura me nismën e klerit katolik. Veprimtaria e tij në mbështetje të njerëzve në nevojë ka qenë e gjithanshme dhe në shumë aspekte ajo ka qenë në pararojë të ngritjes së institucioneve me qëllime të tilla. Kështu në vitin 1877 me interesimin e shoqatave katolike shkodrane u ngrit Kolegji Shën Françesk Saverio që kishte për qëllim kujdesin për jetimët. Mbështetjen lëndore nga rrethet katolike të qendrës së madhe urbane të Shqipërisë Veriperëndimore, ky kolegji do ta merrte deri në vitin 1889 kur do të fillonte të financohej prej autoriteteve austriake.¹⁴⁹ Në fund të luftës ky kolegji ngriti edhe një jetimore, e cila do të merrte emrin “Zemra e Shenjtë”. Kjo jetimore do të financohej në përgjithësi nga bamirës italianë dhe më vonë prej qeverisë italiane.¹⁵⁰

Një shoqëri mirëbërëse dhe filantropike ishte edhe “Kongregacioni i Zojës së Papërlyeme” i themeluar në 10 mars të vitit 1880, që kishte për qëllim ndihmën ndaj të varfërve të qytetit¹⁵¹ dhe edukimin me moralin katolik të rinisë.¹⁵² Në vitin 1889 në Shkodër themelohet prej shoqërive katolike “Rrethi i Shën Jozefit” që kishte për qëllim të ndihmonte fëmijët e rrugës. Për këtë arsye ishte ngritur edhe një mensë.¹⁵³ Shoqëri të tjera mirëbërëse ishin edhe ajo e “Shën Rozarios” e themeluar nga etërit françeskan dhe “Të bijat e Maries” të themeluar nga Motrat Stigmatine. Një kontribut shumë të madh ka dhënë edhe shoqëria mirëbërëse “Buka e Sh’na Nout” e themeluar në vitin 1897 e që deri në vitin 1910 kishte shpërndarë ndihma për të varfrit me një vlerë prej 500 mijë liretash të kohës.¹⁵⁴

Përsa i përket shoqërive mirëbërëse civile për t’u përmendur është “Gruaja shqiptare” e themeluar në 2 gusht të vitit 1920. Duke nisur që prej vitit 1910, kur shpërthyen kryengritje antiosmane të Malsisë së Mbishkodrës dhe më vonë, gjatë Luftës I Ballkanike, Luftës I Botërore dhe përplasjeve që vijuan me ushtritë jugosllave pas mbarimit të Luftës së Madhe, Shkodra ka qenë një nga qytetet më të goditura në Shqipëri. Kjo ka qenë arsyeja që gratë shkodrane vendosën të krijonin këtë shoqëri që kishte për qëllim të ndihmonte ushtarët shqiptarë që luftonin kundër jugosllavëve në veri të vendit.¹⁵⁵ Kjo shoqëri ishte e hapur dhe anëtarësimi në të nuk bëhej mbi baza fetare gjë që duket nga përbërja e themelueseve të saj.

149. Pirro Gjerasi, *vepër e përmendur*, 16.

150. *Po aty*, 17.

151. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 169.

152. P. Pepo, M. Pela, *vepër e përmendur*, dok. 61/1, 220–223.

153. Pirro Gjerasi, *vepër e përmendur*, 17.

154. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 169.

155. P. Pepo, M. Pela, *vepër e përmendur*, dok. 105, nyja 2, 423.

1.5.2 Shoqëri të themeluara në diasporë

1.5.2.1 Shoqëri të themeluara në Rumani

Shoqatat e para mirëbërëse shqiptare janë themeluar në kolonitë shqiptare në Ballkan. Këtu spikat veçanërisht kolonia në Rumani. Pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit veprimtaria e rretheve atdhetare u zhvendos tërësisht në diasporën shqiptare. Kjo veprimtari ishte në pjesën më të madhe të saj kulturore dhe synonte veçanërisht zhvillimin e arsimit dhe lëvrimin e gjuhës shqipe si dhe zgjidhjen e problemit të alfabetit për të hedhur themelet e standartizimit të gjuhës shqipe. Zgjerimi dhe dendësimi i punës kulturore dhe arsimit në shqip shiheshin si mjetet kryesore që do të zhvillonin ndjenjën kombëtare të shqiptarët dhe intelektualët nacionalistë shqiptarë do të gjenin mbështetjen e munguar në Shqipëri për të vërtetësuar ëndërrën e tyre për krijimin e një shteti-kombi shqiptar dhe shmangien e mundësisë së copëzimit të tokave shqiptare mes fqinjëve. Në këto rrethana, kolonia shqiptare në Rumani do të kishte një rol të rëndësishëm dhe do të jepte një kontribut të pazëvendësueshëm. Kjo, si për arsye të numrit të madh të shqiptarëve atje, ashtu edhe për fuqinë e tyre financiare dhe mbështetjen që ata i jepnin Lëvizjes Kombëtare. Në këtë kuadër u formuan shoqëri qëllimi i të cilave ishte nacionalist por brenda të cilave komponenti mirëbërës ishte i pranishëm. Ato grumbullonin fonde me qëllim përhapjen e dijes dhe botimin e librave e çeljen e shkollave. Në këto veprime nuk kishte asnjë interes material, e për këtë arsye përmendja e këtyre shoqërive si pjesë e këtij studimi do të ishte e pamohueshme. Nëse veprimtaria e këtyre shoqërive përfshinte brenda spektrit të vet një gamë të gjerë qëllimesh dhe objekti i punës së tyre kapërceu guackën e ngushtë krahinore apo fetare dhe mori një karakter gjithmonë e më të gjerë, më kombëtar, nuk munguan as ato shoqëri synimet e të cilave ishin më të ngushta, më lokale. Jo të gjitha shoqëritë e krijuara kishin qëllime patriotike. Kishte edhe shoqëri me karakter mirëbërës ku prejardhja apo përkatësia fetare ishin faktorët bazë që lidhnin dhe i shtynin emigrantët të krijonin këto shoqëri. Mbështetja ndaj njëri-tjetrit dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për bashkëfshatarët e tyre ishte qëllimi kryesor i këtyre shoqatave.

Ndër shoqëritë e para të krijuara në Rumani ka qenë “Drita” e themeluar në Bukuresht më 1884. Qëllimi i kësaj shoqërie ishte financimi i botimeve në gjuhën shqipe dhe ndërtimi i shkollave shqipe në trevat shqiptare.¹⁵⁶ Anëtarësimi në këtë shoqëri kufizohej vetëm te shqiptarët ose personat me prejardhje shqiptare pa dallim feje, ndërsa

156. *Po aty*, dok. 10, neni 2 dhe 3, 31.

për personat me kombësi jo shqiptare pranimi do të bëhej me votë konsultative.¹⁵⁷ Një tjetër shoqëri bamirëse dhe atdhetare e themeluar po në Bukuresht ka qenë edhe “Dituria”, qëllimet e së cilës kanë qenë të njëjta me ato të shoqërisë “Drita.”¹⁵⁸ Më në fund pas sheshimit të shumë mosmarrëveshjeve në gjirin e kolonisë shqiptare të Bukureshtit këto dy shoqëri bashkë me shoqërinë tjetër “Shpresa” do të bashkoheshin më 7 dhjetor të vitit 1906 në një shoqëri të vetme me emrin “Bashkimi,”¹⁵⁹ që do të kishte të njëjtat qëllime si edhe shoqëritë nga bashkimi i të cilave kjo u formua. Zhvillimi i arsimit dhe shpërndarja falas në Shqipëri e librave mësimor ishin qëllimet kryesore të kësaj shoqërie.¹⁶⁰ Një tjetër shoqëri me emrin “Shoqëria kulturore shqiptare Bashkimi” u themelua në qytetin rumun të Konstancës në fillim të janarit të vitin 1910. Ndër qëllimet e saj, përveç përpjekjeve për bashkimin e shqiptarëve pa dallim feje¹⁶¹ ishte edhe grumbullimi i fondeve për çeljen e shkollave shqipe në Shqipëri.¹⁶² Përzierja e nacionalizmit, ndjekjes së modelit perëndimor dhe mirëbërësisë, duket e shkruarë në statutin e kësaj shoqërie, ku përveç ngritjes së shkollave, në këtë statut bëhej e ditur se kjo shoqëri do të njihte vetëm alfabetin me shkronja latine të dalë nga Kongresi i Manastirit.¹⁶³ Përfaqimi i këtij alfabeti, përtej arsyeve praktike kishte edhe një vlerë të madhe simbolike pasi tregonte se nga donin këto shoqëri ta orientonin të ardhmen e vendit. Sikurse shihet këto shoqëri morën përsipër një rol udhëheqës për zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe këtu del edhe natyra e tyre e veçantë si dhe veçoritë e punës mirëbërëse në këtë periudhë nga këto shoqëri shqiptare.

Në 23 shkurt të vitit 1915 në kryeqytetin rumun krijohet një shoqëri me karakter fetar dhe patriotik e quajtur “Komuniteti ortodoks shqiptar i Bukureshtit”, e cila kishte për synim të financonte për mbajtjen e Kishës Ortodokse Shqiptare të ngritur në Rumani, të mbështeste arsimin për studime fetare përmes bursave të krijuara enkas për këtë qëllim¹⁶⁴ si dhe të ndihmonte në botimin e librave kishtarë dhe didaktikës së nevojshme kishtarë në gjuhën shqipe.¹⁶⁵ Një qëllim tjetër ishte edhe çelja e një shkolle ku mësimi do të bëhej në gjuhën shqipe.¹⁶⁶

157. *Po aty*, neni 7, 32.

158. *Po aty*, dok. 24, neni 3, 53.

159. *Po aty*, dok. 117, 178–179.

160. *Po aty*, dok. 119, neni 2 dhe 3, 180.

161. *Po aty*, dok. 221, neni. 1, 294.

162. *Po aty*.

163. *Po aty*, neni 53, 299.

164. *Po aty*, dok. 68, neni 2, 260.

165. *Po aty*, neni 3, 260.

166. *Po aty*, neni 2, 260.

Sikurse u përmend edhe më sipër përveç shoqërive bamirëse me qëllime arsimore dhe patriotike, në Rumani u krijuan edhe shoqëri mirëbërëse me bazë lokale. Ndër të parat shoqëri të këtij lloji ka qenë “Vëllazëria e boboshticarëve”, e themeluar në Bukuresht më 1 janar 1894. Kjo ishte një shoqatë bamirëse, e cila kishte për qëllim përmirësimin në hapësirën publike të komunës së Boboshticës dhe kryerjen e bamirësive vetëm për boboshticarët.¹⁶⁷ Në këtë shoqatë mund të anëtarësoheshin vetëm banorë të Boboshticës ose pasardhës të tyre.¹⁶⁸ Më 1 prill të po të njëjtit vit në Bukuresht u themelua një tjetër shoqëri bamirëse po me natyrë lokale me emrin “Drenovë,” e cila sikur e përmendëm më sipër u themelua me nismën e Irakli Duros. Kjo shoqëri kishte po të njëjtat qëllime me shoqërinë e parë.¹⁶⁹ Megjithatë objektivat nuk ishin aq të kufizuara dhe në vëmendjen e kësaj shoqërie ishte edhe arsimiti.¹⁷⁰ Ndryshe nga shoqëria e boboshticarëve, shoqëria e drenovarëve ishte e hapur ndaj kujtdo që donte të bëhej pjesë e kësaj shoqërie, pavarësisht përkatësisë kombëtare.¹⁷¹ Në vitin 1905 po në Bukuresht u krijua, prej emigrantëve nga fshati Dardhë i Korçës në bashkërendim me bashkëfshatarët e tyre të emigruar në ShBA, “Shoqëria mirëbërëse e Dardhës”, e cila do të ndihmonte të varfrit dhe jetimët e këtij fshati.¹⁷² Anëtarësimi në këtë shoqëri ishte i kufizuar vetëm ndaj dardharëve pavarësisht vendit ku jetonin.¹⁷³ Një tjetër shoqëri mirëbërëse me natyrë lokale ishte edhe “Shën Gjergji” i themeluar në Braila më 19 prill të vitit 1919, nga emigrantët prej fshatit Negovan.¹⁷⁴ Ndryshe nga dy të sipërcituarat, kjo shoqëri e cilësonte veten si shqiptaro-rumune, qëllimi i së cilës ishte kryerja e bamirësisë ndaj banorëve të fshatit Negovan.¹⁷⁵ Kjo shoqëri ishte shumë e hapur dhe në të mund të anëtarësohej kushdo pa dallim kombësie.¹⁷⁶

167. *Po aty*, dok. 13, neni 3, 54.

168. *Po aty*, neni 4, 54.

169. *Po aty*, dok. 14, 61.

170. *Po aty*, neni 2.

171. *Po aty*, neni 5.

172. *Po aty*, dok. 23, neni 2, 84.

173. *Po aty*, neni 5, 85.

174. *Po aty*, dok. 44, 150.

175. *Po aty*, neni 1, 150.

176. *Po aty*, neni 3, 150.

1.5.2.2 Shoqëri bamirëse të themeluara në Bullgari

Shoqëri me natyrë bamirëse u themeluan edhe në vende të tjera të Ballkanit. Në kuadrin e veprimtarisë kulturore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare u themelua në Sofje më 1 janar të vitit 1893 shoqëria bamirëse dhe arsimore “Dëshira.” Qëllimi i kësaj shoqërie ishte hapja e shkollave shqipe në Shqipëri.¹⁷⁷ Një shoqëri tjetër e themeluar në Sofje ka qenë edhe “Ndhimëtarja”, themeluar në 1 mars 1908, qëllimi i së cilës ishte të ndihmonte financiarisht veprimtarinë e nacionalistëve shqiptarë.¹⁷⁸

1.5.2.3 Shoqëritë mirëbërëse të themeluara në Evropën Perëndimore

Shoqëri mirëbërëse shqiptare u hapën edhe në disa vende të Evropës Perëndimore. Ato në përgjithësi u çelën atje ku kishte përqëndrime studentësh shqiptarë por edhe emigrantë. Kështu në vitin 1898, ndoshta me nismën e Faik Konicës, u themelua në Bruksel shoqëria “Përlindja e shqiptarëve” qëllimi i së cilës ishte çelja e shkollave kombëtare në Shqipëri dhe shtypja e shpërndarja e librave shqip për të pasuruar dhe fuqizuar gjuhën shqipe.¹⁷⁹ Vëmendja kryesore e punës së kësaj shoqërie do të ishte ngritja e shkollave shqipe në trevat kufitare, atje ku shqiptarët ndodheshin pranë fqinjve të tyre dhe ku propaganda e monarkive ballkanase ishte më e ndezur. Në fokus do të ishin posaçërisht shkollat femërore.¹⁸⁰

Një tjetër shoqëri, me emrin “Dija”, u themelua në Vjenë më 27 dhjetor 1904¹⁸¹ me nismën e atdhetarit të shquar shkodran Hil Mosit.¹⁸² Qëllimi i themeluesve të saj ishte shtypja dhe përhapja e librave në gjuhën shqipe anë e kënd trevave shqiptare.¹⁸³

177. *Po aty*, dok. 12, neni 2, 49.

178. *Shoqëritë patriotike...*, dok. 171, 238–239.

179. Petraq Pepo, Mihallaq Pela, *vepër e përmendur*, dok. 17, neni 1, 70.

180. *Po aty*, neni 7, 71.

181. *Po aty*, dok. 27, 102.

182. *Shoqëritë patriotike...*, dok. 121, 186.

183. *Po aty*, 187.

1.5.2.4 Shoqëritë mirëbërëse të themeluara në Perandorinë Osmane

Nga dokumentat që zotërojmë e para shoqëri mirëbërëse shqiptare e themeluar në diasporë ka qenë “Arsimdashja.” E krijuar në Stamboll në 24 gusht të vitit 1874 ajo kishte për qëllim ngritjen e një shkolle në gjuhën greke për vajzat, pa dallim feje dhe kombësie, me synim përhapjen e kulturës dhe arsimit ndër të gjithë arsimdashësit.¹⁸⁴

Një shoqëri tjetër mirëbërëse u themelua në Selanik në vitin 1908, ndërkohë që ky port i rëndësishëm i detit Egje ishte pjesë e Perandorisë Osmane. “Shoqëri e Shqiptarëve” kishte për qëllim ndihmën e ndërsjellë lëndore dhe morale ndërmjet shqiptarëve që banonin në Selanik dhe rrethinat e tij.¹⁸⁵ Në këtë shoqëri mund të anëtarësoheshin shqiptarët e Selanikut dhe me vendim të kryesisë edhe të huajt që mbështetnin qëllimet e shoqërisë.¹⁸⁶

Një qendër e rëndësishme në Perandorinë Osmane ku pati një lulëzim të shoqërive shqiptare të të gjitha llojeve ka qenë Egjypti. Si pasojë e drejtimit të tij prej familjes së Mehmet Ali Pashës dhe statusit të posaçëm që ky vend kishte brenda shtetit osman, aty shqiptarët kishin mjaft lehtësira për organizimin dhe kryerjen e veprimtarive me karakter të ndryshëm. Ndër këto do dallohen për karakter bamirës shoqërija “Mirëbërëse” e themeluar diku rreth vitit 1908 në Fashnjë¹⁸⁷ në krye të së cilës ishte Loni Ligori¹⁸⁸ dhe që kishte për qëllim të ndihmonte zhvillimin e arsimit në trevat shqiptare si dhe të mbështeste lëvizjen kombëtare. Kjo shoqëri mblodhi shumë herë para si për arsimin¹⁸⁹ ashtu edhe mbështetjen e atdhetarëve të ndryshëm, siç ka qenë rasti me Bajo Topullin.¹⁹⁰ Një tjetër shoqëri me natyrë sa mirëbërëse aq edhe patriotike ka qenë edhe vëllazëria “Bashkimi” e themeluar në 12 dhjetor të vitit 1910 me nismën e Sotir Koleas e Loni Naçit dhe rreth së cilës u mblodhën mjaft figura të tjera të njohura ku ndër ta mund të përmendet Dr. Adhamidhi e Mihal Turtulli.¹⁹¹ Kjo shoqëri që i dha një ndihmë shumë të madhe çështjes kombëtare kishte për qëllim hapjen e shkollave shqipe në Shqipëri dhe jashtë saj.¹⁹² Kjo shoqëri mblodhi dhe shpërndau të holla jo vetëm për krahinën e Korçës por edhe për Negovanin dhe shoqërinë arsimore shqiptare të Brailës.¹⁹³

184. Petraq Pepo, Mihallaq Pela, *vepër e përmendur*, dok. 2, neni 1, 19.

185. *Po aty*, dok. 29, neni 1, 104.

186. *Po aty*, neni 2, 104.

187. Shoqëritë patriotike..., dok. 166, 237–238.

188. AQSh, fondi 97, viti 1908, d. 23, fl. 1.

189. AQSh, fondi 97, viti 1908, d. 26, fl. 1–3.

190. AQSh, fondi 97, viti 1908, d. 39, fl. 1–2.

191. AQSh, fondi 97, viti 1928, d. 22, fl. 4.

192. Petraq Pepo, Mihallaq Pela, *vepër e përmendur*, dok. 48, nyja 3, 163.

193. AQSh, fondi 97, viti 1912, d. 73, fl. 2.

1.5.2.5 Shoqëritë bamirëse të themeluara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Duke nisur nga fillimi i shekullit XX Shtetet e Bashkuara të Amerikës shndërrohen në një nga vatrave kryesore të diasporës shqiptare dhe shumë shpejt roli i saj në historinë e Shqipërisë do të ishte i jashtëzakonshëm. Shqiptarët në ShBA gjetën jo vetëm një vend ku mund të pasuroheshin por njëkohësisht edhe një burim frymëzimi dhe një model për vendin e tyre. Rritja e numrit të shqiptarëve në ShBA do ta rriste edhe më rolin e kësaj pjese të diasporës shqiptare. Të gjendur në një vend sa të madh aq edhe të huaj, nuk do të vononte që shqiptarët aty të organizoheshin në shoqëri, të cilat fillimisht ishin për nga karakteri lokale dhe për nga qëllimi solidarizuese mbi bazë krahine dhe feje. Me kalimin e kohës, si pasojë edhe e punës që bënë nacionalistë shqiptarë të vajtur në Botën e Re enkas me qëllimin e organizimit mbi baza më të gjera dhe bashkërendimit të një grumbulli shoqatash të shpërndara nëpër pjesën lindore të ShBA-së, këto shoqëri do të ndryshonin si për nga përmasat dhe përfshirja, ashtu edhe për nga qëllimi. Ndër të parat shoqëri të themeluara në Amerikë do të ishte “Vëllazëri mirëbërëse e Dardhës” e formuar në 1 janar të vitit 1905 në Boston. Qëllimi i kësaj vëllazërie ishte mirëmbajtja e hapësirës publike të Dardhës, i shkollave dhe mbështetja e dardharëve në ShBA.¹⁹⁴ Natyra lokale e kësaj shoqërie shfaqej edhe në faktin se anëtarë të saj lejoheshin vetëm dardharët, pavarësisht se ku ndodheshin.¹⁹⁵ Por për shkak të mosmarrëveshjeve që kishin ndodhur në gjirin e kësaj shoqërie në vitin 1906 krijohet “Shoqëria Patriotike e Dardhës”, qëllimet e së cilës ishin të ngjashme me ato të shoqërisë mëmë. Në vitin 1910 pasi u sheshuan mosmarrëveshjet, këto dy shoqëri u shkrinë dhe formuan shoqërinë “Vëllazëria mirëbërëse patriotike” programi i së cilës nuk ndryshonte nga dy shoqëritë prej së cilave u krijua.¹⁹⁶ Kjo shoqëri u tregua shumë aktive dhe bashkëpunoi edhe me federatën “Vatra” për të mbledhur dhe shpërndarë ndihma ndaj të mjerëve në fshatin e Dardhës si dhe për përmirësimin e hapësirës publike të Dardhës. Në 3 nëntor të vitit 1918 kjo shoqëri u riorganizua dhe mori emrin “Mbleta.”¹⁹⁷ Pavarësisht ruajtjes së karakterit local, në statut shihet një zgjerim i interesave të kësaj shoqërie në krahasim me parardhëset e veta. Kështu, ndër synimet e “Mbletës” ishte të ndihmonte shkollat në gjuhën shqipe, pa theksuar këtu asnjë parapëlqim krahinor. Natyra lokale sidoqoftë ishte ende e pranishme dhe do të shprehej në qëllimin për të përmirësuar infrastrukturën e Dardhës.¹⁹⁸ Kjo shoqëri kreu një veprimtari të gjerë filantropike në vitet ‘20–‘30.

194. *Po aty*, dok. 23, nyja 2, 82.

195. *Po aty*, nyja 4, 82.

196. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 63.

197. *Po aty*, 64.

198. P. Pepo, M. Pela, *vepër e përmendur*, dok. 82, nyja 2, 307.

Në radhët e shoqërive të krijuara nga emigrantët shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk munguan edhe ato me karakter bamirës dhe arsimor. Në vitin 1906 në Xhejmstaun, Bufalo, me nismën dhe frymëzimin prej atdhetarit të shquar shqiptar, Petro Nini Luarasi, u themelua shoqëria “Malli i mëmëdheut” synimi i së cilës ishte shtypja e librave në gjuhën shqipe me qëllim përhapjen e qytetërimit dhe shtimin e vëllazërisë ndër shqiptarët.¹⁹⁹ Karakteri mbarëkombëtar i kësaj shoqërie do të shprehej edhe në faktin se anëtar i saj mund të bëhej kushdo pa dallime kombëtare²⁰⁰ por në organet drejtuese mund të zgjidheshin vetëm shqiptarët.²⁰¹

Një shoqëri tjetër, e cila do kishte për organ shtypi të vetën gazetën *Dielli*,²⁰² rëndësia e së cilës ka qenë e jashtëzakonshme jo vetëm në publicistikën shqiptare por edhe në historinë e Shqipërisë, ka qenë shoqëria “Besa–Besën”, e themeluar në Boston në 3 shkurt 1907 me nismën e atdhetarëve të shquar shqiptarë, Fan Nolit dhe Sotir Peçit.²⁰³ Kjo shoqëri do të shndërrohej më vonë në strumbullarin e krijimit të federatës “Vatra”.

The Oldest Albanian Newspaper

In Existence Since 1909

In English



and Albanian



Kjo shoqëri synonte arsimimin e shqiptarëve të rinj në ShBA dhe nxënësit e dalluar shqiptarë në shkollat më të mira amerikane, me qëllim kthimin e tyre në atdhe si mësues për të përhapur dijen në Shqipëri, për të zhvilluar arsimin dhe letërsinë shqipe përmes gazetave, librave

199. *Po aty*, dok. 26, nyja 3, 97.

200. *Po aty*, nyja 5, 97.

201. *Po aty*, nyja 6, 97.

202. Valentina Duka, “Rrethanat që çuan në themelimin e ‘Vatrës’”, *Çështje të historisë bashkohore të shqiptarëve*, Tiranë: ShBLU, 2008, 46.

203. Valentina Duka, “Lëvizja kombëtare në gjirin e diasporës shqiptare”, *Po aty*, 28–29.

etj.²⁰⁴ Dyert e kësaj shoqërie ishin të hapura për të gjithë shqiptarët pa patur parasysh dallimet fetare apo krahinore.²⁰⁵ Për të njëjtin qëllim, për shtypjen dhe shpërndarjen e librave për shkollat shqipe në Shqipëri, u themelua më 19 shtator 1909 në Southbrixh, Masaçusets, shoqëria “Djell i Shqipërisë”,²⁰⁶ e cila ishte e hapur për të gjithë shqiptarët, pa dallim feje a krahine.²⁰⁷

Në vitin 1909 në Boston themelohet shoqëria korçare “Arsimi”, e cila ishte patriotike nga qëllimi, por lokale për nga përfshirja dhe trualli ku do të zhvillonte veprimtarinë e saj. Ndërkohë, natyra e saj hibride shprehej edhe në faktin se ajo do të shërbente si një qendër që do të ndihmonte gjithë korçarët që ndodheshin në Boston. Kështu, si qëllim ishte zhvillimi i arsimit në gjuhën kombëtare dhe ndihma për gjithë korçarët anëtarë të shoqërisë që ndodheshin me banim në qytetin ku shoqëria u themelua.²⁰⁸ Kjo shoqëri do të riformohej mbi baza të tjera më 30 gusht 1919. Ajo do ta ruante natyrën e saj lokale për nga përbërja dhe do të vazhdonte të ishte një shoqëri e korçarëve të Amerikës, por si qëllim kishte mbështetjen e zhvillimit të arsimit në mbarë vendin.²⁰⁹ Kjo shoqëri përfaqëson kapërcimin e mendësisë krahinore dhe kalimin në një fazë tjetër të punës bamirëse, e cila shihte dhe kërkonte mirëqënien jo vetëm të një grupi të ngushtë por atë të një bashkësie më të gjerë, atë të kombit. Por sidoqoftë kjo nuk donte të thoshte fundin e krijimit të shoqërive me natyrë lokale. Sikurse do të shihet më tej procesi i themelimit të shoqërive me karakter krahinor vazhdoi të ishte ende i hapur.

Po në lëmin e arsimit u krijuan edhe shoqëri të tjera. Një e tillë u themelua në vitin 1917 nga emigrantët gjirokastritë në Nju Bedford, Masaçusets, e cila mori emrin “Drita”. Ajo kishte për qëllim mbajtjen e shkollës “Drita” në Gjirokastër dhe mbulimin financiar të shpenzimeve të kësaj shkolle.²¹⁰ Nëse shoqëria e mësipërme kishte si shumë të tjera edhe natyrë lokale nuk munguan edhe shoqëritë, të cilat spektrin e punës së tyre e kishin më të gjerë se caqet e ngushta krahinore. Një shoqëri e tillë ishte “Lidhja e studentëve shqiptarë” e themeluar në Springfild, Masaçusets, që kishte për qëllim përhapjen e dijes përmes arsimit në Shqipëri. Ky synim shprehej në statutin e tyre ku theksohej se shoqëria do të përpiqej të ndihmonte studentët shqiptarë të vazhdonin

204. *Shoqëritë patriotike...*, dok. 135, 202.

205. *Po aty*.

206. *Po aty*, dok. 197, nyja 2, 265.

207. *Po aty*, nyja 1, 265.

208. P. Pepo, M. Pela, *vepër e përmendur*, dok. 37, nyja 1, 132.

209. *Po aty*, dok. 96, 379.

210. *Po aty*, dok. 76, nyja 6, 282.

studimet e tyre si dhe të nxiste të rinjtë në Shqipëri të arsimoheshin dhe të luftonin për përhapjen e arsimit në vend.²¹¹

Për tu kthyer te shoqëritë e ngritura mbi baza të ngushta gjeografike duhet përmendur shoqëria “Vëllazëri e Vithkuqit” e themeluar në Southbrixh, Masaçusets, nga emigrantët vithkuqarë. Solidariteti mbi baza lokale dhe lidhja e fortë me vendlindjen si faktorë që shtynë këta emigrantë të formojnë këtë shoqëri shprehet qysh në nyjen e parë të statutit të saj.²¹² Ky bashkim mbi këtë bazë do të shprehej në nyjen e dytë ku emigrantët shprehnin si qëllim kryesor përpjekjet për zhvillimin e Vithkuqit.²¹³ Shprehje e këtij synimi ishte mbështetja e zhvillimit të arsimit në fshat,²¹⁴ përmirësimi i hapësirës publike të fshatit, që shtrihej nga rregullimi i rrugëve, i kishave, manastireve²¹⁵ dhe deri te ruajtja e kufijve të fshatit²¹⁶ e madje mundësisht edhe zgjerimi i tyre.²¹⁷ Solidariteti, ndihma e ndërsjellë dhe mbështetja e vithkuqarëve në nevojë²¹⁸ dhe pritja e atyre që vinin në ShBA si emigrantë²¹⁹ ishte një reflektim tjetër i qëllimit kryesor.

Një shoqëri tjetër me karakter lokal ishte edhe shoqëria mirëbërëse drenovare e themeluar në Hadson, Masaçusets, në vitin 1911 me emrin “Profet Elia” dhe e riformuar në vitin 1914 ku mori emrin “Bashkimi”, qëllimi i së cilës do të ishte kryerja e bamirësisë në Drenovë dhe ndihma ndaj të gjithë drenovarëve në nevojë.²²⁰ Për tu përmendur është edhe shoqëria bamirëse e banorëve të fshatit të Shalësit që mori po të njëjtin emër, “Bashkimi”, e themeluar në korrik të vitit 1919. Qëllimet e kësaj shoqërie ishin shumë modeste. Ato kufizoheshin te sjellja e ujit të pishëm për fshatin e tyre.²²¹

Shoqëri bamirëse me natyrë lokale ka qenë edhe “Bashkimi i pogradecarëve” e themeluar në Southbrixh në 1 gusht 1915. Njëlloj si edhe me rastet e mëparshme ishte dashuria për vendlindjen dhe solidariteti krahinor ai që i bashkoi dhe i shtyu ata të krijonin këtë shoqëri. Qëllimi i kësaj shoqërie ishte ndihma për çdo nevojë që kishte qyteza prej nga ata vinin²²² dhe ndihma ndaj njëri-tjetrit në rast nevoje.²²³

211. *Po aty*, dok. 79, nyja 2, 299.

212. *Po aty*, dok. 47, nyja 1, 159.

213. *Po aty*, nyja 2, 159.

214. *Po aty*, nyja 6, 159.

215. *Po aty*, nyja 8, 159.

216. *Po aty*, nyja 7, 159.

217. *Po aty*, nyja 10, 160.

218. *Po aty*, nyja 12, 13 & 15, 160.

219. *Po aty*, nyja 14 & 16, 160.

220. *Po aty*, dok. 62, 224.

221. *Po aty*, dok. 92, nyja 1, 356.

222. *Po aty*, dok. 69, nyja 3, 264.

223. *Po aty*, nyja 4, 264.

Në vitin 1919 do të krijohet shoqëria e drenovarëve të Amerikës “Bashkimi”. Qëllimet e saj ishin të gjithanshme dhe lidheshin me komunitetin e Drenovës. Kështu shoqëria do të ngrinte klubin e fshatit në Drenovë, do të ndihmonte zhvillimin e bujqësisë, do të rinxirrte tapitë e tokave, do të lehtësonte nevojat e bashkafshatarëve si dhe do të mbështeste ngritjen e shkollave të fshatit.²²⁴ Të njëjtin shembull ndoqën edhe emigrantët që vinin nga krahina e Leskovikut të vendosur në Uroçestër, Masaçusets, të cilët themeluan më 31 maj 1919 shoqërinë arsimtare dhe bamirëse “Jani Vreto.” Por qëllimet e kësaj shoqërie ishin shumë të gjera. Ato shtriheshin nga grishja e dashurisë për njëri-tjetrin mes banorëve të kësaj krahine, te përkujdesja për gjendjen shëndetësore të krahinës, çelje shkollash, ngritja e një librarie, shpërndarje librash shkollorë dhe gazetash në gjuhën kombëtare falas e deri te mbështetja materiale ndaj bonjakëve.²²⁵ Në 22 nëntor të vitit 1919, në Uroçestër, Masaçusets u themelua shoqëria “Çamëria” qëllimet e së cilës shtriheshin nga arsimimi i rinisë çame e zhdukja e padijes, deri te mbrojtja e trevave çame nga shpëputja me Shqipërinë.²²⁶

224. *Po aty*, dok. 102, 414–417.

225. *Po aty*, dok. 91, 350.

226. AQSh, fondi 447, viti 1919, d. 260, fl. 3–4.

2.1 Filantropia dhe bamirësia në vitet 1920–1939

Pas krijimit të shtetit shqiptar në kurbën e zhvillimit të veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike pati ndryshime të dukshme në krahasim me periudhën paraardhëse. E vjetra dhe e reja bashkëjetuan duke i dhënë këtyre aktiviteteve tipare të veçanta në krahasim me periudhën parardhëse. Në radhë të parë *krijimi i shtetit shqiptar e prishi lidhjen mes filantropisë dhe bamirësisë me nacionalizmin*, që është tipari kryesor i kësaj veprimtarie deri në vitin 1920.

Dalja në skenën historike të shtetit shqiptar e uli ndjeshëm aktivitetin filantropik, veçanërisht në fushën e arsimit. Tanimë shteti shihej si aktori kryesor që do të shëronte plagët shoqërore të vendit. Kjo ka një shpjegim të vetin. Tiparet e ndryshme që mori forma e kësaj veprimtarie në këto dy periudha nuk dalin përtej caqeve të logjikës që frymëzoi mirëbërsinë dhe filantropinë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe dy dhjetvjeçarëve të parë të shekullit XX. Pjesa më e gjerë e veprimtarisë filantropike dhe mirëbërëse gjatë periudhës së fundit të administrimit otoman të trevave shqiptare ishte zhvilluar brenda suazave të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe synonte zhvillimin e arsimit dhe atë që quhej ndriçimi i popullit shqiptar për të përqaftuar flamurin e nacionalizimit. Ajo kishte për qëllim të siguronte mbështetjen prej shqiptarëve të idesë së shtet–kombit. Por pas realizimit të qëllimit, krijimit të shtetit shqiptar, detyra e arsimit dhe ndriçimit të shqiptarëve i kaloi këtij të fundit. Filantropia dhe mirëbërësia prej këtij çasti shterën së qenuri pjesë e Lëvizjes Kombëtare pasi qëllimi i kësaj lëvizje në një masë të rëndësishme ishte kryer. Me krijimin e shtetit shqiptar, edhe pse Çështja Shqiptare vazhdonte të ishte e hapur, Lëvizja Kombëtare Shqiptare rreshti së ekzistuari. Bashkë me të edhe filantropia dhe bamirësia me karakter nationalist. Detyrat që më parë bëheshin nga pjestarë të angazhuar apo shoqëri të krijuara në mbështetje të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare tanimë i takonin shtetit shqiptar. Nëse më përpara arsimit dhe përpjekjet për të përhapur librat shqip i bënin aktivistët apo strukturat mbështetëse të nacionalizmit shqiptar kjo ndodhte sepse nuk kishte një shtet shqiptar. Por tashmë ky shtet ekzistonte dhe stafeta i kaloi këtij të fundit. Kuptohet që pati donacione të shumta në mbështetje të arsimit, por ato nuk qenë më në përmasat e mëparshme si për nga shumata e derdhura ashtu edhe për nga numri i rasteve.

Megjithatë nuk ishte vetëm mungesa e interesimit prej emigrantëve apo elementëve të pasur shqiptarë për të bërë vepra filantropike dhe mirëbërëse në fushën e arsimit. Edhe shteti shqiptar nga krahu i vet

nuk ishte i gatshëm që të ndihte këto veprimtari në sektorin e arsimit. Përpara shtetit të ri shqiptar dilte sfida e madhe e ngjizjes kombëtare të shqiptarëve dhe shkatërrimi i identiteteve të fuqishme lokale në funksion të një identiteti kombëtar. Në kuadrin e kësaj politike, arsimi do të merrte një vlerë të jashtëzakonshme pasi ai ishte vjega kryesore përmes së cilës mund të përmbushej kjo detyrë me rëndësi jetike për jetëgjatësinë e shtetit shqiptar.²²⁷

Në këto kushte arsimi u laicizua dhe u vu krejtësisht nën kontrollin e shtetit. Në ligjin organik për arsimin të vitit 1928 qysh në nyjën e parë të tij do të theksohej “Arsimi, Edukata e brezit të ri gjindet nën kryesinë e mbikqyrjen e Shtetit dhe mbahet me mjetet e tij.”²²⁸ Xhelozia me të cilën shteti kontrollonte arsimin ishte e tillë që i linte pak hapësirë financimeve private ose dhuratave nga frika e përdorimit të tyre për qëllime antikombëtare.

Megjithatë, në vitet 1920 – 1924 qeveritë shqiptare, nisur edhe nga gjendja shumë e keqe e financiare ku ato ndodheshin, filluan të interesohen për të thithur shumat e lëna me testament nga shqiptarë të ndryshëm të pasuruar në emigracion.²²⁹ Duke nisur nga viti 1925 gjendja financiare e shtetit shqiptar u përmirësua, por rreziku që shihej nga depërtimi i arsimit të huaj, sidomos atij Italian e shtyu Ahmet Zogun dhe Ministrin e Arsimit, Mirash Ivanaj, që në vitin 1932, të nxirrnin ligjin për mbylljen e shkollave të huaja dhe ndalimin e nxënësve shqiptarë për frekuentimin e tyre,²³⁰ ç’ka nënkuptonte edhe ndërprerjen e financimit të institucioneve arsimore brenda truallit të Mbretërisë Shqiptare nga burime që nuk kontrolloheshin prej shtetit shqiptar. Prej këtij çasti dhuratat për arsimin pranoheshin vetëm me miratim nga Qeveria shqiptare dhe Mbreti. Shteti shqiptar pas vitit 1925 ishte pak i prirur për të grishur veprimtarinë filantropike në fushën e arsimit, sektor ky që donte ta mbante nën kontrollin e vet.

Gjatë kësaj periudhe një zë gjithnjë e më të rëndësishëm në veprimtarinë filantropike dhe bamirëse zunë përpjekjet për të shëruar plagë të rënda shoqërore që lidheshin sidomos me zhvillimin e jetës urbane, si lypsia, të pastrehët, jetimët, higjena etj. Në vëmendjen e filantropëve dhe bamirësve shqiptarë ishte edhe shëndetësia dhe ngritja e qëndrave spitalore.

227. Për më tepër mbi këtë çështje shih Artan R. Hoxha, “The Power of Knowledge: State, Religion and Education in the Process of Nation-Building in Albania Between the Two World Wars,” kumtesë e mbajtur në konferencën “Charting the Nation Between State and Society”, University of Columbia, New York, 14–17 prill 2011.

228. *Ligje, Dekret-Ligje e Rregullore e vjetit 1928*, vëll. 5, Tiranë: Botimet e Këshillit të Shtetit, 1939, 795.

229. AQSH, fondi 151, viti 1923, dosja 54, fl. 11.

230. “Mbi ndalimin e nxënësve Shqiptarë nder shkolla të huaja”, *Fletroja Zyrtare*, nr. 70, 23 shtator 1932, 1.

Pas qëmtimit të lëndës burimore për periudhën mes dy luftrave botërore shohim se në këtë periudhë, në Shqipëri, nuk ndodh vetëm një rishikim i objektivave dhe qëllimeve të mirëbërësisë dhe filantropisë. Nuk kemi thjesht një rialokim, një zhvendosje të vëmendjes dhe dhuratave e fondeve të destinuara për këto veprimtari. Zbehja e dhurimeve për zhvillimin e arsimit nuk u shoqërua me një derdhje masive të donacioneve dhe aktiviteteve të shoqërive mirëbërëse dhe filantropike në drejtime dhe fusha të tjera. *Ajo që shohim është se pas vitit 1920 ka një rënie të veprimtarisë filantropike dhe mirëbërëse.* Përmasat e kësaj veprimtarie bien në krahasim me periudhën pararendëse.

Gjatë viteve 1920–1939 kemi gjithashtu edhe një ngushtim të ndjeshëm të veprimtarisë bamirëse dhe filantropike në rrafsh kombëtar. Nëse gjatë periudhës pararendëse, veçanërisht gjatë dy dhjetvjeçarëve të parë të shekullit XX kemi një shtim të numrit të donacioneve që i kushtoheshin krejt vendit, gjatë harkut kohor të cilit i është kushtuar kjo pjesë, veprimtaria filantropike dhe mirëbërëse do të zhvillohej brenda caqeve krahinore. Si duket, ashtu si edhe e theksuam më sipër, njerëzit që kishin mundësinë të grumbullonin fonde për të kryer vepra bamirëse apo filantropike mendonin se për çështjet që shtriheshin në rrafsh kombëtar duhet të mendonte shteti shqiptar.

Në të vërtetë shqiptarët vuanin nga mungesa e një tradite të fuqishme në fushën e filantropisë. Tradita perëndimore e institucioneve bamirëse që mbështesin shtresat në nevojë dhe kontributi aktiv me nismë vetjake i segmenteve të caktuara shoqërore për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të shoqërisë, nuk kishte rrënjë të thella në trevat shqiptare. Edhe atëherë kur kjo veprimtari nisi të merrte hov u zhvillua në kuadrin e Lëvizjes Kombëtare dhe me krijimin e shtetit shqiptar u ul dhe entuziazmi, e bashkë me të, edhe intensiteti i bamirësisë dhe filantropisë. Përballja e vendit me sfidat e reja që hapeshin para tij pas Luftës I Botërore, u prit me mospërfillje nga shumica e shoqërisë. Aksioni i sektorit privat në çështjet publike ishte mjaft i vakët. Kjo do të theksohej edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme, në një raport drejtuar Kryeministrisë në vitin 1936 mbi problemin e të pastrehëve dhe dukurisë së lypësisë, kur kjo këmbëngulte për veprim të menjëhershëm nga shteti pasi mungonin institucionet bamirëse dhe ndjenja mirëbërëse në shoqërinë shqiptare ishte e dobët.²³¹ Edhe në fund të viteve '30, kur ishin ngritur institucione filantropike si Kryqi i Kuq, donacionet për veprimtarinë e kësaj organizate ishin tepër të vogla për të mos thënë të papërfillshme. Kështu në vitin 1937 të ardhurat e Kryqit të Kuq ishin

231. AQSH, fondi 149, viti 1936, dosja V–217, fl. 2.

273 mijë franga ari, nga të cilat 3800 ishin ndihma të Brendshme dhe 12000 ishin ndihma të jashtme.²³² Sikurse shihet jo vetëm që ndihmat në përgjithësi janë të papërfillshme por gjithashtu ndihmat e jashtme janë disa herë më të mëdha se sa ato të Brendshme. Kurse në vitin 1938 kemi një rënie edhe më të madhe të ndihmave nga të cilat të Brendshme ishin 1750 franga ari dhe të jashtme po 1750 franga ari për një total të përbashkët prej 3500 franga ari.²³³

Mbizotërimi i identiteve krahinore do të përkthehej në një angazhim të ulët në problemet që i përkisnin mbarë shoqërisë shqiptare. Do të ishte shteti ai që do të mendonte për ndreqjen e problemeve mbarëkombëtare. Krahinarizimi dhe brishtësia e unitetit kombëtar do të ndihmonte zhvillimin e shtetit të centralizuar në Shqipërinë e kësaj periudhe. Ndërsa secili rajon dhe krahinë do të mendonte për ndreqjen e problemeve të veta pa e shtrirë shikimin përtej kufijve të vet, do të ishte shteti ai që do të mendonte për krejt vendin. Nga ana tjetër ndërsa krahina të veçanta do të kërkonin në vazhdimësi mbështetjen e shtetit, ato do të bënin fare pak për të ndihmuar njëra-tjetrën. Në këtë moment në skenë del shteti si mburoja dhe përfaqësuesi i kombit, si farkëtuesi i identitetit kombëtar. Etatizmi zhvillohet edhe si produkt i nacionalizmit dhe nevojë për ngjizjen e kombit. Në këtë kuadër roli patriarkal i tij do të theksohet. *Veprimtaria e shtetit, me nismën ekskluzive të tij për ndreqjen e problemeve shoqërore rritet.*

Por aktiviteti i shtetit në zhvillimin e shoqërisë dhe përparimin e saj nuk cilësohet filantropik. Duke u nisur prej idealit se shteti është shërbëtor i shoqërisë dhe rregullator i marrëdhënieve që zhvillohen në gjirin e saj, atëherë përmirësimi i cilësisë së jetesës del të jetë një detyrë dhe jo një dëshirë sikundër është në rastin e sektorit privat. Megjithatë, duke patur parasysh mungesën e këtij ideali në Shqipëri, identifikimi i kontributit që kanë dhënë personalitete të shquara të politikës shqiptare të kohës, të cilët u angazhuan për të ngritur institucione të posaçme për të kryer veprimtari filantropike dhe bamirëse, merr një vlerë të veçantë. Për këtë arsye, në këtë trajtim nuk mund t'i shmangemi edhe rolit të shtetit, ç'ka reflekton qëllimet dhe vizionin e njerëzve të caktuar që qëndronin në krye të tij, që u bënë promotorë të zhvillimeve të reja dhe pak të njohura në vend e që përmes nismave të tyre u përpoqën t'u përgjigjeshin sfidave të kohës dhe të zhvillimit.

Gjithashtu shteti ndihmon ose mohon përmes instrumentave të tij, dhe mbi të gjitha përmes ligjit, zhvillimin e filantropisë dhe bamirësisë. Shteti, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, është një aktor

232. *Fletorja Zyrtare*, nr. 37, 13 prill 1938, 5.

233. *Fletorja Zyrtare*, nr. 65, 1 shtator 1938, 7.

i rëndësishëm në këtë fushë. Kjo bëhet edhe më e vërtetë në rastin e Shqipërisë të viteve 1920–1990 sidomos po të kemi parasysh se veprimtaria filantropike ka qenë në nivele shumë të ulta gjë që shkaktonte hidhërim në instancat e larta shtetërore dhe e detyronte sektorin publik të vepronte shpesh herë i vetëm në nismat për përmirësimin e gjendjes së shoqërisë.

Por aparati ligjor ishte tepër cunguar në këtë drejtim, pasqyrim ky i mungesës së traditës dhe pamundësisë së shtetit për t’u bërë faktor nxitës i veprimtarisë filantropike. Ndryshe nga shumë vende të zhvilluara evropiane ku jo rrallë shteti i detyronte subjektet e sektorit privat që cilësoheshin si të pasur, të viheshin në shërbim të shoqërisë përmes pagesave dhe detyrimeve të caktuara, në Shqipëri nuk ndodhi diçka e ngjashme. Një gjë e tillë ishte e vështirë të bëhej, pasi edhe mundësitë ekonomike dhe financiare të shqiptarëve në përgjithësi ishin tepër të ulta. Funkionarët e lartë të shtetit ishin të vetdijsëm për këtë. Në një raport që Ministria e Brendshme i dërgonte Këshillit të Ministrave në vitin 1936 për miratimin e një ligji për nxjerrjen e disa taksave dhe mbitaksave, që do të shërbenin për ngritjen dhe mbajtjen e institucioneve bamirëse, vihej në dukje se pavarësisht faktit se në krahasim me vendet e tjera taksat në Shqipëri ishin të ulta, ato ishin të larta për shqiptarët.²³⁴ Megjithatë, qëllimi i Ministrisë së Brendshme ishte pikërisht ngarkimi me më shumë taksa i shtresave të kamura për të siguruar të ardhurat e nevojshme për zbatimin e kësaj nisme.²³⁵ Nëse shteti detyronte dikë për të dhënë kontribute në shërbim të veprimtarive filantropike, kjo ishte administrata shtetërore, sikurse bëri Ahmet Zogu në vitet 1922–1924, kohë gjatë së cilës ishte Ministër i Brendshëm dhe Kryeministër, kur u jepte urdhra administratës shtetërore të paguante kuotacione për të mbushur arkën e të sapo krijuarit Kryq të Kuq Shqiptar.

Në Shqipëri nuk u krijua një klimë e mirë ligjore për donacionet dhe sidomos testamentet që ishin mjeti kryesor përmes të cilave bëheshin dhuratat për çështje shoqërore. Çështja e zbatimit të testamenteve pati shumë boshllëqe dhe nuk u zgjidh dot përfundimisht në mënyrë të kënaqshme deri në fund të kësaj periudhe. Kishte shumë hapsira që linin vend për abuzime. Ngatërresat që krijoheshin nga mbivendosja e ligjeve të ndryshme, e përshtjellonin edhe me keq situatën dhe ky problem ngeli i hapur.²³⁶ Në ligjin “Mbi tatimin e trashigimit dhe të dhuratave edhe të transferimeve pa kurrfarë ekuivalenti” të miratuar në 26 mars të vitit 1928 përjashtoheshin nga tatimet pasuritë e tundshme

234. AQSH, fondi 149, viti 1937, dosja V–228, fl. 18.

235. *Po aty*.

236. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 208.

ose patundshme që i kalonin shtetit²³⁷, duke mos parashikuar asnjë lehtësim tatimor për veprat mirëbërëse dhe filantropike.

Sikurse shihet dhuratat që i bëheshin shtetit kishin përparësi ndaj dhuratave që u bëheshin organizatave apo institucioneve që nuk ishin pjesë organike e tij. Gjithashtu shteti i dha vetes të drejtën e miratimit ose jo të donacioneve ndaj kujtdo shoqërie, bashkësie apo institucioni brenda territorit të Mbretërisë Shqiptare. Në Kodin Civil të vitit 1928 parashikohej se çdo dhuratë që kalonte vlerën e 1000 frangave ari, që u bëhej shoqërive ose bashkësive civile apo fetare si dhe fondet që do të përdroreshin për themelim fondacionesh, nuk mund të kryheshin pa dekret mbretëror.²³⁸ Edhe komunitetet fetare, të vendosura nën mbikqyrjen e shtetit, e kishin të ndaluar të pranonin dhurata prej shteteve të huaja pa miratimin e qeverisë shqiptare. Mbi të gjitha këto donacione duhet të ishin vetëm për qëllime filantropike²³⁹ndërkohë që, këto komunitete ishin të lira të mblidhnin ndihma fakultative prej shtetasve shqiptarë por edhe ky proces do të kryhej me lejen e qeverisë.²⁴⁰ Kjo klimë e krijuar nga legjislacioni në fuqi do të shndërronte shtetin në destinacionin kryesor të donacioneve për qëllime filantropike. Shteti do të bëhej në këtë mënyrë drejtuesi dhe organizuesi kryesor i kësaj veprimtarie, shpesh jo në mënyrë të drejtëpërdrejtë por përmes institucioneve të varura prej tij si p.sh. Kryqi i Kuq Shqiptar.

Për të kuptuar këtë qëndrim kontrollues ndaj të gjitha veprimtarive shoqërore dhe për të shpjeguar prirjet centralizuese duhen rrokur kushtet historike të kohës. Shqiptarët ishin të ndarë në katër besime të ndryshme, qenë të varfër dhe të paditur dhe shteti i tyre, i rrethuar me fqinjë aspak dashamirës, që nuk ishin pajtuar ende me ekzistencën e Shqipërisë, ishte ende i brishtë në arenën ndërkombëtare. Frika e keqpërdorimit të dallimeve krahinore dhe fetare dhe nxitja e prirjeve qendërikëse, ende të forta në radhët e një shoqërie me organizim shoqëror ende primitive, do ta bënte shtetin shqiptar dhe kreun e tij, Ahmet Zogun, shumë të kujdesshëm ndaj këtyre veprimtarive. Për këtë arsye ai monitoronte gjithçka. Por duhet patur kujdes dhe duhet theksuar se shteti shqiptar nuk e minonte veprimtarinë e shoqërive filantropike apo donacionet e personave të veçantë në të mirë të bashkësisë ku jetonin apo kombit. Angazhimi gjithnjë e më i madh i shtetit në këtë veprimtari ishte edhe produkt i mungesës së vazhdimësisë së punës së

237. *Ligje, Dekret-Ligje e Rregullore e vjetit 1929*, vëll. 6, Tiranë: Botimet e Këshillit të Shtetit, 1940, dok. 57, 152.

238. *Ligje, Dekret-Ligje e Rregullore*, vëll. 5bis, Tiranë: Botimet e Këshillit të Lartë, 1940, neni 562, 288.

239. "Dekret-Ligje mbi Formimin e Komuniteteve Fetare", *Fletorja Zyrtare*, nr. 38, 16 korrik 1929, neni 20, 2.

240. *Po aty*, neni 21, 2.

shoqërive filantropike apo aktivitetit të filantropëve të ndryshëm. Aksioni i tyre ishte i shkëputur, sporadik dhe i paorganizuar. Këto shoqëri nuk kishin një strategji pune. Ato, me veprimtarinë e tyre, u përgjigjeshin më tepër nevojave të çastit. Këto mangësi ishin më pak të mprehta në institucionet që ishin nën patronazhin e shtetit pasi aksioni i tyre mbështetej prej tij nga pikpamja financiare dhe institucionale.

Shteti shqiptar me nisma të autoriteteve më të larta të tij, si Ahmet Zogu, Et'hem Toto e Mehdi Frashëri, u bë nismëtar projektesh që përqeshin të shëronin plagët e shoqërisë. Që në vitin 1922, me nismën e Ministrit të Brendshëm të asaj kohe, Ahmet Zogut, u themelua Kryqi i Kuq Shqiptar dhe ky institucion do të qëndronte nën patronazhin e tij edhe kur ky të bëhej mbret i Shqipërisë.²⁴¹ Kryqi i Kuq shqiptar do të shndërrohej në bërthamën e të gjitha insitucioneve filantropike në vend, si azile, jetimore etj.

Duke nisur nga viti 1925 Ahmet Zogu nisi të vinte në jetë politika që synonin modernizimin e vendit gjë që u shoqërua edhe me zgjerimin e qendrave urbane. Bashkë me këto të fundit, nisën të shtoheshin edhe dukuri të tilla si lypsija, u rrit numri i endacakëve dhe jetimëve etj. Përballë këtyre dukurive, shteti shqiptar, gjendej në më të shumtën e rasteve krejt i vetëm. Me përjashtim të disa rasteve, si në Korçë apo aktiviteti i klerit katolik, aktorët civilë u përfshinë shumë pak në projektet që kishin për qëllim të eleminonin plagët shoqërore që rridhnin prej urbanizimit dhe skamjes. Shtimi i endacakëve dhe lypësve nëpër rrugët e Tiranës e shqetësonte Ministrinë e Brendshme pasi këta mund të shndërroheshin fare kollaj në kontigjent krimi dhe prishës të qetësisë publike. Prej këtij shqetësimi u pa e nevojshme ngritja e insitucioneve bamirëse që do të përqeshin të minimizonin efektet e këtyre dukurive.²⁴² Një nismë e tillë ishte vendimi për të çelur azile për pleqtë dhe të gjymtuarit. Ministri i Brendshëm në kohën e qeverisë liberale të Mehdi Frashërit, Et'hem Toto, do të ngrinte me mbështetjen e Kryeministrit dhe të Mbretit, një komision për këtë qëllim²⁴³ Një tjetër nismë e po të njëjtit ministër do të ishte edhe përpjekja për të krijuar “Kasën e të vobektëve”, që ishte një projekt për t'i ardhur në ndihmë invalidëve dhe endacakëve që ishin nga rrethet por që banonin në Tiranë. Duke qenë të peregjistruar në gjendjen civile të kryeqytetit ata nuk përfitonin mbështetje sociale. Kjo nismë do të ndihmonte pikërisht këtë grup në nevojë.²⁴⁴

241. AQSH, fondi 203, viti 1934, d. 104, fl. 2.

242. AQSH, fondi 149, viti 1937, d. V-228, fl. 18.

243. AQSH, fondi 149, viti 1936, d. V – 217, fl. 3.

244. AQSH, fondi 152, viti 1936, d. 918, fl. 7.

Po në vitin 1936, Ministria e Brendshme hartoi një dekret–ligj që i detyronte bashkitë e qarqeve të ndryshme të dërgonin në Strehën Vorfnore të Tiranës një numër të caktuar jetimësh nga qarqet e tyre dhe t’i paguanin për këtë qëllim Kryqit të Kuq Shqiptar, nën drejtimin e të cilit ishte jetimorja, 2% të të ardhurave të tyre për të mbuluar shpenzimet e këtyre jetimëve.²⁴⁵ Sikurse shihet këto nisma buruan në vitin 1936, gjatë kohës së Qeverisë Liberale të kryesuar nga Mehdi Frashëri, e cila u përpoq që të fuste një frymë të re në drejtimin e çështjeve të vendit.



Mehdi Frashëri

Këto nisma nuk u paraprinë dhe as u pasuan nga të tjera, ç’ka tregon ngushtësinë e vizionit të pjesës më të madhe të elitës politike të kohës, që rridhte nga grupet konservatore të bejlerëve, ndaj këtyre problemeve të mprehta shoqërore. Dështimi i kësaj qeverie do të shoqërohej edhe me ngrirjen e pjesës më të madhe të këtyre nismave.

Tjetër element i rëndësishëm i veprimtarisë filantropike në periudhën 1920–1939, është përfshirja më e madhe në të e shqiptarëve që jetonin brenda shtetit shqiptar dhe zbehja e angazhimit të emigrantëve të pasur apo shoqërive të krijuara për këtë qëllim në diasporë.

Mbizotërimi i rajoneve të caktuara në këtë veprimtari do të vazhdonte të ishte i pranishëm ende në këtë periudhë. Në krahina të caktuara kjo veprimtari do të ishte shumë më e ngjeshur dhe me përmasa më të mëdha se sa në krahina të tjera. Këtu do të spikasë sërish Korça. Kjo do të dukej edhe në dekret–ligjin e sipërcituar mbi jetimët, ku ndryshe nga të gjitha bashkitë e tjera, ajo e Korçës, përjashtohej nga ky detyrim, pasi ky qytet kishte hapur strehën vorfnore dhe e mbante me mjetet e veta.²⁴⁶ E vërteta është se kjo jetimore u hap falë veprimtarisë së filantropëve korçarë, që kishin financuar ngritjen e një institucioni kaq të rëndësishëm, që veç të tjerash tregon edhe shkallën e humanizmit dhe qytetërimit që ka një shoqëri e caktuar.

245. “Dekret–Ligjë mbi bonjakët e vorfën qi Bashkitë do të dërgojnë në Strehën Vorfnore të Kryqit të Kuq”, *Fletorja Zyrtare*, nr. 50, 29 korrik 1936, neni 1 & 2, 1.

246. *Po aty*.

Një tjetër element vazhdimësie është edhe mbizotërimi i elementit ortodoks në kryerjen e veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike. Por duhet vënë në dukje se mbizotërimi i këtij elementi në këtë veprimtari, është i pranishëm vetëm në Shqipërinë Jug-Lindore. Në zonat e tjera ku kishte ortodoksë nuk ndjehet e njëjta përfshirje në veprimtarinë mirëbërëse dhe filantropike. Në këtë pjesë të Shqipërisë, elementi ortodoks ka qenë shumë më i emancipuar dhe me një ndjenjë përgjegjësie shoqërore shumë më të zhvilluar se në pjesë të tjera të vendit, pavarësisht përkatësisë fetare. Duhet vënë në dukje se angazhimi i elementit mysliman shënon një rritje të ndjeshme në këtë veprimtari, veçanërisht në Shqipërinë e Mesme. Rritja e rëndësisë së kësaj pjese të vendit, sidomos prej shndërrimit të Tiranës në kryeqytet e hapi atë më shumë me botën si dhe forcoi më tej shtresën e mesme të tregtarëve dhe sipërmarrësve. Në të vërtetë, njëlloj si edhe në periudhën paraardhëse kjo shtresë do të ishte grupi kryesor shoqëror që do të ishte promotor i këtyre veprimtarive. Pra, ndërsa Jugu i vendit vazhdoi të ishte vatra kryesore e zhvillimit të mirëbërësisë dhe filantropisë, shohim një rritje të këtij aktiviteti në Shqipërinë e Mesme dhe përfshirje shumë të dobët në Shqipërinë e Veriut, ku përjashtim bën kleri katolik por ku njëlloj si edhe në periudhën pararendëse, mungon një aksion civil në këtë fushë.

Në këtë periudhë qyteti u shndërrua në qendrën e mirëbërësisë. Për shkaqe nga më të ndryshmet ku më kryesorët janë fakti se në qytet ishte i përqëndruar kapitali financiar, i domosdoshëm për filantropinë dhe ishte rezidenca e shtresës së mesme, si dhe fakti tjetër se aty edhe tensionet sociale ishin shumë të pranishme, sidomos në kushtet e urbanizmit, e bënë në mënyrë të pashmangshme qytetin qendrën e kësaj veprimtarie. Përjashtim bën këtu Korça, e cila ishte e rrethuar nga një gjysë qendrash të zhvilluara urbane që orbitonin rreth saj.

Interesante do të ishte edhe një qasje gjinore ndaj kësaj çështjeje. Gratë nisin dhe bëhen më aktive në këto veprimtari. Ku të vetme dhe ku me mbështetjen e bashkshortëve apo të afërmeve, ato do të bëheshin më të dukshme në punën mirëbërëse dhe filantropike. Këto janë shenja të një lëvizjeje sado të ngadaltë, të sigurtë, drejt emancipimit të gruas shqiptare dhe shndërrimit të saj në një faktor të rëndësishëm shoqëror. Kjo dukuri përbën një zhvillim origjinal të veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike gjatë kësaj periudhe.

Përveç kësaj një tjetër element ishte edhe rënia e ndjeshme e veprimtarisë së shoqërive mirëbërëse. Gjatë kësaj kohe u ngritën shoqëri të reja me qëllime bamirësie por ato nuk patën kurrë të njëjtin angazhim sikurse në periudhën pararendëse. Përveç kësaj numri i shoqërive bamirëse nuk pati rritje. Gjatë kësaj kohe u themeluan shume

shoqëri me shtrirje mbarëkombëtare, por pjesa më e madhe e tyre ishte kulturore dhe politike. Qëllimet e tyre ishin të mbështetnin modernizimin e shoqërisë shqiptare por jo përmes një aksioni filantropik. Ato synonin të ngrinin përmes propagandës dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe politike, ndjenjën e nacionalizmit të rinia shqiptare, të emanciponin gruan, të përshpejtonin shkëputjen nga trashëgimia osmane etj. Ato bashkpunonin me shtetin duke u bërë masha të tij. Për këtë arsye pjesa më e madhe e tyre nuk u përfshi në veprimtari mirëbërëse dhe filantropike. Shoqëritë mirëbërëse të kësaj periudhe nuk ishin mbarëkombëtare por lokale.

Nga ana tjetër mjaft aktive u treguan institucionet fetare ku ashtu si edhe më parë, do të shkëlqente Kisha Katolike. Komunitetet e tjera fetare do të përfshiheshin në bamirësi dhe filantropi, por ato ishin shumë të varfra dhe nuk kishin organizimin e duhur për të kryer një aksion shoqëror me përmasa të krahasueshme me atë të Kishës Katolike. Edhe pse përfaqësonte bashkësinë fetare më të vogël në vend, Kisha Katolike në Shqipëri, si pasojë e traditës dhe institucioneve të saj të krijuara prej kohësh për të mbuluar këto veprimtari, si dhe mbështetjes së plotë dhe të gjithanshme të Vatikanit, që e cilësonte Shqipërinë si një hapësirë të interesit të veçantë për kryerjen e punës misionare, do të qëndronte në pararojë të kësaj veprimtarie mirëbërëse dhe filantropike.

2.2 Filantropë dhe bamirës të shquar në vitet 1920–1939

2.2.1 Filantropia dhe bamirësia në krahinën e Korçës

Ndërmjet dy lyftrave botërore qyteti i Korçës vazhdoi të ishte një ndër qendrat kryesore ekonomike dhe kulturore të vendit dhe pa dyshim qendra kryesore e veprimtarisë shoqërore në Shqipëri. Korça edhe gjatë kësaj periudhe vazhdoi të ishte qendra e veprimtarisë filantropike dhe mirëbërëse në vend. Ndryshe nga dy qendrat e tjera të mëdha shqiptare, Shkodra dhe Tirana, ku kampionët e këtyre veprimtarive ishin përkatësisht kleri katolik dhe institucionet shtetërore, në Korçë kjo veprimtari u zhvillua ekskluzivisht nga persona privatë dhe shoqata civile. Edhe pse jo me të njëjtin intensitet si në periudhën paraardhëse, në krahinën e Korçës vazhduan të ishin aktivë edhe emigrantët, që bënë një punë jo të vogël filantropike, përmes nismave personale apo shoqatave mirëbërëse.

Përsa i takon veprimtarisë mirëbërëse dhe filantropike të kryer nga korçarët me qëndrim në Shqipëri ajo ka përmasa po aq të mëdha, për të mos thënë edhe më të gjera se sa veprimtaria e kryer nga diaspora

e kësaj krahine. Edhe në këtë rast emrat janë të shumtë. Raste të tilla janë ato të senatorit Vangjel Turtulli, që kishte ndihmuar financiarisht martesat e vajzave të varfra korçare dhe që la me testament 10 mijë franga shqiptare për spitalin e shtetit në Korçë.²⁴⁷ Për t'u përmendur është edhe rasti i Dervish Bektashit, nga Panariti, i cili kishte bërë në zonën e Tomorricës dhe Skraparit një numër të madh çezmash, pusesh dhe urash. Në vitin 1928 ai nisi ndërtimin e rrugës që do të lidhte Tomorricën me Dardhën.²⁴⁸ Gjithë këto ndërtime merrnin një rëndësi të madhe në një vend si Shqipëria, që kishte shumë pak rrugë dhe për këtë arsye komunikimi ishte i kufizuar. Rruga dhe urat që ai ngriti, do të ndihmonin zhvillimin e krahinës së Skraparit pasi do ta lidhnin atë me qendrën kryesore ekonomike dhe kulturore të Shqipërisë së Jugut. Raste të tjera më pak të bujshme janë ai i Niko Gjlinikasit, që la një pjesë të pasurisë së tij për bamirësi të ndryshme,²⁴⁹ ai i avokatit Vasil Kondi, që i la Ministrisë së Arsimit shtëpinë e tij në fshatin Bradavicë për ta bërë shkollë²⁵⁰ apo ai i Petro Prodanit dhe Sejfulla Malukës, nga Erseka, që falën një truall prej 8 dynmësh për ngritjen e shkollës së kësaj qyteze.²⁵¹



Thoma dhe Athina Turtulli

Por mbi të gjithë spikat personaliteti i Thoma Konstandin Turtullit, që mund të cilësohet pa anjë rezervë filantropi më i madh shqiptar.

Lindur në qytetin e Korçës në vitin 1865 në familjen e një tregtari të suksesshëm vithkuqar të zbritur në Korçë, Thomai u mor që në moshë të re me tregti bashkë me të atin. Të pajisur me dhunti të veçanta në fushën e sipërmarrjes, Thomai me të atin e shtrinë veprimtarinë e tyre në shumë qytete të Shqipërisë dhe në treva

247. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 88.

248. *Po aty*, 94.

249. *Po aty*, 88.

250. *Po aty*, 93.

251. *Po aty*.

të tjera të Ballkanit, si Manastir e Selanik.²⁵² Edhe pse i pa arsimit Thoma u përfshi në Lëvizjen Kombëtare në vitet e trazuara 1912–1920 dhe më pas u angazhua edhe në jetën politike të Korçës, aktivitet në të cilin ishte e përfshirë gjithë familja Turtulli.²⁵³

Edhe në veprimtarinë filantropike nuk u përfshi vetëm Thoma Turtulli por krejt familja Turtulli. Qysh në vitin 1921 Athina Turtulli, bashkshortja e Thomait, ndihmoi materialisht jetimore të Korçës. Prej këtij viti do të niste veprimtaria filantropike e tij.²⁵⁴ Në vitin 1924, pasi Bashkia e Korçës nuk kishte arritur të siguronin fonde prej qeverisë për të ngritur një bibliotekë të re të qytetit, Thoma Turtulli do të jepte të gjitha paratë e nevojshme për të përmbushur këtë qëllim.²⁵⁵ Për këtë gjest ai u nderua nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ahmet Zogu, me urdhrin “Komandar i Skënderbeut”.²⁵⁶ Ai do të paguante edhe për rindërtimin e kësaj biblioteke pas dëmtimeve që ju shkaktuan nga tërmeti i vitit 1931 që ra në Korçë.²⁵⁷

Një tjetër kontribut të shënuar familja e Thoma Turtullit dha për ngritjen e jetimores së re të qytetit. Godina e vjetër, ku Kryqi i Kuq Amerikan kishte çelur jetimorën e Korçës në dhjetor të vitit 1919, nuk i plotësonte më standartet. E veja e Grigor Turtullit, Erasti Turtulli, në vitin 1930 mori përsipër përpara organeve bashkiake të qytetit, mbulimin e shpenzimeve për blerjen e truallit dhe ndërtimin e godinës së re.²⁵⁸ Brenda një viti jetimorja ishte gati dhe aty nisën të vinin bonjakë të shumtë nga të gjitha trevat shqiptare.²⁵⁹ Kurse në vitin 1932, Thoma Turtulli i premtoi autoriteteve shtetërore shqiptare se do të ndërtonte një spital në Korçë, punimet për ngritjen e të cilit nisën në vitin 1933 dhe do të mbaronin në vitin 1934.²⁶⁰ Pas mbarimit të spitalit, e shoqja e Thomait, Athina Turtulli, bleu edhe një kaldajë me qymyrgur për ngrohjen e mjedisëve të Brendshme të spitalit gjatë dimrit.²⁶¹

252. *Po aty*, 73.

253. *Po aty*, 74.

254. *Po aty*.

255. *Po aty*, 75.

256. *Po aty*, 77.

257. *Po aty*, 77–78.

258. *Po aty*, 79.

259. *Po aty*, 80.

260. *Po aty*, 80–81.

261. *Po aty*, 82.



Veprimtaria e filantropike e Thoma Turtullit nuk u mbyll me kaq. Ai financoi përfundimin e katedrales së Shën Gjergjit²⁶² si dhe ndërtimin e Liceut të Korçës dhe Shkollës Industriale të Korçës, të cilën e bëri në emër të së shoqes, gjë për të cilën ajo u dekorua nga Mbreti Zog me urdhrin e Skënderbeut.²⁶³ Të gjitha këto vepra me rëndësi të madhe, jo vetëm për Korçën, do të përfundonin falë mbështetjes financiare të këtij filantropi të madh. Aktivitetit të tij filantropik do t'i jepte fund vetem vdekja, e cila e mori në vitin 1937.²⁶⁴

Gjatë kësaj periudhe në krahinën e Korçës u formuan një varg shoqëri filantropike. Shoqëri të tilla u hapën sidomos në satelitët urbanë të Korçës. Të tilla ishin shoqëritë “Qyteti” në Mborje, “Përparimi” në Borovë, “Shpresa” në Boboshticë, “Shpresa” në Dardhë, “Djalëria”

262. *Po aty*, 83.

263. *Po aty*.

264. *Po aty*, 84.

në Polenë, “Rilindja” në Voskopojë, “Çardhaku” në Dishnicë, “Rilindja” në Bradavicë etj. Këto shoqëri kishin natyrë lokale dhe themelimi i tyre ishte frut i nevojës dhe dëshirës që kishin banorët e këtyre fshatrave për të mirëmbajtur hapësirën publike të fshatrave të tyre si dhe për të mbajtur të gjallë solidaritetin mes njëri-tjetrit. Kështu në statutin e shoqërisë “Përparimi” të fshatit Borovë, të themeluar në vitin 1925, ishte forcimi i arkës së fshatit dhe forcimi i bashkësisë, për të ndërtuar gjithçka për të cilën fshati kishte nevojë dhe për të ndihmuar, sa herë që lypej, nevojtarët e fshatit.²⁶⁵

Edhe në qytetin e Korçës u themeluan shoqëri të tilla si “Leku i nxënësit”, i themeluar me nismën e prefektit të Korçës, Ismet Kryeziu, që kishte qëllime filantropike në fushën e arsimit. Po në Korçë ishte dega shqiptare e federatës “Vatra”. Kjo degë u tregua shumë e angazhuar në veprimtari mirëbërëse, gjë që e dëshmoi veçanërisht në fund të vitit 1920 dhe fillim të vitit 1921 për të ndihmuar popullsinë e krahinave të Tepelenës dhe Elbasanit për dëmet që shkaktoi tërmeti i fuqishëm që tronditi Shqipërinë jugore dhe qendrore në fund të vitit 1920.²⁶⁶

Mjaft aktive u treguan të rejat dhe gratë korçare, të cilat themeluan një varg shoqëri. Kështu në qershor të vitit 1921 vajzat e këtij qyteti themeluan shoqërinë mirëbërëse “Civilizimi” që kishte për qëllim të ndihmonte materialisht nxënësit e vobektë të qarkut të Korçës.²⁶⁷ Në vitin 1920 në Korçë themelohet shoqëria mirëbërëse femërore “Përlindja”. Por për shkak të fërkimeve kjo shoqëri do të ndahej në dy shoqëri të tjera, të cilat u krijuan në vitin 1922 në këtë qytet, që ishin “Përlindja Shqiptare” me kryetare Evanthi Kotën²⁶⁸ dhe “Rilindja” me kryetare Helidiona Falli.²⁶⁹ Këto shoqëri patën një aktivitet shumë të ngjeshur filantropik. Kështu në vitin 1923 shoqëria “Rilindja” do t’i falte 500 dhrahmi Spitalit Ushtarak dhe do t’u shpërndante ndihma grave të varfra muhamedane me rastin e Bajramit.²⁷⁰ Kjo shoqëri u angazhua edhe në kryerje llotarish me qëllim shtimin e të ardhurave të arkës së saj për të kryer më pas aktivitetin mirëbërës.²⁷¹ Sidoqoftë,

265. *Statuti i Shoqërisë Mirëbërëse Përparimi i Katundit Borovë*, Korçë: A. A. Vangjeli, 1926, nyja 2, 4.

266. AQSh, fondi 97, viti 1920, d. 28, fl. 1.

267. AQSh, fondi 447, viti 1921, d. 125, fl. 1.

268. AQSh, fondi 447, viti 1924, d. 127, fl. 1.

269. AQSh, fondi 447, viti 1924, d. 128, fl. 2.

270. Helidhona Falli, “Drejtorit gazetës ‘Shqiptari i Amerikës’ Këtu”, *Shqiptari i Amerikës*, nr. 33, 2 qershor 1923, 7.

271. Helidhona Falli, “Lajmërim”, *Shqiptari i Amerikës*, nr. 42, 11 gusht 1923, 6.

ndër shoqëritë mirëbërëse të grave emër në këtë drejtim do të bënte shoqëria “Gruaja shqiptare.” Ajo kreu një veprimtari të gjerë mirëbërëse për shtresat në nevojë. Në Korçë u zhvilluan edhe veprimtari të tjera që i kapërcenin format klasike të aksionit filantropik të shpjeguar deri tani, përmes të cilave bëhej mbledhja e fondeve. Të tilla ishin edhe ballot, ku pjesëmarrësit dhuronin shuma për filantropi, koncertet dhe shfaqjet teatrale të ardhurat nga të cilat përdoreshin për qëllime filantropike. Në kuadrin e kontributeve kolektive të bashkësive duhet përmendur se në krahinën e Korçës, në vitet ’20, fshatra të tëra kanë ndërtuar me të hollat e përbashkëta dhe me punën e tyre shkollat me qëllim arsimimin e fëmijëve të tyre pa pritur ndihmën e shtetit të varfër shqiptar. I tillë ishte, p.sh. rasti i fshatit Polenë, banorët e të cilit që kishin mbledhur dhe më pas shpenzuar, për ndërtimin e një shkolle moderne për vajza, një shumë prej 500 napolonash.²⁷²

2.2.2 Filantropia dhe bamirësia në krahinat e Vlorës, Beratit dhe Gjirokastrës

Edhe pse në një shkallë shumë më të ulët se sa Korça, edhe Vlora ka patur veprimtari filantropike dhe mirëbërëse në periudhën ndërmjet dy luftave botërore. Ky aktivitet u zhvillua si edhe në Juglindje të vendit, si përmes nismave të personave të veçantë ashtu edhe përmes aksionit të shoqërive mirëbërëse. Mirëbërësi më i njohur vlonjat është Neshat Bej Vlora. Përmes dhuratave që bëri ai mbështeti në veçanti arsimin.²⁷³ Në testamentin e tij ai la një pjesë të pasurisë për vepra mirëbërëse në Vlorë dhe caktoi një fond për të dërguar të rinj vlonjatë në universitet. Për këtë qëllim u krijua edhe një fondacion por vetëm pak të rinj u dërguan me studime pasi shumica e fondit u përvetësua nga Komuniteti mysliman.²⁷⁴ Tjetër rast është edhe ai i Xhiko Bakos, një vejushë e familjes Xhyheri, e cila dhuroi një sasi tokash në shërbim të arsimit, përfshi këtu edhe atë femëror, por që njëlloj si edhe me rastin e Neshat Bej Vlorës ato u përvetësuan nga Komuniteti Mysliman, i cili nuk lejoi përdorimin e kësaj pasurie sipas dëshirës së pronarëve të tyre.²⁷⁵ Një tjetër grua vlonjate që kreu punë bamirëse ka qenë edhe Haxho Alikaj nga fshati Kuç, e cila financoi ngritjen e shkollës së fshatit të saj si dhe një varg veprash të tjera me dobi publike.²⁷⁶ Në vitin 1923 në Vlorë u themelua “Shoqëria mirëbërëse”, që kishte për qëllim të ndihmonte

272. AQSh, viti 195, viti 1926, d. 25, fl. 212.

273. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 183

274. *Po aty*, 185.

275. *Po aty*, 184–185.

276. *Po aty*, 186–187.

njerëzit në nevojë, por asgjë nuk dihet rreth veprimtarisë së saj, kurse në vitin 1933 në fshatin Vuno të krahinës së Vlorës themelohet shoqëria mirëbërëse Viro që kishte për qëllim përmes parave të mbledhura nga banorët dhe emigrantët e këtij fshati të ndërtonin ujësjellësin e fshatit.²⁷⁷ Për tu përmendur është edhe dhurata prej 150 mijë lireta që Vakëfi i Vlorës bëri në vitin 1924 për ndërtimin e shkollës së mesme në Ujin e Ftohtë të Vlorës.²⁷⁸

Edhe në Berat veprimtaria mirëbërëse në periudhën në fjalë ka lënë më shumë gjurmë se sa ajo që e parapriu. Në këtë qytet të vjetër dhe me identitet të spikatur lokal u krijuan një varg shoqëri mirëbërëse që do t'i përgjigjeshin edhe nënidentiteteve mjaft të kultivuara në gjirin e qytetit, që shprehej mbi të gjitha nga ndarja e lagjeve. Kështu çdo lagje e Beratit në vitet '20–'30 kishte nga një shoqëri të tillë, të cilat merreshin kryesisht me mirëmbajtjen e lagjeve dhe ndihmën për të varfrit e tyre. Nga këto shoqëri njohim vetëm një pjesë. Prej informacioneve që kemi në Berat ka qenë e organizuar, të paktën që nga viti 1922 një shoqëri me emrin "Vëllazëria Mirëbërëse," me kryetar Zau Gallanin. Nga përbërja e pleqësisë dallojmë se të gjithë ishin me përkatësi fetare ortodokse.²⁷⁹ Duke patur parasysh organizimin urbanistik të qyteteve të vjetra shqiptare ku ndarja e lagjeve të tyre bëhej duke ndjekur kriterin fetar, mendojmë se ndoshta kjo ka qenë një shoqëri bamirëse e njëjës prej lagjeve të Beratit. Në korrik të vitit 1925 krijohet shoqëria mirëbërëse "Bashkimi" e lagjes Goricë. Qëllimi i saj ishte ndihma ndaj të varfërve të lagjes në vdekje e në dasma, si dhe për të mbështetur vajtjen e fëmijve të këtyre familjeve në shkollë.²⁸⁰ Në qershor të vitit 1929 themelohet shoqëria mirëbërëse me emrin "Djersa" e lagjes Vakëf, që kishte për qëllim ndihmën për vajzat e varfra të lagjes për të bërë pajën, për të shtruar një rrugë të rëndësishme të qytetit dhe ndriçimin elektrik të rrugës kryesore të lagjes.²⁸¹ Sikurse shihet këto janë shoqëri me natyrë korporative. Ato janë shumë të mbyllura dhe duket qartazi se janë një zgjatim i funksioneve që dikur i luanin esnafet. Këto shoqata mirëbërëse tregojnë se sa mirë kishte mbijetuar mendësia e rufeteve në një qytet me një histori të rënjosur fort në shpirtin e banorëve të tij. Megjithatë, sipas të gjitha gjasave edhe në Berat kjo atmosferë po ndryshonte. Nga aq sa na lejojnë burimet, në këtë qytet kishin nisur rrekjet për bashkimin

277. AQSh, fondi 447, viti 1935, d. 225, fl. 1.

278. AQSh, fondi 195, viti 1924, d. 30, fl. 223.

279. Kristo Guxhamana, "Mbledhja e Shoqërisë 'Vëllazëria Mirëbërëse' në Berat", *Shqiptari i Amerikës*, nr. 20, 3 mars 1923, 6.

280. AQSh, fondi 447, viti 1930, d. 282, fl. 2–3.

281. AQSh, fondi 447, viti 1929, d. 75, fl. 1–2.

e këtyre shoqërive, që të vogla dhe të shumta sikurse ishin mund të bënin pak punë, në një shoqëri të gjerë që të mbulonte me veprimtarinë e vet krejt Beratit. Mbi rezultatet e këtyre përpjekjeve nuk dime ende asgjë. Në qarkun e atëhershëm të Beratit veprimtaria mirëbërëse me natyrë kolektive vihet re edhe në zonat fshatare sikurse është rasti i çeljes së një shkolle në vitin 1926 në fshatin Seman të Fierit me paratë e mbledhura në fshatrat Seman, Raman e Sheq Marinas për fëmijët e këtyre fshatrave.²⁸²

Edhe në Gjirokastrë u krijuan shoqëri me qëllime mirëbërëse, por deri tani kemi të dhëna vetëm për një të tjerë prej tyre, që ishte shoqëria e zonjave gjirokastrite “Përmirësimi”. Kjo shoqëri përveç qëllimit për të përmirësuar gjendjen shoqërore dhe emancipimin e gruas së asaj krahine, synonte edhe marrjen nën mbrojtje dhe arsimimin e aftësimit për një jetë të qytetëruar të vajzave jetime të Gjirokastrës.²⁸³

2.2.3 Filantropë dhe mirëbërës nga krahina e Elbasanit

Në periudhën ndërmjet dy luftave botërore nga Elbasani dolën disa prej filantropëve më të shquar shqiptarë. Qendër e dëgjuar tregtare dhe në një pozicion kyç, në qendër të Shqipërisë dhe përgjatë rrjedhës së lumit Shkumbin, ky qytet lidhte sa jugun dhe veriun e vendit aq edhe lindjen dhe perëndimin e tij. Traditat e dëgjua qytetare dhe arsimdashëse si dhe fuqizimi i klasës së mesme tregtare të krishterë dhe myslimane e bënte këtë qytet mjaft të hapur ndaj ndikimeve të gjithanshme që vinin nga brenda dhe jashtë vendit. Kjo pozitë e veçantë e Elbasanit do të pasqyrohej edhe në veprimtarinë mirëbërëse.

Ndër filantropët më të dëgjuar të dalë nga kjo trevë gjatë periudhës që po trajtojmë do të përmendim tre prej tyre: Nazif Bahollin, Rrapush Demetin dhe Sulejman Domin.

Nazif Baholli, një tregtar i dëgjuar elbasanas, ndërtoi për bashkqytetarët e tij bibliotekën e qytetit.²⁸⁴ Me këtë kontribut madhor që bëri ndaj komunitetit të vet ai futet në radhët e filantropëve të dëgjuar të këtij qyteti pasi ndërtoi vendin ku, përveç shkollës, lind dija dhe fillon ndryshimi.

Rrapush Demeti është një tjetër filantrop elbasanas. Ai la pjesën më të madhe të pasurisë së tij për zhvillimin e arsimit në qytetin e Elbasanit si dhe parashikoi që një pjesë e pasurisë së tij të përdorej për të mbajtur nxënësit e varfër të Elbasanit. Ai, si njeri i apasionuar pas dijes kishte edhe një bibliotekë të madhe personale, të cilën ia fali Bibliotekës së Elbasanit.²⁸⁵

282. AQSh, fondi 195, viti 1926, d. 25, fl. 31–33.

283. AQSH, fondi 195, viti 1926, d. 127, fl. 3.

284. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 159.

285. *Po aty*, 166.

Edhe pse i fundit nga radha, Sulejman Domi nuk është i fundit për nga rëndësia. I lindur në një familje tregtarësh elbasanas në vitin 1884, ka qenë në kohën e tij një nga njerëzit më të pasur në Shqipëri. Ai kishte degë të firmës së tij të shpërndara nëpër të gjitha qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë dhe degë të vetat edhe në Greqi dhe Itali. Sulejman Domi kryente në mënyrë të rregullt vepra bamirësie ndaj grupeve në nevojë dhe të varfërve të qytetit të Elbasanit. Ai mbështeti edhe zhvillimin e arsimit duke ndihmuar materialisht Liceun e Korçës dhe shkolla në Elbasan.²⁸⁶

Një rast tjetër për t'u përmendur është kontributi që dha popullsia e qytetit të Elbasanit dhe e Nënprefekturës së Peqinit në vitin 1922 për ngritjen e Shkollës Teknike të Tiranës. Për shkak të shpenzimeve të mëdha Qeveria shqiptare u bëri bëri thirrje shqiptarëve që të ndihmonin për ngritjen e kësaj shkolle, që do të shërbente si një djep për pëparimin e Shqipërisë. Populli i krahinës së Elbasanit ju përgjigj thirrjes menjëherë. Bashkia e Elbasanit mblodhi 279 franga ari²⁸⁷ kurse Nënprefektura e Peqinit mblodhi 1200 franga ari.²⁸⁸

2.2.4 Bamirës dhe filantropë në krahinën e Tiranës

Gjatë kësaj periudhe një numër bamirësish dhe filantropësh dolën edhe nga treva tiranase. Ndër ta mund të përmendim Hamide Toptanin, që në vitin 1923 la me testament një shumë për të varfrit e kryeqytetit të vendit²⁸⁹ apo Sadik Numani, që në vitin 1937, me rastin e 25 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, i dhuroi Kryqit të Kuq Shqiptar shtëpinë e tij që ta përdoret për nevojat e veta.²⁹⁰ Një tjetër bamirës ishte edhe Hysen Nikolica, lindur në Kolonjë por me banim në Tiranë, i cili bashkë me të shoqen, Zyrha, lanë në vitin 1936, 20 mijë franga ari për ndërtimin e një kopshti për fëmijë.²⁹¹

Më i shquari ndër bamirësit tiranas ka qenë Hoxha Hasan Vogli, i cili e zhvilloi veprimtarinë e tij bamirëse pikërisht në periudhën që po trajtojmë. Përveç kontributit të gjerë në fushën politike dhe arsimore ai në fund të jetës së tij la një pjesë të pasurisë së vet për Kryqin e Kuq Shqiptar. Kjo pasuri përbëhej prej 638 rrënjësh ullinj që ndodheshin në një fshat të Tiranës e që i jepnin Kryqit të Kuq shumë të ardhura për

286. *Po aty*, 163–164.

287. AQSh, fondi 195, viti 1922, d. 70, fl. 286.

288. *Po aty*, fl. 287.

289. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 176.

290. *Po aty*, 181.

291. *Po aty*, 180.

të mbuluar shpenzime të rëndësishme në veprimtarinë e tij filantropike.²⁹² Edhe pse jo nga Tirana dhe pavarësisht personalitet dhe veprimtarisë së tij kundërthënëse menduam ta fusim Ahmet Zogun në listën e filantropëve të krahinës së Tiranës për shkak se këtë veprimtari të vetën e kreu gjatë kohës që qëndroi në Tiranë, fillimisht si një nga njerzit më të fuqishëm të vendit dhe më pas si kreu i shtetit për plotë 14 vjetë. Ahmet Zogu, i njohur më shumë për karrierën e tij politike të mbushur me peripeci, objekt debatësh të ashpra për rolin që ka patur në ndërtimin dhe modernizimin e shtetit shqiptar dhe mbi politikat e Brendshme dhe të jashtme që kreu, nuk është parë asnjëherë nën prizmin e mirëbërësit. E vërteta është se Ahmet Zogu ka qenë një shpërdorues i madh i të arkës së shtetit, i njohur për ekstravagancat dhe luksin me të cilin rrethonte veten, pavarësisht se ishte mbreti i një shteti të vogël dhe të varfër. Por brenda aktivitetit të këtij personaliteti kompleks të mbushur me kundërshti dhe sjellje ekstreme, fshihet edhe ajo e donatorit dhe mirëbërësit, qëllimi përfundimtar i të cilit ishte modernizimi i Shqipërisë. Kjo është edhe arsyeja pse vendosëm përfshirjen e tij në listën e mirëbërësve dhe filantropëve shqiptarë, pasi në vlerësimin e këtyre veprimtarive qëllimi dhe aksioni janë ngushtësisht të lidhur dhe të pandashëm nga njëri-tjetri. E parë në këtë prizëm kjo është një anë e re e veprimtarisë së tij. Ahmet Zogu ishte donatori më i madh i Kryqit të Kuq Shqiptar.



Në kushtet kur ky institucion ishte nën patronazhin e tij,²⁹³ ai i kishte falur këtij institucioni të rëndësishëm filantropik çiflikun Rreth bashkë me stacionin zooteknik të Xhafzotajt në rrethin e Durrësit, pyllin Pishë të Divjakës në Lushnje dhe pasurinë e Sarandës,²⁹⁴ të cilat, me përjashtim të kësaj të fundit i ishin dhuruar atij nga Asambleja Kushtetuese ku u shpall Mbret.²⁹⁵ Këto tre dhurata jepnin një pjesë shumë të rëndësishme të të ardhurave të Kryqit të Kuq. Po ashtu, në një moment tjetër, në vitin 1931, ai do t'i falte shtetit shqiptar çifligjet e tij private në Divjakë, Rremas.

292. AQSH, fondi 150, viti 1938, d. V-51, fl. 4.

293. AQSH, fondi 202, viti 1934, d. 104, fl. 2.

294. AQSH, fondi 150, viti 1938, d. V-51, fl. 4.

295. Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, 454.

Karavasta, Përves dhe Çakajas.²⁹⁶ Pavarësisht qëllimit apo dyshimeve që mund të ngrihen mbi singeritetin e këtyre dhuratave, nisur kjo edhe nga fakti se në krye të Kryqit të Kuq Shqiptar ishte e motra e Zogut, Sanija, duhet theksuar se ai dha një shembull të qartë personal dhe do të shërbente si model për t'u ndjekur në një shoqëri me tradita jo të forta filantropike. Por kjo veprimtari e Zogut nuk është e kufizuar vetëm në këtë rast. Në vitin 1926, kohë kur Zogu ishte ende President, ai u fal pleqëve të fshatrave Kuç, Bolenë, Fterrë, Çorraj dhe Kallarat të holla për t'i përdorur për ngritjen e shkollës në Kuç.²⁹⁷ Është e kuptueshme që këto dhurata duhen parë edhe si pjesë e politikës së kulaçit dhe kërbaçit të ndjekur prej Zogut, i cili përmes mirëbërësisë mundahej të përmirësonte imazhin e tij në disa zona ku nuk kishte mbështetje.

Në Tiranë thirrja e Qeverisë shqiptare drejtuar popullit, më qershor të vitit 1922, për të ndihmuar financiarisht ndërtimin e Shkollës Teknike të Tiranës, pati jehonë më shumë se kudo tjetër në vend. Vetëm nga popullsia e qytetit kontribuan 123 vetë për një shumë prej 16.517 franga ari.²⁹⁸ (Foto në faqet 74-80) Me këtë çështje u solidarizua edhe deputeti i Tiranës Zija Toptani, i cili bashkë me disa kolegë të vetët falën rrogën e tyre për të ndihmuar përfundimin sa më të shpejtë të kësaj shkolle.²⁹⁹ Për tu përmendur është edhe kontributi i Ismail Axhemit, protoarshivist në Ministrinë e Brendshme, që dhuroi 2016 franga ari.³⁰⁰

Në qytetin e Krujës, pjesë e Prefekturës së Tiranës, në vitin 1921 çelja e shkollës fillore për djem po ndeshte në mjaft vështirësi për shkak të shtrëngesave ekonomike të Qeverisë se re dhe të varfër shqiptare. Pamundësia për të çelur shkollën mobilizoi njerëz me peshë në jetën e qytetit për të mbledhur të holla me qëllim plotësimin e shumës së nevojshme për ndërtimin e shkollës. Këtu do të spikaste kadiu dhe myftiu i qytetit, të cilët mblodhën përkatësisht 600 dhe 350 korona argjendi. Me këtë rast Ministri i Arsimit për kohën, Aleksandër Xhuvani i falenderoi ata për gjestin e kryer.³⁰¹ Rast tjetër domethënës është edhe grumbullimi i 20 napolonave flori prej banorëve të fshatit tepër të varfër Bastar, në vitin 1921, për të plotësuar shumën e nevojshme për ngritjen e shkollës së tyre, të cilën ata e kërkonin me këmbëngulje.³⁰² Po në krahinën e Tiranës, më qartë në malësitë e saj, në fshatin Fag

296. *Ligje, Dekret-Ligje e Rregullore*, vëll. 8, Tiranë: Këshilli i Lartë, 1942, dok. 118, 409.

297. AQSh, fondi 195, viti 1926, d. 25, fl. 149.

298. AQSh, fondi 195, viti 1922, d. 70, fl. 300-301.

299. *Po aty*, fl. 285.

300. *Po aty*, fl. 294.

301. AQSh, fondi 195, viti 1921, d. 7, fl. 55.

302. AQSh, fondi 195, viti 1921, d. 13, fl. 79.

List'e Bashirësve të për ndërtimin e
shkollës në Jellë

300

Nr. rend.	Emri e mbiesit	Sasi e caktuara Fr.ar	Sasi e paguara Fr.ar	Sasi e mbetur Fr.ar
1	Esat Topçani	1.100	357.70	742.30
2	Mahmet Ali baj	440	314.30	225.70
3	- Risa baj	200	60.40	139.60 ✓
4	Fuat baj	1.100	230.50	869.50
5	Abdi baj	1.100	536.60	563.40
6	Mahmet Pasha	6.000	3 300.-	2 700.-
7	Sijsa baj	200		200.-
8	Rafik baj	200	132.-	68.-
9	Xhelal baj	200		200.-
10	Qamil baj Sali baj	110	44.-	66.- ✓
11	Haliq baj " "	110	44.-	66.-
12	- Haxhur baj Çor Ali	200	87.50	112.50 ✓
13	- Zyber eff. Mallulli	110	62.-	48.- ✓
14	- Islem aga Petrola	330	64.80	265.20 ✓
15	Mustafa aga Rles	1.100	331.70	768.30
16	Sylajman aga Kusi	200	44.-	156.-
17	Shahmet Begja	132	22.-	110.- ✓
18	Haxhi Sait Beshiri	66.-	44.-	22.-
19	Myslim aga Beshiri	110	23.80	86.20 ✓
20	Bandi aga Beshiri	110		110.-
21	Xhemal aga Beshiri	110		110.-
22	Kymir eff. Kulliqi	110	22.-	88.- ^{paguar} 29.40 ✓
23	- Sefer Sarapi	66	32.30	33.70 ✓
24	- Haxhi Hasan Vagarr	44	35.-	9.- ✓
25	Myslim eff. Llogon	110	41.60	68.40 ✓
26	Muharrem aga Karpic	55	15.50	39.50 ✓
27	Shaban Mulla Abdulla	22		22.- ^{paguar} 7.80 ✓
28	Sylajman aga Basha	44	27.50	16.50 ✓
29	Hardi aga Furtasi	22	5.20	16.80
30	Islem Alla	22	11.-	11.- ✓
	për t'u bart.	14.485	6.329.70	8.155.30

Kontribut i qytetarëve të Tiranës për ndërtimin e shkollës teknike, marrë nga AQSh, fondi 195, viti 1922, d. 70, fl. 300-304

31	- Mehmet bej Myziki	22		22	✓
32	- Sefer Dalia	22	5.50	16.60	
33	- Selman off. Dauti	44	20.40	23.60	✓
34	/ Islem Hyka	44	22.-	22.-	✓
35	- Islem Hasan Dermori	22	8.00	13.10	✓
36	- Mysen Haxhi	27.50	21.40	26.10	✓
37	- Ibrahim Kagi	66	44.-	22.-	✓
38	- Remazan Doli	22	11.00	10.40	✓
39	- Myrtosa off. Kasazi	22	5.20	16.60	✓
40	- Haxhi Islem Tugu	110	43.00	66.40	✓
41	- Abdullah off. H. Met	22	16.40	5.00	✓
42	- Sali Pullan	44	39.40	5.00	
43	- Osman Sorra	22	11.-	11.-	✓
44	- Hasan off. Sali	22	11.-	11.-	✓
45	- Mehmet Bardhosh	22		22.-	✓
46	- Mehmet Hafiz Daja	11	5.40	5.00	✓
47	- Abdullah off. Gjinol	44	15.-	20.-	✓
48	- Murat Haxhi Spahi	11	5.40	5.00	✓
49	- Ryzan Spahi	11	5.40	5.00	
50	- Muharem Purtsani	11	5.40	5.00	
51	- Ahmet Haxhi aga	11		11.-	✓
52	- Musa Haxhi	22		22.-	
53	- Mehmet Sali Osmanli	11	7.60	3.40	✓
54	- Abdyl Rufina	22	11.-	11.-	✓
55	- Abdyl M. Ibrahim	22		22.-	
56	- Ismail Gali	22	5.40	16.60	✓
57	- Myrtosa Keta	16.50	5.50	11.-	✓
58	- Hasan aga Byxollit	11		11.-	✓
59	- Ibrahim Beran Zafai	22		22.-	✓
60	- Boran Struga	11		11.-	✓
61	- Zogorija Seit Krupa	22	11.-	11.-	✓
62	- Sali Hxuna	22	11.-	11.-	✓
63	- Lyman bej	66	44.-	22.-	
64	- Islem Hulla Mallban	44		44.-	11
65	- Islem aga Lleshi	22	8.20	13.60	✓
66	- Iner Qonja	44		23.50	
		16.477	6.749.90	8.727.10	

Kontribut i qytetarëve të Tiranës për ndërtimin e shkollës teknike, marrë nga AQSh, fondi 195, viti 1922, d. 70, fl. 300-304

	u bartë	15.477	6.749.90	8.727.10
67	Teftik Stendi	44	22.-	22.-
68	Hasan eff.Darhem	22		22.-
69	Ramazan eff.Nyfti	22	7.40	14.60 ✓
70	Musa eff.Nydercini	44	48.20	33.60 ✓
71	Begir eff.Kavaja	22	8.20	13.60 ✓
72	Solin eff.Rosna	11		11.- ✓
73	Hasni eff.Nehmet	22	11.-	11.- ✓
74	Solin eff.Uta	11	7.-	4.- ✓
75	Hasan ef.Bakall	22		22.- ✓
76	Nehmet Haxhi Ibrahim	22	11.-	11.- ✓
77	Hajdar Baj Hysk	22	19.10	2.90 ✓
78	Hysan Mehmet Krocjasi	22		22.- ✓
79	Jusuf eff.Khaloku	55	22.-	33.-
80	Xhemal Petrola	44	11.-	33.- ✓
81	Begir Karani	16.50	10.20	5.60 ✓
82	Ramazan Kllasi	22	16.40	5.60 ✓
83	Mehmet ef.Farka	11		11.- ✓
84	Sul Ketroshi	22	16.40	5.60 ✓
85	Mehmet Balluk	4.10		4.10
86	Reshit Petrola	16.50		16.50
87	Sefer Rradhesi	4.10		4.10 ✓
88	Ali Hal Paza	5.50	1.40	4.10 ✓
89	Shaban Sul Hara	4.10		4.10 ✓
90	Shin Turku	5.50	1.40	4.10 ✓
91	Reshit baj Nulletja	8.20		8.20
92	Asin ef.Ibrahim	11		11.-
93	Ahmet aga Bylyku	4.10		4.10 ✓
94	Uta Hasan Kurdar	12.20	9.10	3.20 ✓
95	Doktor Panteqi	22		22.- ✓
96	Xhafer Lufta baj	11		11.-
97	Doktor Qarup ef.	27.50	11.-	16.50
98	Ryshdi ef.	44	20.50	23.50
99	Hysan ef.Kavaja	44		44.-
për t'ua bartë		16.157.40	6.965.90	9.191.50

Kontribut i qytetarëve të Tiranës për ndërtimin e shkollës teknike, marrë nga AQSh, fondi 195, viti 1922, d. 70, fl. 300-304

503

	16.157.40	6.966.90	9.191.50
100 - Kasem Ali Mehmet	22	8.30	13.60 ✓
101 Salih ef. Osman	11		11.-
102 - Nysen Riza Hoxhi	16.50	8.30	8.30 ✓
103 - Mustafa baj Haxhi baj	22		22.- ✓
104 Osman ef. Kanani	11		11.-
105 Ergjater Mushoni	44	11.-	33.-
106 - Ismajl ef. Bekalli	11	2.00	8.10 ✓
107 / Osman baj Berberi	5.50		5.50 ✓
108 Sali Haxhi Abdyl	22		22.-
109 - Dhimitër Hoxhaci	33	20.40	12.60 ✓
110 / Kristi Mina	27.50	12.30	15.30 ✓
111 - Niholl Nishku	22	8.30	13.60 ✓
112 - Anastas Pantofi	22	5.50	16.50 ✓
113 Kostantin Kananzi	11	5.40	5.60
114 Lial Lim Rroçi	11		11.-
115 Anastas Laska	11	5.40	5.60
116 SANTI Vasil Nishku	11	7.-	4.-
117 - Bush Andri Prodi	11	3.00	7.10 ✓
118 - Spiro Zhava	5.50	3.-	2.80 ✓
119 Dhimitër Qali	5.50	4.-	1.50
120 - Vangjel Gallabandi	8.30	4.10	4.10 ✓
121 Ruzhuf ef. Dodja	11		11.-
122 Osman ef. Haxhi Xhar	5.50		5.50
Shuma	16.517.60	7.075.30	9.442.30

124 Animi Shqiptar nr. 64. Simbolika. Nr. 923/E. D. 15.12.22.
 Shuma e nete (nandmi katërqind e katërdhjetë e dy e tridhjetë)
 33.
 3.409.30

Vërtetohet njëlloj me origjinalin qmë q ka Zyber ef. Hallulli.

Tiranë me 18/VI/1922.

Llogoritar'i Min. s' Arsimit



Kontribut i qytetarëve të Tiranës për ndërtimin e shkollës teknike, marrë nga AQSh, fondi 195, viti 1922, d. 70, fl. 300-304

Lista q: përmba emrat e arsimtarëve
 nën shërbimë ndihmës për shkollën teknike

Sh. e. m. sh.

	Emri e mbiemri	Shërbimia	Pa paguar pr. ar.
1	L. Samil Bala	Inspektori	20
2	" Salih Beka	Dirj. Komunik	20
3	" Fasil Dujaku	profesor "	10
4	" Kostog Bizo	" "	10
5	" Riko Krahmi	" "	10
6	" Ahmet Gashi	Dirj. Dytetës	
7	" Blimiti Paparito	" Denshron	10
8	" Reshep Gjeza	mbimis	7
9	" Abedin Banihi	"	7
10	" Mustafa Gjergani	"	5
11	" Ibrahim Shullazjari	"	5
12	" Blimiti Dardkeda	"	5
13	" Spiro Sotria	" frje	7
14	" Fetulla Jurajaku	" "	5
15	" gëner Lekci	"	5
16	" Nazim Kuvçija	Dirj.	10
17	" Grahqerit Vasi	mbimis	10
18	" Atlina Bicci	"	5
19	" Evantli Danicka	"	5
20	" Mari Berashija	"	5
21	" Shqipat Nafizani	"	5
22	" Asani Kristomarku	"	3
23	" Shafiq Sotci	Dirj.	10
24	" Ibrahim Berashija	mbimis	8
			<hr/> 187

Kontribut i arsimtarëve të Tiranës për ndërtimin e shkollës teknike, marrë nga AQSh, fondi 195, viti 1922, d. 70, fl. 280

N.Ren.	Emeni e mbi emeni.	Fr.sh.	
		fr.	cant.
1.	Z. Zyber Hallulli.	48.	00.
2.	" Abdulla Haxhi Mahmud	5.	00.
3.	" Ramazan Delija.	10.	40.
4.	" Haxhi Iskan Yugu.	86.	40.
5.	" Sefer Saraçi.	33.	70.
6.	" Mehmet Bej Muniku.	22.	00.
7.	" Ahmet Haxhi Aga.	11.	00.
8.	" Abdulla Eff. Gjinoli.	29.	00.
9.	" Selman Daut.	23.	00.
10.	" Xhem Petrela.	33.	00.
11.	" Shaban Bul. Mora.	4.	10.
12.	" Ymer Qosja.	23.	50.
13.	" Dimitri Hobdari.	12.	00.
14.	" Riza Bej.	150.	60.
15.	" Abdyl Tufina.	11.	00.
16.	" Haxhi Hasan Veqarri.	11.	00.
17.	" Kasem Ali Mehmed	13.	20.
18.	" Kyslim Aga Beshiri.	60.	20.
19.	" Myrteza Eff. Kasasi.	10.	80.
20.	" Mehmed Bardhoshi.	22.	00.
21.	" Ismail Çali.	16.	00.
22.	" Iskan Alla.	11.	00.
23.	" Hasan Eff. Bali.	11.	00.
24.	" Mehmed Hafiz Daja.	5.	60.
25.	" Osman Beg Berberi.	5.	50.
26.	" Selim Eff. Resna.	11.	00.
27.	" Kristo Mima.	15.	30.
28.	" Vangjel Ballabanai.	4.	10.
29.	" Iskan Hasan Demneri.	13.	10.
30.	" Muharrem Furtuci.	5.	00.
31.	" Salih Juna.	11.	00.
32.	" Usta Hasan Kurdari.	3.	20.
33.	" Ibrahim Balran Tafala.	22.	00.

Kontribute të tjera nga qytetarë të Tiranës për zhvillimin e arsimit, marrë nga AQSh, fondi 195, viti 1922, d. 70, fl. 283

		128	38
34.	- Tush Andi Prosi.	7.	10.
35.	Hysejn Maqi.	6.	10.
36.	Islan Aga Petrela.	205.	10.
37.	Zeqirija Saia Kroja.	11.	00.
38.	Spiro Khava.	2.	50.
39.	Qanil Bej Sali Bej.	66.	00.
40.	Sul Katroshti.	8.	60.
		<u>1112.</u>	<u>70.</u>
41.	Musad Haxhi Spahi.	5.	60.
42.	Hysen Mahmud Krojei.	22.	00.
43.	Shim Turku.	4.	10.
44.	Mehmed Sul Osmanlii.	3.	40.
45.	Nyrtexa Këta.	11.	00.
46.	Mehmed Haxhi Ibrahim	11.	00.
47.	Mehmed Aga Bylyku.	4.	10.
48.	Hajdar Munikë.	2.	80.
49.	Hasan Aga Bexholli.	11.	00.
50.	Osman Sorra.	11.	00.
		<u>1128.</u>	<u>80.</u>
51.	Deqir Kazari.	5.	00.
52.	Ramazan Kellezi.	5.	60.
53.	Selim Eff. Huta.	4.	00.
54.	Ali Mol Pasa.	4.	10.
55.	Ibrahim Koqi.	22.	00.
56.	Sofer Rradheqeci.	4.	10.
57.	Hysejn Him Maqi.	8.	30.
58.	Ismael Eff. Bekall.	8.	10.
59.	Islan Aga Lleshi.	13.	80.
60.	Bajram Struga.	11.	00.
		<u>1285.</u>	<u>40.</u>
61.	Mahmud Eff. Parka.	11.	00.
62.	Nikoll Nishku.	13.	80.
63.	Mustafa Bej Haxhi Bej.	22.	00.
64.	Hamdi Eff. Mehmedi	11.	00.
65.	Sulejman Aga Basha.	16.	50.
66.	Mas-har Bej Qorr Ali.	132.	50.
67.	Mahmud Begeja.	110.	00.
68.	Myslim Eff. Llagoni.	68.	20.
69.	Doktor Panteqi.	22.	00.
70.	Anastas Panteqi.	16.	50.
71.	Abdyl Mulla Ibrahita.	22.	00.
72.	Islan Mulla Hellbeni.	11.	00.
		<u>1741.</u>	<u>90.</u>

Kontribute të tjera nga qytetarë të Tiranës për zhvillimin e arsimit, marrë nga AQSh, fondi 195, viti 1922, d. 70, fl. 285

të krahinës së Zaranikës, Xhemal Ozuni, banor i fshatit në fjalë, dhuroi kullën e tij për shkollë fshati pa kërkuar asgjë në shkëmbim të këtij gjesti.³⁰³

Në Tiranë, përveç Kryqit të Kuq u krijuan edhe organizata të tjera bamirëse, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte shoqëria e grave “Shqiptarka”³⁰⁴ që bashkpunonte me Kryqin e Kuq por punonte edhe e vetme për vepra filantropike duke patur në fokus gratë.

2.2.5 Bamirësia dhe filantropia në krahinën e Shkodrës

Shkodra është një qendër tjetër e madhe e mirëbërësisë dhe e veprimtarisë filantropike. Kjo veprimtari ishte e dominuar nga kleri katolik por kishte edhe persona civilë që zhvilluan gjithashtu bamirësi me nisma vetjake pa u mbështetur në ndihmën e institucioneve mirëbërëse klerikale. Një nga ata ishte Tef Pogu, që mund të thuhet me plotë gojë se është bamirësi më i madh shkodran. Ai ishte një nga sipërmarrësit më të suksesshëm shqiptar dhe hapi një varg fabrikash në zona të ndryshme të vendit. Ndihma e tij për komunitetin ku ka jetuar ka qenë e shumëanëshme. Për tu përmendur janë ndihmat financiare në fushën e arsimit për shkollën fillore të Motrave Stigmantine dhe shkollën “Filip Shiroka” si edhe për objektet e kultit si kishën e Shën Kollit dhe xhaminë e Parrucës. Ndihma e tij u drejtua edhe ndaj shumë të varfërve të qytetit të Shkodrës. Ndër të tjera gjatë Holokaustit ka bujtur dy hebreg që i strehoi në vilën e tij në Razëm.³⁰⁵

Natyra origjinale e qytetit të Shkodrës do të shprehej edhe në krijimin e “Shoqërisë Ndihmëtare” e themeluar nga punëtorët shkodranë. Ajo ishte një shoqëri thellësisht korporative, një zgjatim i organizimit esnafor por këtë radhë jo mbi baza profesionale por me një themel klasor. Ajo ishte forma shqiptare e sindikatës. Qëllimi i kësaj shoqërie ishte ndihma mes punëtorësh në rast nevojë por që si objektiv kryesor ishte arritja e bashkimit të tyre dhe e bashkëpunimit brenda vetes. Por ky qëllim që shprehte një vetëdije klasore zgjerohej dhe nuk qëndronte vetëm këtu. Kështu kjo shoqëri kishte edhe synime edukative duke u orientuar si ndaj anëtarëve ashtu edhe fëmijëve të tyre,³⁰⁶ jehonë kjo e traditës esnafore ende e gjallë dhe e fortë.

Përsa i takon veprimtarisë së klerit katolik ajo nuk ka mbuluar vetëm qytetin e Shkodrës apo zonat me popullsi katolike por edhe zona të tjera, sidomos në jug të vendit në radhët e ortodoksve. Kjo ishte pjesë e

303. AQSh, fondi 195, viti 1924, d. 1, fl. 83.

304. AQSH, fondi 155, viti 1924, d. II-217, fl. 1.

305. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 170-171.

306. AQSh, fondi 447, viti 1920, d. 352, fl. 1.

strategjisë së një aksioni shoqëror që kishte ndërmarrë Kisha Katolike në mënyrë që të tërhiqte në orbitën e saj popullsi jo katolike. Kjo ndodhi edhe në Shqipëri. Përmes jetimoreve, shkollave dhe veprave të ndryshme mirëbërëse kleri katolik synonte të afronte dhe të bënte për vete popullsinë ortodokse në zonat e Korçës³⁰⁷ por edhe të Beratit. Sidoqoftë Kisha Katolike u tregua shumë aktive në këto veprimtari dhe shfrytëzoi strukturat e ngritura qysh në fund të shekullit XIX për të zgjeruar më tej dhe për të shtrirë përmes punës filantropike jo vetëm ndikimin e vet por edhe kulturën e bamirësisë, punë në të cilën institucionet e tjera klerikale që vepronin në Shqipëri, qëndronin shumë mbrapa.

2.2.6 Mbështetja e diasporës për Kryqin e Kuq Shqiptar

Përveç korçarëve të Amerikës, ndihma të ndryshme mirëbërëse erdhën edhe nga anë të ndryshme të diasporës shqiptare. Këto raste të pakta përfaqësojnë kontributin e diasporës shqiptare në mbështetje të veprimtarisë filantropike të Kryqit të Kuq Shqiptar. Kështu në vitin 1925, 16 shqiptarë nga Kavalla depozituan pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë një shumë parash për Strehën Vorfnore në Tiranë,³⁰⁸ kurse kolonia shqiptare e Skeces, pranë Selanikut dërgoi një shumë tjetër për Kryqin e Kuq Shqiptar.³⁰⁹ Edhe shqiptarë të Amerikës ndihmuan financiarisht Kryqin e Kuq. Një gjë e tillë është e dokumentuar në vitin 1924 kur Konsullata Shqiptare në Nju Jork dërgoi një çek prej 340 dollarësh në të mirë të këtij institucioni me premtimin se do të vazhdonin të mblidhnin më tej ndihma për të mbështetur punën e mëtejshme filantropike të Kryqit të Kuq Shqiptar.³¹⁰ Edhe pse modeste dhe të shkëputura, këto ndihma përfaqësojnë një kontribut i cili ka mbi të gjitha një vlerë simbolike. Ajo tregon se puna e diasporës ishte e ndarë në dy rrafshë – e para ishte ajo lokale, që kryhej nga shoqëritë e themeluara nga vetë emigrantët mbi baza krahinore, dhe e dyta në rrafsh kombëtar, që kryhej përmes mbështetjes dhe financimit të shoqërive filantropike të themeluara nga shteti shqiptar enkas për këtë qëllim.

307. AQSh, fondi 133, viti 1924, d. 922, fl. 8.

308. AQSh, fondi 151, viti 1925, d. 256, fl. 1.

309. *Po aty*, fl. 4.

310. AQSh, fondi 151, viti 1924, d. 486, fl. 19.

2.2.7 Veprimtaria mirëbërëse dhe filantropike e diasporës shqiptare

Gjatë harkut kohor 1920–1939 diaspora shqiptare, edhe pse me ritme më të ulëta, vazhdoi të angazhohej në aktivitete mirëbërëse dhe filantropike në atdhe. Ky angazhim do të ndjehej veçanërisht në gjysmën e parë të viteve '20 dhe më pas do të vinte gjithnjë e duke u zbehur. Arsyet mund të jenë nga më të ndryshmet por kryesisht duhen shpjeguar me qëndrimin e tyre antizogist.

Diaspora shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ishte më aktivja dhe më e organizuara ndër gjithë të tjerat në këto veprimtari, të cilat u kryen prej shoqërive shqiptare të krijuara aty qysh përpara vitit 1920. Me përjashtim të ndonjë rasti, si i atij të federatës “Vatra” që dhuroi një vitin 1920 1000 franga ari për zhvillimin e arsimit në Shqipëri,³¹¹ pjesa tjetër e këtij aksioni ishte me karakter lokal. Shoqëritë ishin të organizuara mbi kriterin lokal dhe kishin në fokus të punës së tyre zhvillimin e lokaliteteve përkatëse. Shumë aktivë në këtë drejtim u treguan dardharët që me veprimtarinë e tyre filantropike dhe mirëbërëse u bënë një shembull edhe për shoqëritë e tjera shqiptare në Amerikë. Shoqëria “Mbleta” në vitet '20 dha një kontribut shumë të madh për zhvillimin dhe përmirësimin e hapësirës publike të fshatit të Dardhës. Në vitin 1922, në bashkëpunim me shoqërinë e dardharëve në Bukuresht, çeli shkollën e re të fshatit. Në vitet në vijim kjo shoqëri financoi përmirësimet në infrastrukturën e fshatit dhe lidhjen e tij me një varg qendrash të tjera të rëndësishme fshatare, me të cilat dardharët zhvillonin jetën e tyre ekonomike.³¹² Një kontribut të madh dha edhe shoqëria e të rinjve dardharë “Përparimi” me qendër në Kembrixh, Masaçusets. Kjo shoqëri, përveç ndihmës ekonomike që i dha shoqërisë “Mbleta” për të vazhduar ndërtimin e shkollës në Dardhë të nisur në vitin 1922, ngriti në vitin 1933 me fondet e grumbulluara prej saj edhe bibliotekën e këtij fshati. Po ashtu emigrantët dardharë në Amerikë ndihmuan hapjen e teatrit të Dardhës që jepte shfaqje me repertor kombëtar.³¹³

Një shoqëri tjetër mjaft aktive gjatë viteve '20 ka qenë edhe shoqëria “Arsimi” me qendër në Boston, veprimtaria e së cilës u shtri që nga mbështetja e zhvillimit të arsimit, e deri te ndihmat ndaj jetimores së Korçës, ngritjen e monumentit të Themistokli Gërmenjit dhe ndihmat ndaj viktimave të tërmetit që ra në Shqipërinë e Jugut në vitin 1930.³¹⁴

311. AQSh, fondi 195, viti 1920, d. 21, fl. 20.

312. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 64.

313. *Po aty*, 67.

314. *Po aty*, 68–69.

Gjatë kësaj periudhe në Amerikë pati edhe shoqëri të tjera mbi baza lokale që kanë bërë punë mirëbërëse. Të tilla kanë qenë shoqëria “Përparimi” me qendër në Çikago, e themeluar në vitin 1929 prej emigrantëve nga fshati Sinicë, që ngriti një shkollë moderne në këtë fshat,³¹⁵ shoqëria tjetër “Përparimi” e themeluar nga emigrantët nga fshati Qytezë, e cila ngriti një shkollë në këtë fshat duke bërë kështu të mundur që gjithë fshatrat e komunës së Dardhës të kishin shkolla.³¹⁶ Po ashtu, njëloj si edhe dardharët, emigrantët e fshatit Qytezë financuan investime publike si p.sh. ndërtimin e ujësjellësit, që e përmirësuan ndjeshëm cilësinë e jetës në këtë fshat, si dhe ndërtuan kishën e Shën Thanasit.³¹⁷ Edhe vithkuqarët themeluan shoqërinë “Mirëbërëse fillarsimtare” që ngriti një shkollë në Vithkuq.³¹⁸ Të njëjtën gjë bënë edhe emigrantët nga fshati Vinçan që themeluan shoqërinë mirëbërëse me të njëjtin emër, që i vuri qëllim vetes të ngrinte një shkollë në këtë fshat³¹⁹, dhe hoçishtarët që ndihmuan ngritjen e një shkolle në fshatin e tyre.³²⁰ Shoqëria “Bashkimi” e boboshticarëve të Amerikës kreu një veprimtari të ngjeshur bamirëse në fshat që përfshinte ripërtëritjen e hapësirës publike përmes ndërtimit të një ure, rregullim rrugësh dhe mbështetje për të varfrit e fshatit.³²¹ Edhe emigrantët nga fshati Gostivisht i Leskovikut themeluan në Filadelfia shoqërinë “Shënjt e Premtja” me qëllim ndihmën ndaj fshatit.³²² Aktive do të tregohej edhe shoqëria “Çamëria” e cila në vitin 1924 do të mbledhte ndihma në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të mbështetur popullsinë çame që po kalonte një moment shumë të vështirë si pasojë e politikave të shtetit grek.³²³ Në këtë kuadër ata nisnin një fushatë nën emrin ‘Për dramën e Çamërisë.’³²⁴ Kjo shoqëri do të jepte një kontribut të veçantë për mbrojtjen e çështjes çame si duke ndihmuar popullsinë shqiptare në Greqi ashtu edhe për të bërë të njohur çështjen e saj në opinionin publik amerikan. Pavarësisht se në radhët e shqiptarëve të Amerikës pjesën dërrmuese të aksionit mirëbërës dhe filantropik e kryen shoqëritë në të cilat ata ishin të organizuar nuk munguan edhe gjeste personale si ai i

315. *Po aty*, 69.

316. *Po aty*, 70.

317. *Po aty*.

318. *Po aty*, 71.

319. *Po aty*, 70.

320. *Po aty*, 71.

321. *Po aty*, 70–71.

322. *Po aty*, 71.

323. Abdul Abazi, “Fushata e çamëve”, *Dielli*, nr. 2683, 1 mars 1924, 8.

324. Idriz Demi & Hysni Sejko, “Mbledhja e shoqërisë ‘Çamëria’”, *Dielli*, nr. 2675, 9 shkurt 1924, 2–3.

Gaqi dhe Kleanthi Qiriazit, të cilët dhanë të holla për një bursë studimi në shkollën femërore të Tiranës të drejtuar nga Parashqevi Qiriazit.³²⁵ Diaspora shqiptare në Rumani vazhdoi gjithashtu të ishte aktive. Në vitin 1924 kolonia shqiptare e Konstancës grumbulloi një shumë prej 4000 lei për të ndihmuar pasurimin e fondit të librave të Bibliotekës Kombëtare³²⁶ kurse në vitin 1925 kolonia e Bukureshtit dërgoi një shumë të hollash si ndihmë për Liceun e Korçës dhe Shkollën Normale të Elbasanit.³²⁷ Përveç shoqërive në këto veprimtari u përfshinë edhe individë të veçantë. Të tillë ishin Llazar Qiriazit nga fshati Skorovot i Kolonjës, i cili la me testament një shumë prej 100 mijë lei për ndërtimin e një shkolle në fshatin e tij të lindjes. Dëshira e tij ishte që interesat e parave që ai i kishte depozituar në një bankë në Rumani, të përdreshin deri sa të ndërtohej shkolla, për të ndihmuar të rinjtë, pleqtë dhe gratë e varfra të Skorovotit.³²⁸ Një tjetër mërgimtar që u angazhua në mirëbërësi ishte edhe Vasil Çikozi nga Vithkuqi, që la me testament në janar të vitit 1927, një shumë të nxjerrë nga shitja e aksioneve të tija për shkollën e Vithkuqit dhe për arsimin në Korçë.³²⁹ Sipas të dhënave, përpara Depresionit të Madh që përfshiu botën në vitin 1929, Kristaq Naum Dogani ishte një nga shqiptarët më të pasur në botë. Por pasurinë e tij ai nuk e përdori gjerësisht në veprimtari filantropike. Përpara se të vdiste në vitin 1934 ai kishte depozituar në Vjenë një fond për një shkollë në Korçë.³³⁰

Në veprimtari filantropike dhe mirëbërëse u angazhuan, edhe pse rrallë, edhe emigrantë shqiptarë në Bullgari. Një prej tyre ishte një tjetër korçar, Kristo Adham Grapshi, i cili pas vdekjes së tij në Sofje në vitin 1924, detyronte pasardhësit e tij të jepnin 35 mijë leva në vit për 25 vjet me radhë për zhvillimin e arsimit dhe bamirësi të tjera në Shqipëri si dhe një shumë prej 35 mijë levash në vit për arsimimin në Bullgari të një të riu bullgar, turk dhe hebre.³³¹

Edhe diaspora shqiptare në Turqi u përfshi, sado në mënyrë modeste, në aksionin e mirëbërësisë. Në nëntor të vitit 1924 shoqëria mirëbërëse shqiptare në Turqi “Pragu Shqiptar”, i dërgonte Shkollës Normale të Elbasanit që po kalonte vëshirësi të mëdha financiare, ndihma në të holla³³² kurse në vitin 1925 kolonia shqiptare e Stambollit dërgoi

325. “Vepër mirëbërëse”, *Shqipëri' e re*, nr. 193, 7 shtator 1924, 1.

326. AQSh, fondi 195, viti 1924, d. 240, fl. 1.

327. AQSh, fondi 195, viti 1925, d. 16, fl. 1.

328. AQSh, fondi 195, viti 1924, d. 30, fl. 1.

329. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 61–62.

330. *Po aty*, 62.

331. *Po aty*.

332. AQSh, fondi 195, viti 1924, d. 275, fl. 2.

nëpërmjet Legatës Shqiptare në Athinë, një ndihmë financiare për Liceun e Korçës dhe Shkollën Normale të Elbasanit.³³³ Përveç shoqërive pati edhe nisma vetjake mërgimtarësh siç ka qenë ai i Jani Mitrushit, nga fshati Kovaçisht i Leskovikut, që kërkoi në vitin 1930 të financonte ndërtimin e një shkolle fillore në fshatin e tij të lindjes.³³⁴

Shumë aktive u tregua diaspora shqiptare në Egjipt. Ajo dha një kontribut jo të vogël në mbështetjen ndaj popullsisë së Tepelenës të dëmtuar nga një tërmet i fuqishëm në fund të vitit 1920.³³⁵ Ndër mërgimtarët shqiptarë që ndihmuan në këtë rast dallojnë emrat e Andon Çakos,³³⁶ Pando Avramushit,³³⁷ Avramidh Oprait³³⁸ (Foto në faqen 87,88,89) etj. Nga kjo koloni do të mbahej i njëjti qëndrim gjatë krizës së urisë në vitin 1928 në krahinat veriore të vendit. Kërkesës së Qeverisë shqiptare për të ndihmuar këto krahina iu përgjigjën Jani Vruho, Nexhip dhe Dilaver Dibra, Andon Çako, Hajdar Rustemi etj.³³⁹ Një tjetër vepër e shënuar e po kësaj kolonie ishte edhe grumbullimi i të hollave për të ndihmuar të sëmurët në Shqipëri dhe të varfrit në Egjipt.³⁴⁰ (Foto në faqen 90,91,92,93) Në këtë mënyrë ata i shërbyen vendit të tyre si dhe nuk harruan edhe vendin që u krijoi mundësitë për t'u pasuruar dhe ku kaluan një pjesë të madhe të jetës së vet. Raste të tjera kemi edhe atë të vëllezërve Stelio dhe Jani Konstandini, emigrantë në Iskenderie të Egjiptit, të cilët lanë me qera pronat e tyre në Shqipëri me qëllim grumbullimin e fondeve për çeljen e një jetimoreje në Korçë.³⁴¹ Një tjetër emigrant nga fshati Grapsh i vendosur në Egjipt ishte edhe Vasil Thomaidhi, i cili dërgoi në vitin 1936 një shumë prej 2000 franga ari për çeljen e një shkolle në fshatin e tij.³⁴²

2.3 Filantropia dhe bamirësia në vitet 1939–1944

Vitet e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, ashtu si edhe në pjesën më të madhe të Evropës, u shoqëruan me shkatërrime dhe probleme të mprehta shoqërore, politike dhe ekonomike. Prania e ushtrive të huaja në truallin shqiptar, qëndresa antifashiste dhe përplasjet e vazhdueshme ndërmjet fraksioneve të ndryshme politike në vend do ta vështirësonin së tepërmi gjendjen në vend. Pesë vjet që mbulon kjo periudhë janë pak për të bërë një përshkrim të veprimtarisë filantropike,

333. AQSh, fondi 195, viti 1925, d. 16, fl. 1.

334. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 62.

335. AQSh, fondi 97, viti 1924, d. 32.

336. AQSh, fondi 97, viti 1921, d. 30, fl. 1.

337. *Po aty*, fl. 2.

338. *Po aty*, fl. 4.

339. AQSh, fondi 97, viti 1928, d. 33, fl. 1.


340. AQSh, fondi 97, Pa vit, d. 35.

341. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 72.

342. *Po aty*.

Listë *Shebin al Kom* (5)

për ndimë për atdhetaret që pshuan
nga tërmeti i Tepelenës



<i>Shebin al Kom</i>	<i>Argimidihi Opuni dhe Miltinshi Jozari</i>	<i>q. s. 500</i>
" "	<i>q. th. Papracqantini</i>	<i>" " 100</i>
" "	<i>Vlezoria Andresco</i>	<i>" " 200</i>
" "	<i>Spiri Jine</i>	<i>" " 100</i>
" "	<i>P. Avramuzi</i>	<i>" " 200</i>
" "	<i>Maria Cica</i>	<i>" " 100</i>
" "	<i>Eleni Vatekioty</i>	<i>" " 100</i>
		<i>q. s. 1300</i>

Evidenca të kontributit të diasporës shqiptare në Egjypt në mbështetje të të dëmtuarve nga tërmeti në Tepelene, 1920. Marrë nga AQSh, fondi 97, viti 1924, d. 30, f.5



Listë. 4714

Mansoura

Widima për Shqipëtarët të Tepelenës që poun nga tërmeti.

x Mednie bey Yarud	Liq. 5.	x
x Mikolla Karfetsi	" 5.	x
Docteur Bamikhas	" " 5.	x
x Britia Consul Agent	- - 2	x
x Hassan Bey Mousad	- - -	500 mill. x
x Doktor Grilleur +	" " 5.	-
x Avocat Angelopoulos +	-	200 mfm.
x Avocat Gouristis +	" " 4.	-
x Avocat Papadakis +	" " 1.	-
x H. N. Avramischi	" " 1	-
Jusuf Begir Piccini	1	500
Panayotis Lazaris	1	500
Theocharis Anagnoste	1	500
x tel-hu-hassani goscova	2	x
x elialti-hassani tel-hajt	1	500 x
x germi-shaqiri	1	500 x
x tel-tol-gjavarat y bey	1	600 x
x Doctor M. Amin Hour	1	x
x Ibrahim Bey El-takhi	2	x
x M. Kostantina Natcho	2	x
x M. Navrojanmi +	1	: 500
x Michel Papadakis +	1.	x
x Avocat David Botton +	1.	x
x A. Papayanopoulos +	1.	x
x Mahmud Bey Musci	1	x
u reporter P. 4740		

Evidenca të kontributit të diasporës shqiptare në Egjipt në mbështetje të të dëmtuarve nga tërmeti në Tepelene, 1920. Marrë nga AQSh, fondi 97, viti 1924, d. 30, f.10

Report

P. 4170

- * Anvat S. Liatsico L. Eq 1.
- * A. Aratti bey " " 1.
- * Palmiro Landi " " 1.
- * Anvat Vlachos " " 1.
- * P. Bodani " " 2.
- * Alex. Vaccache " " 1.
- * Mh. Couladis " " 4
- * Hotel Lahif bey Helmu Yhannam " " 2
- * Famille Gusseni Hotel Razak. - 500^{mm}
- * Spirio Alexi " " 3.
- * Spirio C. Bonello - 500^{mm}

Total Plashtes me tarif. cunq mille huit cents
taxe mille dix (P. 5870)

100

P. 5470

50

P. 6020

* A. Yaloussi L. Eq 1.
 * Anonyme

500^{mm}

Evidenca të kontributit të diasporës shqiptare në Egjypt në mbështetje të të dëmtuarve nga tërmeti në Tepelene, 1920. Marrë nga AQSh, fondi 97, viti 1924, d. 30, f. 10.a

100/100

(53.216)

Ndëmbna

pre të sëmureve e të pre Kalamayta
të mbeturës të varfër -

Wasta	2 ^{te}	Vasil Jigori	Gr	900	-
.	.	Dori D. Jigori		300	-
.	.	Thia D. Jigori		200	-
.	.	Milto V. Gode		200	-
.	.	Pando Tomçe		100	-
.	.	Vilazrija Xeo		200	-
.	.	Petro Gole		40	-
.	.	Arbimidi Adamiçi		100	-
.	.	Koço Gicko		200	-
.	.	Jovan Kalapeci		100	-
Bibeb	.	Spiro Toçka		100	-
.	.	Anonim (Diamandi Fravo)		195	-
.	.	A. P. (A. Poliraqi Gick)		50	-
.	.	Anonim (Musliman ngaj Mbojja)		5	-
.	.	Petro ParDeni		100	-
.	.	Anonim (Nikola Joanon)		40	-
.	.	Tirpi Klisura		10	-
Fachn	.	Dimitri Gofko		150	-
.	.	Anonim (Kristo Nikola)		100	-
.	.	Jovan Mitko		195	-
.	.	Abilca Antoniaçi		150	-
Hatai	.	Kostandin Qendariçi (Themetas)		197	50
Minieb	.	Loni Jigori		487	50
.	.	Namm Antoniaçi		97	50
.	.	Milo Luce		97	50
		Pre të Keyer		4315	-

Evidenca të kontributit të diasporës shqiptare në Egjipt, në mbështetje të të varfërve dhe të sëmureve, marrë nga AQSh, fondi 97, viti 1924, d. 35, f. 1

	£ Kayer	Cy	4315	-
Beni-Souef	7 th Leuka Baklava		195	-
.	7 th Kosta E. Mitko		292	50
.	.		97	50
.	Dimiska K. Mitko		97	50
.	Jean Koiopulo (Grek)		97	50
.	Apostolos Koiopulo		97	50
.	Abd. Hadjaki		97	50
.	E. D. Evangelon		50	-
.	Apostolo Kanellis		50	-
.	G. Kanellis		30	-
.	A. Digenis		20	-
.	Theodore Pantazis		20	-
.	Mr. Frances		5	-
.	.		5	-
.	Leonidas Lappas (Grek)		5	-
.	Sebastian Takovas (Greq)		50	-
.	Dr. G. Liasko		97	50
.	Mimis Permetari		30	-
.	Jani Ioanidi (Permetas)		97	50
.	K. Ekonomu (Rhab)		30	-
.	Vasil Dimitriu (Kosovar)		97	50
.	Mr. Greek		20	-
.	.		20	-
.	.		20	-
.	.		20	-
	Per Kayer		5860	-

Evidenca të kontributit të diasporës shqiptare në Egjypt, në mbështetje të të varfërve dhe të sëmurëve, marrë nga AQSh, fondi 97, viti 1924, d. 35, f.1.a

E. K. Ayer	Gr.	5860	-
imi. Souif	Gr. 20	15	-
.	.	30	-
Tasta	Jazo Guda (Themetas)	30	-
.	Dimi Mici (Oparak)	50	-
imi. Souif	M. D. Economu (Vlah)	97	50
Tasta	Prefan A. Rena (Themetas)	97	50
.	Anonim (Anton Taka)	40	-
.	Dionis Meria (Korçar)	150	-
chmunt	Yrakli Vitto (Themetas) Lab	100	-
Tasta	Atbanak Gumpas (Grek)	195	-
.	Anonim (Vlah)	80	-
.	Panayoti Kaniklidis (Grek)	40	-
.	Ylia Nona (Korçar)	50	-
ansowab	Ylia Kota	97	50
		6922	50
Prof. Zif	Vasil Zagori për të mësuarin e Klubit	60	-
.	anetar për 6: muaj për 30: qum.	60	-
.	Zif Landri V. Zagori, ndëri 6: . . . 30: . . .	60	-
.	Zif Milto V. Godes anetar për 6: muaj për 34: dimëson	70	-
		7172	50
Lumi e prapitshme			
proor 13. Meanni e Tostis	Gr.	6337.50	
.	për të bollarin Tostis	10. -	
.	14 të prisurave të Tostis Gode	215. -	
.	Prof. Zif Milto për të a. autonim	150. -	
		6712	50
		460	-

Evidenca të kontributit të diasporës shqiptare në Egjipt, në mbështetje të të varfërve dhe të sëmurëve, marrë nga AQSh, fondi 97, viti 1924, d. 35, f.2

	Per të Kayer		Cyr. 6922.50
Abu-el-Wakf	Doti Georgiu		. 121.75
Matai	Dori Tragiçi		. 121.75
Fayoum	Gambi Petri	92 40	
E Shauray	S. Natse	92.50	
" "	A. Natse	50	
Hirit	Mustafa be Ginde pamte	92.50	
" "	Tasov Osmani	40	
Lubhar	Sadek. Moh. Mumin	40	
	Mumin. S. Mumin	97.50	
	J.P. Vuko	92.50	
			560 -
	A. Tashko, Fayoum	195.	
	Nikoll Loko Desoratas	92 40	

Evidenca të kontributit të diasporës shqiptare në Egjypt, në mbështetje të të varfërve dhe të sëmurëve, marrë nga AQSh, fondi 97, viti 1924, d. 35, f.2.a

për më tepër kur vendi ishte i pushtuar dhe i kontrolluar nga ushtri të huaja. Në të tilla kushte edhe nismat e organizuara shoqërore edhe ato personale do të ishin të politizuara ose do të ishin krejt të druajtura nga pasiguria e kohës.

Kjo bëhet më e vërtetë në kushtet kur nevoja për aktivitet mirëbërës dhe filantropik ndjehej në ato rajone ku zhvilloheshin luftime ndërmjet ushtrive pushtuese dhe forcave të ndryshme që organizonin qëndresën kundër pushtuesve. Të ndihmoje këto zona do të thoshte të bëheshe pjesë e rezistencës Antifashiste. Kjo bëhej edhe më e vërtetë po të kemi parasysh se aktiviteti filantropik në Shqipëri është zhvilluar në përgjithësi nga shtresa e mesme, e cila e ka qendrën e saj në qytete të kontrolluara këto nga ushtritë e huaja. Është e vërtetë se në kohë lufte fitimet e sipërmarrjeve janë më të mëdha gjë që ndihmon më pas edhe aktivitetin filantropik dhe mirëbërës por është po aq e vërtetë se në kohë lufte, edhe prona, burimi kryesor që mundëson filantropinë dhe bamirësinë, është po aq e pasigurt. Për nga vetë tiparet e luftës që u zhvillua në atë kohë në Shqipëri ishte e vështirë të qëndroje i paanëshëm. Marrja e njëres apo tjetres anë mund të përfundonte fare lehtë në raprezalje nga pala kundërshtarë. Në kushtet e luftës është e vështirë që veprimtaria mirëbërëse dhe filantropike të jenë jopolitike. Ndërkohë në kohë lufte është e vështirë të mos përfshihesh me politikë. Kjo do ta minimizonte veprimtarinë filantropike dhe mirëbërëse në një kohë që vendi kishte më shumë nevojë se kurrë për të tilla aksione. Por kjo nuk do të thotë se bamirësia dhe filantropia u shuan krejt. Në kushte të skajshme ka përgjigje të skajshme.

Pushtimi Italian i Shqipërisë çoi në një ndryshim të plotë të strukturave politike të vendit. Në Shqipëri u ngritën institucionet fashiste sipas modelit të sistemit totalitar të ngritur nga Musolini në sinujdhesën Apenine. Kjo do të prekte edhe ato institucione që ishin marrë historikisht me veprimtari filantropike dhe mirëbërëse. Kryqi i Kuq ndërroi patronazh dhe u vendos nën kontrollin e institucioneve fashiste. Në krye të tij u emërua Maja Jakomoni, bashkëshortja e Mëkëmbësit të Mbretit italian në Shqipëri, Françesko Jakomonit. Kuptohet se qëllimi ishte i qartë: instrumentalizimi në funksion të imazhit të Italisë Fashiste dhe ideologjizimi i veprimtarisë së këtij instituti të rëndësishëm filantropik me qëllim shndërrimin e tij në një mashë të propagandës fashiste në vend.

Gjithashtu italianët nisën një proces intensiv të indoktrinimit të popullsisë shqiptare, veçanërisht të rinisë. Për këtë qëllim u hapën shumë shoqata fashiste etj.³⁴³ Ata vendosën nën kontroll të plotë jo vetëm të gjitha institucionet e vendit por tutelën e tyre e shtrinë në të tëra fushat e jetës. E gjitha kjo do të pasqyrohej në të gjithë jetën shoqërore, politike dhe kulturore të vendit. Klima e papërshtatshme e krijuar e paralizoi fillimisht këtë veprimtari.

343. Pirro Gjerasi, *vepër e përmendur*, 37.

Rastet e donacioneve janë të kufizuara. Ndër to dallohet dhurata që bënë në qershor të vitit 1940 një grup shqiptarësh nga Shkupi për Kryqin e Kuq Shqiptar si dëshmi e bindjeve të tyre fashiste.³⁴⁴ Edhe pse një fakt nuk mund të shërbejë si provë përfundimtare për të nxjerrë teza, duhet theksuar se Italia shihej prej shqiptarëve që banonin në trojet kombëtare jashtë kufijëve, si e vetmja fuqi që mund të bashkonte tokat shqiptare në një shtet të vetëm. Deklarata për qënien fashist do kuptuar brenda suazave të nacionalizmit shqiptar dhe kjo dhuratë do parë e lidhur me këtë ideologji. Ajo do kuptuar si shenjë mirënjohjeje për përkrahjen prej Italisë të politikës irredentiste të ndjekur nga shqiptarët e Jugosllavisë. Gjatë kohës që Shqipëria ndodhej nën pushtimin Italian, në Shkodër, ndoshta sipas shembullit të institucioneve bamirëse katolike, u themelua “Komiteti bamirës myslyman” i drejtuar nga Esat Myftia, qëllimi i të cilit ishte mbështetja e institucioneve klerikale myslymane në këtë qytet. Kjo shoqëri ndërtoi një bibliotekë me libra të ndryshëm në shqip, arabisht dhe turqisht si dhe hapi një medrese ku veç të tjerash u çel edhe një kurs rrobaqepësie për vajza nga familje të varfra.³⁴⁵

Duke nisur nga viti 1943 pati një rritje të intensitetit të veprimtarisë bamirëse. Kriza e thellë e Italisë fashiste dhe rritja e qëndresës do të hapnin më shumë hapësira për një aksion më të vendosur në këtë drejtim. Në këtë vit u krijua edhe “Shoqëria e Mirëbërësve të Kurveleshit”,³⁴⁶ krahinë kjo mjaft e prekur nga lufta dhe një vatrë kryesore të qëndresës Antifashiste. Raste të tjera janë edhe ai i Fatushe Zaimit nga Elbasani që i dhuroi në vitin 1942 Shkollën Normale të Elbasanit dy çifligje,³⁴⁷ dhe ai i Ismail Nebi Sefës nga Lushnja, i cili i kërkoi ministrisë së Arsimit të ndërtonte një shkollë në Lushnje.³⁴⁸ Por këto ishin raste sporadike. Përgjithësisht puna mirëbërëse në këtë periudhë ishte e përqëndruar në lehtësimin e pasojave të luftës mbi civilët.

Kjo veprimtari do të shënonte një ngritje të mëtejshme në vitin 1944, pas ardhjes së ushtrive gjermane në Shqipëri. Falë qëndrimit më tolerant dhe madje aspak ndërhyrës që mbanin gjermanët ndaj politikave shoqërore të qeverive shqiptare dhe institucioneve të saj, puna filantropike dhe mirëbërëse do të merrte një hov të veçantë. Strumbullari kryesor i kësaj veprimtarie do të ishte Kryqi i Kuq Shqiptar dhe në aktivitetin e nxitur prej tij u përfshinë si rrallë ndonjëherë edhe shumë sipërmarrje dhe tregtarë. Ky angazhim i gjerë u bë atëherë kur Shqipëria e Jugut ishte bërë shesh arene e luftimeve ndërmjet ushtrive gjermane dhe bashkëpuntorëve të tyre

344. AQSh, fondi 161, viti 1940, d. 698, fl. 1.

345. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 171–172.

346. Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912–2005*, Tiranë: 55, 515.

347. Iljaz Gogaj, *vepër e përmendur*, 164–165.

348. *Po aty*, 150.

dhe forcave partizane, pasojat e të cilave mbi popullsinë civile ishin shumë të rënda. Kryqi i Kuq ju përgjigj kësaj gjendjeje duke kërkuar ndihma në të gjitha firmat e njohura shqiptare, shumë prej të cilave iu përgjigjën bujarisht. Këto ndihma ishin monetare dhe materiale. Kështu një tregtar i mirënjohur tiranas që nuk dëshironte t'i dilte emri dha 80 metra stofë,³⁴⁹ firma “Hasan Lahi dhe Vila” dhuruan 2000 franga ari përpos zotimit për dhurimin e 1200 frangave ari çdo vit,³⁵⁰ firma “Birra Korça” dhuroi 2000 franga ari,³⁵¹ distileria “Skanderbeg” dhuroi 1000 franga ari,³⁵² shoqëria “SITA” dhuroi 5000 franga ari.³⁵³ Kësaj thirrjeje iu përgjigjën edhe persona të kamur si zonja Dylifqar Toptani, që i dha Kryqit të Kuq 4 kuintal grurë për ndihma,³⁵⁴ një tjetër dhurues dha 6300 kg dardha dhe 45 kg bostan,³⁵⁵ Tonin Selfo dhe Spiro Truja dhuruan 4315 franga ari³⁵⁶ dhe një mirëbërës tjetër të cilit nuk i del emri dhuroi 5000 franga ari.³⁵⁷ Një shembull tjetër është edhe rasti i solidarizimit që ndodhi pas bombardimit që bënë aleatët amerikanë në Tiranë më 17 tetor të vitit 1944. Dëmet ishin të mëdha dhe në mbështetje të të dëmtuarve dhe lënduarve nga ky bombardim u grumbulluan mbi 56 mijë franga shqiptare.³⁵⁸ Po në vitin 1944, kur pasojat e luftës po ndjeheshin më shumë se në çdo moment që kur Shqipëria ishte pushtuar në prill të 1939–ës, në Berat, qytet ky fare pranë përplasjeve kryesore të armatosura, themelohet një shoqëri bamirëse me emrin “Mirëbërëse”, që kishte për qëllim ndihmën ndaj gjithë të goditurve nga lufta në qarkun e prefekturës së Beratit ose që edhe pse nuk ishin që aty, për arsye të luftimeve ishin vendosur në këtë qark.³⁵⁹

Sado të pakta dhe sporadike të duken këto ndihma, po të mbajmë parasysh kohën që u bënë dhe pasigurinë që mbretëronte në vend, ato janë një ndihmë me të vërtetë e madhe. Nga kjo arrijmë në përfundimin se pavarësisht kohës së trazuar dhe kushteve të jashtëzakonshme që ndodhej vendi, veprimtaria mirëbërëse nuk u shua. Në të u përfshinë aktorë nga të dyja gjinitë, sipërmarrje të mëdha tregtare dhe qytetarë të thjeshtë, çka është dëshmi e atij mobilizimi të gjithanshëm shoqëror

349. AQSh, fondi 203, viti 1944, d. 1365, fl. 4.

350. *Po aty*.

351. *Po aty*, fl. 11.

352. *Po aty*, fl. 16.

353. *Po aty*, fl. 25.

354. *Po aty*, fl. 17.

355. *Po aty*, fl. 19.

356. *Po aty*, fl. 20.

357. *Po aty*, fl. 18.

358. Kastriot Dervishi, *vepër e përmendur*, 497–498.

359. AQSh, fondi 447, Pa vit, d. 281, fl. 3.

që ndodh në situatë lufte. Mbi të gjitha këta janë shembuj të izoluar që nuk shprehin atë frymë që kishte përfshirë shoqërinë shqiptare gjatë kohës së luftës, e cila do të shpalosej në mënyrë të plotë në tre raste. Në të parin kur shqiptarët mjekuan, strehuan, ushqyen dhe ndihmuan ushtarët grekë gjatë luftës italo–greke në vitin 1940, duke mos marrë parasysh krimet që ushtria greke kishte bërë vetëm 26 vjet më parë në Shqipërinë e Jugut. Ky qëndrim do të shfaqej në mënyrë edhe më të fuqishme në vitin 1943, kur pas kapitullimit të Italisë fashiste në 8 shtator të atij viti, shumë ushtarë italianë edhe pse deri në atë moment kishin qenë pushtues, u strehuan nga populli shqiptar duke i shpëtuar masakrimit të sigurtë prej ushtrive naziste gjermane. Rasti i tretë është ai i mbrojtjes së hebregjeve në çastin më të vështirë të historisë së tyre. Atëherë kur reja e errët e Holokaustit kishte mbuluar Evropën, hebregjtë u strehuan dhe u mbrojtën nga shqiptarët pavarësisht rrezikut që rëndonte mbi familjet që bënë një akt të tillë. Shqipëria ishte një nga të paktat vende ku autoriteteve naziste gjermane nuk iu dorëzua asnjë hebre. Këto tre raste humanizmi të skajshëm mund të ndërfiten pa asnjë druajtje në suazat e veprimtarisë filantropike pasi ato janë shembuj të përpjekjeve për ndërtimin e marrëdhënieve miqësore mes kombeve duke kapërcyer paragjykimet dhe tragjeditë historike, në emër të një të ardhmeje më të mirë. Kjo bëhet edhe më e vërtetë po të marrim parasysh rrethanat historike kur ato u kryen.

2.4 Filantropia dhe bamirësia në vitet 1945–1990

Zbatimi i modelit të socializimit real në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore do të kishte pasoja të jashtëzakonshme mbi historinë e vendit. Do të zbatohesh një sistem i ri politik, ekonomik dhe shoqëror që synonte homogjenizimin e shoqërisë dhe shndërrimin e saj në një masë njëngjyreshe. Ky qëllim do të arrihej përmes luftës së klasave që përkthehej në krijimin e shtetit të diktaturës së proletariatit, pra të një shteti njëpartiak, eliminimit të pronës private dhe shtetëzimit të gjithë sektorit ekonomik, puna e të cilit kryhej përmes planifikimit nga qendra dhe ideologjizimit të skajshëm të shoqërisë me qëllim krijimin e njeriut të ri. Pra u ndërtua një sistem politik, ekonomik dhe shoqëror tejet i centralizuar, që mbante nën kontroll dhe drejtonte çdo sektor të jetës, përfshi edhe artin dhe kulturën që u shndërruan në masha të fuqishme propagandistike të regjimit. Ky ishte totalitarizmi i tipit bolshevik dhe stalinist që u zbatua në mënyrë shembullore në Shqipëri.

Në një vend ku mungon prona private, ku sistemi politik është i ngritur mbi parimin se shteti i përket njerëzve pa pronë, që luftojnë të zhdukun

pronën dhe klasën e pronarëve, kuptohet që nuk ngel më asgjë për filantropinë. Etatizmi shqiptar, themelet e të cilit u ngritën nga Ahmet Zogu, u çuan në ekstrem nga udhëheqësi komunist Enver Hoxha. Nëse në kohën e Zogut roli i shtetit në drejtimin e shoqërisë u rrit, në 45 vjeçarën e regjimit stalinist shqiptar ai u bë absolut. Shteti do të mendonte për gjithçka. Sfera publike zgjerohet pafundësisht dhe sfera private rrudhet thuajse deri në zhdukje. Gjithçka që lidhej me këtë të fundit i nënshtrohej kritikës dhe ndëshkimit. Nisur nga parimi se interesat e përgjithshme duheshin vënë mbi ato personale u sanksionua asgjësimi i nismës personale dhe aftësisë së individit për të vepruar si subjekt dhe aktor i pavarur që veprimtarinë e tij përpiquej ta kryente në shërbim të së mirës vetjake dhe asaj të shoqërisë. Kërkimi prej individit i ekuilibrit ndërmjet interesit vetjak dhe atij shoqëror që mbështetet mbi moralin dhe gjendjen e shëndoshë ekonomike, u ndalua nga totalitarizmi stalinist. Këto regjime nuk prireshin drejt gjetjes së këtij ekuilibri. Duke vepruar në mënyrë të njëanëshme dhe duke zhdukur individualizmin dhe ekzaltuar kolektivin ato shkatërruan si bazat ekonomike ashtu edhe vlerat për të kryer këtë lloj veprimtarie.

Për të kuptuar më mirë se si interpretohej mirëbërësia dhe filantropia në Shqipërinë socialiste mjafton t'i hedhim një sy fjalorit të gjuhës shqipe të botuar në vitin 1980 nga Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Ajo që të bën më shumë përshtypje është se autorët e kësaj vepre madhore nuk japin asnjë ndryshim ndërmjet këtyre dy termave. Kështu mirëbërës është ai “që merret gjoja me veprimtari bamirëse gjoja për të ndihmuar njerëzit e varfër, po që në të vërtetë ka për qëllim të ulë zemërimin e tyre dhe të shuajë luftën e klasave (për disa organizata e shoqëri në vendet kapitaliste)”³⁶⁰ ndërsa filantropia është “ndihma materiale që u jepet në vendet borgjeze të varfërve nga të pasurit sa për sy e faqe: mirëbërësi borgjeze që ul e poshtëron dinjitetin e njeriut.”³⁶¹ Nga kjo kuptohet qartë se filantropia shihej nën një prizëm ideologjik që mohonte çdo lloj vlere të saj si veprimtari dhe kritika shkonte deri në mohimin e saj si shfaqje e humanizmit dhe shkallës së qytetërimit.

Në të tilla kushte nuk mund të pritej që në një shtet që kishte marksizëm-leninizmin si ideologji sunduese,³⁶² të kishte në legjislacionin e tij dispozita që të rregullonin kryerjen e veprimtarive filantropike dhe mirëbërëse. Në Kodin Civil të kohës³⁶³ nuk përmendet fare as bamirësia

360. *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Tiranë: Akademia e Shkencave të RPSSH, 1980, 1145.

361. *Po aty*, 470.

362. AQSh, fondi 489, viti 1976, d. 12, fl. 6.

363. *Kodet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*, Tiranë: Byroja Politike pranë Këshillit të Ministrave, 1982, 115–233.

dhe as filantropia. Dhurimi nuk shikohet si një akt që individi bënte për shoqërinë. E njëjta gjë vlente edhe për trashëgimin. Në të vërtetë mjetet që shtetasi shqiptar zotëronte në atë periudhë ishin aq të kufizuara sa që ishte e pamundur që të lije diçka për bamirësi. Prona vetjake, sikurse cilësohej në kushtetutë dhe kodin në fjalë ishte e kufizuar ngushtësisht brenda caqeve të orendive shtëpiake dhe kursimeve prej rrogave shtetërore që nuk ishin të tilla sa të mund të përdroreshin për të tilla qëllime.

Por kjo nuk do të thotë se në Shqipërinë socialiste mbështetja e njerëzve mes njëri-tjetrit dhe përpjekja për zhvillimin e shoqërisë u zhduk si tipar i veprimtarisë shoqërore. Ajo thjesht ndryshoi tërësisht dhe u fut në një format të ri në përputhje me ideologjinë dhe interesat e regjimit komunist. Në Shqipërinë e kohës konceptet bamirësi dhe filantropi do të zëvendësoheshin nga konceptet “vullnetarizëm” dhe “solidaritet”. Po t’i kthehemi edhe një herë fjalorit të gjuhës shqipe të botuar në vitin 1980 këto terma shpjegohen në këtë mënyrë: solidarësi do të thotë “lidhja ndërmjet njerëzve ose grupeve shoqërore që kanë qëllime e interesa të përbashkëta dhe që ndihmojnë njëri-tjetrin, shprehja e përkrahjes për qëllimet dhe veprimet e dikujt me të cilin jemi të një mendjeje,”³⁶⁴dhe vullnetarimi ishte “parim i pjesëmarrjes së njerëzve në një lëvizje, në një organizatë etj. me vullnetin a me dëshirën e vet, pa u detyruar nga dikush tjetër.”³⁶⁵

Por përputhja e këtyre dy termave me praktikën qëndronin larg. Si në të gjitha vendet e socializmit real u zhvilluan punët “vullnetare” për ndërtimin e socializmit. Në të vërtetë ato ishin punë e detyruar, veçanërisht e rinisë, në veprat e mëdha që ndërtonte shteti komunist, të tilla si hapje rrugësh, ndërtim hekurudhash, hapja e brezareve në jug të vendit etj. Kjo ishte një mënyrë e mirë dhe e lirë për të zbatuar projekte të mëdha. Veshja e këtij “vullnetarizmi” me petk ideologjik bëhej në mënyrë të thjeshtë pasi ky ishte një kontribut që jepte shoqëria për pronën e përbashkët dhe gjithashtu zvogëlonte distancën mes punës së mendjes me atë të krahut, që ishte sipas ideologjisë marksiste një tipar i shoqërisë borgjeze. Ndërsa solidariteti shprehej në mbështetjen e ndërsjelltë që shoqëria jepte sidomos në raste katastrofash, ku populli nuk rrinte mospërfillës dhe t’ia linte gjithë barrën shtetit por bëhej njësh me të duke i mëshuar kështu parullës së “unitetit monolit parti–popull.” Solidariteti dhe vullnetarizmi shkriheshin në këto raste pasi vullnetarizimi ishte rrjedhojë e solidaritetit socialist. Raste të tilla të njohura kanë qenë ndihma që ju dha krahinave veriore në vitin 1979 të cilat u goditën nga një tërmet, dëmet e të cilit ishin shumë të

364. *Fjalori...*, 1774.

365. *Po aty*, 219.

mëdha. Drejt Lezhës dhe Shkodrës, zonat më të goditura, u drejtuan me mijëra vullnetarë nga të gjitha anët e Shqipërisë për të ndihmuar në rimëkëmbjen nga dëmet. Raste të ngjashme ka patur edhe në vitin 1967, 1975, 1976 etj. Veçse, pa mohuar prirjen e shqiptarëve për të ndihmuar ndërsjelltazi njëri–njjetrin, ato ishin të organizuara nga shteti, i cili i përdorte këto raste në shërbim të propagandës së vet.



Nënë Tereza

Ndërkohë që veprimtaria filantropike dhe mirëbërëse në Shqipërinë staliniste të Enver Hoxhës ishte asgjësuar plotësisht, si për të kompensuar këtë asfiksion të sforcuar, jashtë kufijve të vendit një shqiptarë do të bënte emër në rrafsh botëror me veprimtarinë e saj filantropike duke u bërë burim frymëzimi për njerëzit në krejt rruzullin. Fjala është për Gonxhe Bojaxhiun e njohur gjerësisht me emrin Nënë Tereza. Ajo me plot

të drejtë është më e madhja filantropike e dalë nga gjiri i shqiptarëve dhe ndër më të mëdhatë filantropike të njerëzimit. Ajo nuk ia kushtoi veprimtarinë e saj krahinës prej nga vinte, bashkombasve të vet apo ndjekësve të besimit që ajo i përkiste. Veprimtarinë e saj ajo ia kushtoi njerëzimit dhe për këtë arsye ajo ngrihet mbi të gjithë shqiptarët e tjerë që janë angazhuar me këtë veprimtari. Ndërsa këta të fundit janë udhëhequr në aksionet e tyre nga nevoja të bashkësive prej nga vinin dhe veprimtarinë e tyre e orientuan ndaj këtyre bashkësive, Nënë Tereza ia kushtoi aksionin e saj filantropik qëllimit të shndërrimit të botës në një vend më të mirë. Qëllimi i saj ishte lufta ndaj plagëve që vuante shoqëria njerëzore, sidomos në vendet e varfra dhe të prapambetura. Veç kësaj, Nënë Tereza në ndryshim nga shumë filantropë të tjerë nuk ishte një sipërmarrëse e suksesshme, e cila përdori pasurinë e saj për të ndjekur një vizion vetjak pavarësisht asaj që mund të jetë ose jo nevojë e shoqërisë. Në të vërtetë ajo nuk u përfshi asnjëherë në asnjë sipërmarrje të ngjashme. Me shembullin e saj ajo u shndërrua në një promotore të një aktiviteti që mobilizoi dhe frymëzoi njerëz në çdo kënd të botës. Pikërisht këtu qëndron madhështia e saj. Nënë Tereza i përket



jo thjesht Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ajo i përket botës. Megjithatë, nismat dhe ndërmarrjet filantropike në qendër të të cilave ajo ishte, e mbajtën të pandërprerë dhe të lidhur fillin e veprimtarisë filantropike ndër shqiptarët, që përshkon shtatë shekujt e fundit të historisë shqiptare. Pa të, si pasojë e politikave staliniste të ndjekura nga regjimi komunist shqiptar, ky fill do të ishte prerë.

Si përfundim duhet theksuar se edhe pse dukuria e mbështetjes mes njerëzve në rast nevojë nuk u zhduk, dukuria filantropike si formë e nismave personale për t'i shërbyer shoqërisë u zhduk krejtësisht. Edhe në rastet e solidaritetit dhe vullnetarizimit, këto nuk ndodhnin në suazat e vendimeve personale por në ato të kolektivave punonjëse. Goditja e individualizmit dhe e pronës, ç'ka do të thotë asfiksimi i lirisë prej stukturave shtetërore, asgjësoi plotësisht veprimtarinë filantropike dhe mirëbërëse për 45 vjet. Filantropia, një dukuri jo fort e spikatur ndër shqiptarët u zhduk më pas nën goditjet e çekiçit komunist. Efektet shoqërore të politikave homogjenizuese, eliminimi i pronës, varfërimi ekstrem i shqiptarëve si pasojë e kolektivizimit dhe etatizmi i skajshëm, e zhveshën “njeriun e ri” nga përgjegjësia shoqërore. Kjo do të dëshmohej në mënyrë të vrazhdë në periudhën post-komuniste. Indiferentizimi ndaj problemeve dhe konflikteve të mëdha shoqërore dhe rëndësia që morën veprimtaritë mirëbërëse brenda një kuadri më të ngushtë shoqëror, dhe vënia në shërbim të çështjeve që nuk lidhen me atë që ka rëndësi kombëtare dhe mbarë shoqërore por me interesa të ngushta, është pasojë e drejtëpërdrejtë e përvojës komuniste. Regjimi stalinist shqiptar edhe pse çoi përpara ngjizjen kombëtare

të shqiptarëve nuk arriti ta përfundonte atë dhe madje në disa raste këputi disa fije të rëndësishme të ndërgjegjes qytetare që e mbanin shoqërinë të lidhur si një të tërën. Aktiviteti filantropik dhe mirëbërës gjatë 20 vjetëve të fundit do të përcaktohej gjerësisht nga 45 vjeçari komunist i vendit. Shfaqja e një antinacionalizmi të dukshëm në radhët e shqiptarëve do të ngjallte lokalizimin dhe identitetet lokale dhe fetare, të cilat do të përcaktonin edhe këtë veprimtari në periudhën që vijoi shëmbjen e regjimit komunist. Rigjallërimi i kësaj dukurie në Shqipërinë postkomuniste dhe tiparet e saj janë objekti i kreut që vijon.

III.FILANTROPIA DHE BAMIREsia PAS VITEVE 1990

Pas 1990, Shqipëria së bashku me vendet e tjera lindore evropiane, me ndryshimin e sistemit pësoi transformimin më të rëndësishëm politik dhe ekonomik drejt një shoqërie demokratike me një treg të hapur, rikthimin e pronës private dhe të konkurrencës së lirë. Reforma të rëndësishme u zbatuan, të tilla si liberalizimi i tregut, privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore në sektorët strategjikë dhe zhvillimi i sektorit privat.

Tranzicioni dhe sfidat social ekonomike të zhvillimit ishin të shumta për t'u përballur në kushtet e një sistemi të ri politik, ekonomie të varfër, dobësimi të institucioneve, mentalitetit të një shoqërie të mbyllur prej 45 vitesh, rritjes së papunësisë etj. Zhvillimi i iniciativës së lirë krijoi kushtet që shumë iniciativa private të lulëzonin, duke ndikuar në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e shoqërisë e vendit në përgjithësi.

Krijimi i organizatave jofitimprurëse dhe zhvillimi i sektorit të shoqërisë civile, ishte një tjetër faktor përcaktues dhe me kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik e shoqëror.

Të gjitha këto zhvillime krijuan kushtet për ringjalljen e veprimtarisë bamirëse dhe filantropike.

Studimi nuk është thelluar në analizimin e zhvillimit të filantropisë dhe bamirësisë në periudhën pas viteve 1990, duke qenë se kjo nuk ishte pjesë e qëllimit të këtij studimi. Periudha relativisht e afërt me kohën e kryerjes së këtij studimi, veprimtaria e vogël filantropike gjatë këtyre 20 viteve si dhe mungesa e dokumentimit të kësaj veprimtarie si nga ana e individit ashtu dhe nga ana e shtetit, kërkon një lloj tjetër përqasje studimore.

Partnerët Shqipëri duke e vlerësuar si shumë të rëndësishme analizën e veprimtarisë filantropike gjatë kësaj periudhe kohore, ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë studime më të thelluara në këtë fushë.

Partnerët Shqipëri si pjesë e punës së saj kërkimore në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të filantropisë në Shqipëri, zhvilloi më herët në pranverën e vitit 2011 një studim në lidhje me sipërmarrjet dhe angazhimin e tyre në veprimtari filantropike³⁶⁶ Si pjesë e studimit në të cilin u përfshinë 140 biznese në të gjithë vendin, Partnerët Shqipëri identifikoi një përqindje relativisht të lartë të aktivitetit filantropik, kryer

366. "Sipërmarrja dhe filantropia", Raporti i Studimit; www.partnersalbania.org

nga sipërmarrjet e llojeve e sektorëve të ndryshëm si ai financiar, sektori i ndërtimit, i transportit dhe telekomunikacionit, industria nxjerrëse e përpunuese, e hoteleri-turizmi.

Partnerët Shqipëri gjykon se identifikimi i rasteve të aktivitetit filantropik të sipërmarrjeve dhe sjellja e tyre në një formë më të shtjelluar, do të ndihmonte në njohjen e aktivitetit filantropik dhe kontributit që sektori i biznesit jep në ndihmë të zhvillimit të komuniteteve lokale si dhe ndërgjegjësimin e mbarë shoqërisë dhe institucioneve e aktorëve për rëndësinë që ky aktivitet ka. Në vijim janë paraqitur disa nga rastet e identifikuar dhe investiguara më tej me kompanitë përkatëse dhe përfituesit nga dhurimet e mbështetja e tyre. Këto raste synojnë të ilustrojnë veprimtarinë filantropike nga ana e bizneseve të madhësive, industrive, si dhe llojeve të ndryshme të kontributeve në zhvillimin ekonomik - shoqëror. Ato përbëjnë vetëm një pjesë të praktikave të identifikuar nga PSh dhe që kanë marrë aprovimin e kompanive respektive për të qenë pjesë e këtij publikimi. Rastet janë një vlerë e shtuar e këtij studimi duke u bërë pjesë e analizës historike të kësaj veprimtarie dhe evoluimit të saj në periudha të ndryshme historike. Ky studim tregon qartë se veprimtaria filantropike në shekullin e XXI është vazhdim i një veprimtarie shoqërore shumë më të hershme ndonëse në përmasa dhe në një kontekst tjetër politiko- shoqëror.

3.1 Praktika nga aktiviteti filantropik i disa kompanive në Shqipëri

General Polymeren Recycling Albania (GPR Shqipëri), me vendndodhje në fshatin Gjoçaj pranë Vorës, Tiranë, është një kompani e fokusuar në fushën e riciklimit të mbeturinave.

Aktiviteti filantropik i sipërmarrjes daton që prej krijimit të saj, përkatësisht në vitin 2009. Gjatë këtyre tre viteve, GPRSh ka mbështetur vazhdimisht shkollat 9-vjeçare në iniciativat për të mbajtur pastër mjedisin, duke i njohur nxënësit me materialet e riciklueshme. Çdo vit janë mundësuar udhëtime të nxënësve për në fabrikën e GPRSh, jo vetëm për të vëzhguar dhe për t'u prezantuar me mënyrën sesi funksionon një fabrikë riciklimi, por edhe për të nxitur fëmijët në qëndrime dhe sjellje pozitive ndaj mjedisit. Për shkollat të cilat mbledhnin materialet e riciklueshme dhe i dërgonin në fabrikën e GPRSh, kjo e fundit ka kontribuar me investime për rregullimin e mjedisve të tyre.

Një tjetër kontribut i GPR Shqipëri është punësimi i banorëve të fshatit Gjoçaj. Fabrika është e vendosur në këtë fshat dhe duke synuar bashkëpunim e ndërveprim, si dhe duke dashur që të ketë një marrëdhënie të mirë e të qëndrueshme me banorët e komunitetit ka punësuar pjesën më të madhe të banorëve të këtij fshati. Duke bashkëbiseduar me një përfaqësi të grave që punojnë në fabrikë, punësimi i banorëve të zonës nga fabrika ka qenë shumë pozitiv për këto familje. Veçanërisht, është e rëndësishme të merret në konsideratë fakti që tashmë të gjitha gratë janë punësuar pranë fabrikës duke shënuar një hap përpara në zhvillimin social-ekonomik të zonës. Gjithashtu, çdo fundviti sipas punonjësve, është kthyer në traditë organizimi nga ana e kompanisë i festave me fëmijët e fshatit dhe komunitetin rom, ku shpërndahen dhurata për fëmijët dhe festohet në komunitet.

Helvetika Profarma me qendër në qytetin e Tiranës është e fokusuar në fushën e prodhimit të produkteve farmaceutike, kryesisht për fëmijë. Kontributi i kompanisë në zhvillimin e aktiviteteve filantropike, kryesisht në fushën e shëndetit të fëmijëve, ka filluar që prej vitit 2004.

Përgjatë këtyre viteve, firma ka zhvilluar aktivitete të ndryshme filantropike në mënyrë të qëndrueshme. Ka mbështetur një numër të konsiderueshëm organizatash si Fondacioni "Fëmijët Shqiptarë", Shoqata "Unë Gruaja" dhe Fondacioni "Shpresa për Botën" në aktivitetin e tyre në shërbim të grupeve në nevojë, si dhe institucione të tjera në raste të katastrofave natyre si p.sh. përmbytja në Shkodër gjatë vitit 2010, ku kompania i erdhi në ndihmë spitalit rajonal Shkodër me produkte. Mbështetja e ofruar nga Helvetika Profarma ka qenë në forma

të ndryshme nga ofrimi i produkteve bio për fëmijë, e deri në kontribut të vazhdueshëm financiar, në shifra nga 5000 deri në 6000 Euro. Për kompaninë, shtysa kryesore për të kryer aktivitete filantropike ka qenë mbështetja ndaj njerëzve dhe grupeve në nevojë. Për të, roli i shtetit në lehtësimin e taksave dhe rritjen e incentivave, si dhe promovimi nëpërmjet medias do të ndikonin në rritjen e aktivitetit filantropik edhe nga sipërmarrje të tjera në Shqipëri, duke zgjeruar rrethin e personave dhe grupeve që do të mbështeteshin.

Shtypshkronja Pegi është një tjetër sipërmarrje, në fushën e industrisë përpunuese, që zhvillon aktivitetin e saj filantropik prej disa vitesh.

Mbështetja e dhënë në disa raste ka qenë sporadike e në disa të tjera e qëndrueshme. Ndër të parat përmendim rastin e katastrofave natyrore, si përmytjet në Shkodër, ku kompania ka kontribuar me libra si dhe mbështetje financiare. Si shembull të rasteve të mbështetjes së vazhdueshme përmendim kontributin për Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli” kryesisht me libra artistike për fëmijë dhe mbështetjen dhënë “Shoqatës së të verbërve” me libra të përshtatur në gjuhën brail.

Shtysa për të kryer aktivitete filantropike lidhet me vizionin dhe dëshirën e mirë të kompanisë për të kontribuar për grupet në nevojë. Ata janë të bindur që do të vazhdojnë edhe në të ardhmen të mbështesin shoqatat dhe institucionet e sipërpërmendura.

Z. Asllan Sula, president i firmës Santara sh.p.k. është një biznesmen në fushën e ndërtimit, i cili kryen aktivitet filantropik që prej vitit 1993. Gjatë kësaj periudhe ai ka mbështetur shumë aktivitete kulturore – artistike si dhe ka kryer vepra mirëbërësie për individë në nevojë. Z. Sula ka sponsorizuar koncerte për Grupin Folklorik të Krujës, ka mbështetur Klubin Sportiv të Krujës, ka ndihmuar në ndërtimin e shtëpive për të pastrehët, ka ndërtuar Myftininë e Krujës, ka shtruar rrugë për komunitetet aty ku ka patur nevojë, ka ndihmuar persona paraplegjikë dhe tetraplegjikë duke ofruar ndihmë financiare etj.

Ndjenja e thellë e besimit që e karakterizon dhe ndjeshmëria ndaj problemeve dhe nevojave të komunitetit përbëjnë shtysën më të madhe në ndërmarrjen e aktiviteti filantropik nga Z. Sula. Ndihma që ai ka dhënë për këto komunitete ka qenë dhe vazhdon të jetë e qëndrueshme dhe e larmishme.

Sheraton Hotel Albania ka kryer aktivitete filantropike që prej fillimit të aktivitetit së tij në Shqipëri. Kryesisht këto aktivitete filantropike kanë qenë në mbështetje të organizatave të cilat synojnë të përmirësojnë cilësinë e jetës së grupeve të ndryshme shoqërore. Ndër organizatat që ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë janë Kryqi i Kuq Shqiptar

dhe UNICEF-i. Me Kryqin e Kuq Shqiptar kontributi ka qenë në formën e bazës materiale dhe ushqimore për fëmijët dhe moshën e tretë. Sa i përket UNICEF-it, kompania ka kontribuar përmes mbështetjes së iniciativës “Shqipëria lexon” për 2 vite me rradhë, me një shumë prej rreth 100.000 Euro.

Shtysa për të kontribuar ka qenë dëshira për t’u ardhur në ndihmë grupeve të ndryshme në vështirësi dhe zhvillimin e shoqërisë në tërësi. Sa i përket formës së mbështetjes, një pikë e fortë për kompaninë ka qenë bashkëpunimi me aktorë të tjerë të shoqërisë. Pranë mjediseve të saj kompania zhvillon ankande dhe bankete, ku ftohen personalitete nga fusha të ndryshme. Të ardhurat nga këto aktivitete shkojnë për organizatat të cilat kompania mbështet. Një mënyrë tjetër për të vjelur kontribute nga persona e grupe të organizuara, vizitorë të hotelit, është edhe vendosja në ambjentet e hotelit, e një kutie për ndihma ku secili mund të kontribuojë me një shumë simbolike. Për të rritur edhe më tepër aktivitetet filantropike kompania rekomandon bërjen e transparencë nga ana e organizatave të cilat punojnë për zhvillimin e komuniteteve dhe kërkojnë bashkëpunimin e biznesit në kryerjen e aktivitetit të tyre, si dhe më tepër ndërgjegjësim në shoqëri rreth filantropisë.

Fix – Pro Company është një kompani e cila merret me përpunimin e produkteve të mishit në qytetin e Korçës. Aktivitetet filantropike kjo kompani i ka zhvilluar prej vitit 2005 e në vazhdim. Çdo vit ajo mbështet shoqatën “Dorcas”, një organizatë humanitare e cila punon në shërbim të grupeve në nevojë të qytetit të Korçës. Gjithashtu, prej vitesh kompania jep ndihma financiare për 5 fëmijë të kopshtit të Kishës, për fëmijët e policëve të vvarë dhe gjithashtu siguron jetesën e një të moshuare në fshatin Boboshticë përmes një pensioni mujor, në kushtet e një gjëndjeje të vështirë ekonomike dhe mungesës së të afërmeve të saj.

Përgjithësisht, forma e mbështetjes që jep kompania është kontribut financiar. Shtysa për të zhvilluar aktivitete filantropike nuk është promovimi i biznesit, por ndjenja e humanizmit dhe respekti ndaj njerëzve, si dhe ndjesia e përftuar nga dhënia e ndihmës, e të qenurit i dobishëm për shoqërinë.

Duke qenë se ka një eksperiencë gjashtë vjeçare në zhvillimin e këtyre aktiviteteve, komuniteti i është shumë mirënjohës. Kompania synon që në të ardhmen të kontribuojë edhe në përfshirjen e të tjera bizneseve në aktivitete të tilla.

Çelësi Media Group i vendosur në Tiranë, është një tjetër kompani që zhvillon aktivitete filantropike.

Grupi ka ngritur qendrën “Akademia Kult” përmes së cilës organizon mbi baza vjetore, konkurimin dhe ndarjen e çmimeve për artistë të fushave të ndryshme. Aktiviteti i qendrës është fokusuar në fushën e artit dhe të kulturës. Ka rreth 7 vjet që Grupi kryen aktivitet filantropik me një kontribut financiar prej afro 2–3 milion lekë, megjithëse sipas përfaqësuesve të tij, në një kontekst mjaft të vështirë shoqëror. Shtysa për të zhvilluar një aktivitet filantropik është personale, e drejtuesve të kompanisë, si dhe e lidhur me misionin e Grupit. Ajo që kompania synon në të ardhmen është jo vetëm të vazhdojë punën që ka zhvilluar gjatë këtyre shtatë viteve, por që edhe aktorë të tjerë të biznesit dhe organizatave t’i bashkohen në të ardhmen, pasi për artin dhe kulturën ende bëhet shumë pak.

Shaga sh.p.k është një kompani e fushës së industrisë përpunuese e lokalizuar në Tiranë. Aktiviteti i saj filantropik daton prej vitit 2009. Gjatë kësaj periudhe tre vjeçare ndihma e dhënë ka qenë kryesisht përmes mbështetjes në materiale, por edhe mbështetja financiare nuk ka munguar. Organizatat dhe institucionet e mbështetura kanë qenë disa, mes të cilave Shoqata e Policëve të Vrarë dhe Shtëpia e fëmijës “Zyber Hallulli”. Drejtuesit e kompanisë besojnë që është në moral të shoqërisë që të ndihmojë njerëzit në nevojë. Kjo përbën edhe shtysën për të kryer veprimtari filantropike. Kompania beson se do të vazhdojë të mbështesë grupet në nevojë, por një ndër rekomandimet për të pasur larmishmëri të aktiviteteve filantropike sipas saj, do të ishte edhe përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues duke ofruar më shumë lehtësira për biznesin.

Kompania **Vodafone Albania**, në kuadër të përgjegjshmërisë sociale të biznesit, themeloi në vitin 2007 Fondacionin Vodafone Albania. Kjo risi për komunitetin e biznesit në Shqipëri siguron një investim social të konsiderueshëm dhe të qëndrueshëm për komunitetin.

Fondi vjetor i kontributit të Fondacionit është minimalisht gjysëm milion euro. Fondacioni shpall çdo vit tre raunde aplikimesh për projekte, prej të cilave janë mbështetur deri më tani 73 organizata jofitimprurëse dhe 21 fitues të programit “Bota e Ndryshimit”. Harta e zbatimit të projekteve shtrihet anëmbanë Shqipërisë, si në zonat urbane ashtu edhe rurale. Financimet u janë dedikuar grupeve të ndryshme në nevojë duke përfshirë fëmijë talasemikë dhe jetimë, të pastrehë, pacientë me sëmundje terminale, ish-viktima të trafikut njerëzor, të moshuar të vetmuar, nëna shtatzëna në risk të abandonimit të foshnjës, vuajtës të dënimit në burgje, komuniteti rom dhe ai në nevojë në zona të thella

vendit, si dhe nismave mjedisore e të tjera. Një vëmendje të vecantë në strategjinë dhe programet e Fondacionit i kushtohet personave me aftësi të kufizuar, përmes mbështetjesh me një sërë projektesh si prodhim i karrikeve me rrota, program punësimi i personave me aftësi të kufizuar, krijim i laboratorëve dhe përdorim i programeve të përshtatura për personat e verbër, programe të vecanta edukative për kategori të caktuara, organizimi i Lojrave Speciale Olimprike në vitet e fundit si dhe shumë nisma të tjera.

Raiffeisen Bank SHA në vijim të politikës së saj të sponsorizimeve është fokusuar kryesisht në fushën e arsimit dhe atë sociale në mbështetje të fëmijëve e studentëve, si dhe në fushën e mjedisit për përmirësimin e tij në qytete e zona të ndryshme të vendit.

Raiffeisen Bank ka shpenzuar më shumë se gjysëm milionë euro në projekte sociale duke treguar angazhimin e saj në përmirësimin e jetës së komunitetit. Banka përmes projekteve të përbashkëta me disa bashki në vend, ka kontribuar në rindërtimin dhe pajisjen me libra të bibliotekave të shkollave dhe rikonstruksionin e oborreve të disa shkollave në Tiranë, Elbasan, Berat, Shkodër, Korçë, Durrës, etj. Të tjera nisma ndër vite të mbështetura nga Raiffeisen Bank kanë qenë mbështetje prej 5 vitesh e Konferencës së Studentëve dhe Loja në Bursë, Kampionati Kombëtar i Basketbollit me pjesëmarrjen e 1.500 fëmijëve në të gjithë Shqipërinë, pajisja me kompjutera e kabinetit të Financë-Kontabilitetit të Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, rikonstruksioni i sallës së koncerteve të shkollës artistike “Prenkë Jakova” Shkodër, përkrahja e nismës së Bashkisë së Tiranës “Një-Qytetar-Një Pemë” për dy vite me radhë, projekte të tjera të mbjelljes së pemëve në qytetet e Beratit, Krujës, Lushnjës, etj, si dhe projekte të tjera mjedisore për pastrimin e zonave bregdetare të vendit. Vecori e aktivitetit të Kompanisë është përfshirja në një shkallë të gjerë e stafit në disa aktivitete si pastrimi i bregdetit të Vlorës, Durrësit, Divjakës dhe Shëngjinit.

Raiffeisen Bank në Shqipëri ka dhënë kontribut të madh edhe në raste të katastrofave natyrore. Vlen për t’u cilësuar një shumë prej 100 mijë Euro, kontribut për zonat e veriut të prekura nga përmytjet. Dhurime të tjera po për këtë kauzë janë bërë edhe nga stafi i kompanisë.

AQSH, Ministria e Oborrit Mbretëror, fondi 150, viti 1938, dosja V-58

Promemorie e Drejtorisë së Përgjithshme të Kryqit të Kuq Shqiptar drejtuar Ministrisë së Oborrit Mbretëror mbi gjendjen dhe masat e marra për zhvillimin dhe aktivitetin e Kryqit të Kuq.

(Në parashtrimin e të ardhurave të KK jepen pronat e tij të patundshme ndër të cilat janë këto që vijojnë, ku përmenden edhe dhuruesit)

- a) Ullinj të e Strehës prej 638 rrënjësh qi gjenden në katundin Kryesi-Përclesh të Tiranës, të dhuruem prej të ndyerit Hasan Vogli...
- b) Çifliku Rreth, i dhuruem Kryqit të Kuq prej Nalt-Madhnisë së Tij Mbretit bashkë me stacionin Zooteknik Xhafzotaj qi përbëhet prej një 600 hektarësh e qi nga këto 200 hektarë i ka zanë stacioni në fjalë dhe pjesa tjetër prej bujqve vendas qi nuk janë përgjithësisht në gjindje të mirë ekonomike...
- c) Pylli Pishë i Divjakës, i dhuruem Kryqit të Kuq po prej Nalt-Madhnisë së Tij Mbretit, ka një sipërfaqe prej 15 kilometrë gjatësie e 1.5 kilometrë gjanësije, i shtrinum në busë-detin Adriatik...
- c) Pasunija e Sarandës, një dhuratë tjetër kjo e vlefshme e Nalt-Madhnisë së Tij Mbretit qi ja cedoj Kryqit të Kuq me 24 mars 1937.

AQSH, Ministria e Punëve të Jashtme, fondi 151, viti 1923, dosja 54

Në një letër qi muarmë nga Legata jonë në Athinë na thuhet se i quajhuri Konstantin Kena (nga Lavidhi) Luidhi nga Përmeti, vdekur ka moti 1913 në Matai (Egypt), ka lanë nji zet-mij lira egjipziane monedhe per shkollat të Përmetit.

Si kujdestar për prishjen e këtyre të hollavet i sipërpërmenduri paska lënë qeverinë Greke me një epitropi në Përmet.

Ju lutemi të bëni hetimet e duhura mbi këtë çashtje dhe të na njoftoni përfundimin.

Mbas informative qi kemi dhe shum shqiptar të tjere paskan lanë të holla në favor të shkollavet në Shqipëri; mir po këto të holla u mblidhkan të depozituara në Bankat e Greqisë.

Do ishte e interesyeshme të përgatitesh nji listë ku bashkë me emrat e të tillë bamirësve të shënoheshin edhe shumat e këtyre trashëgimeve me të gjitha hollsisrat e duhura.

Ministri i Punëve të Jashtme

(Informacion i Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, datë 18/08/1923)

Në vijim të shkresës së këtushme Nr. 12488 më 26/06/1923 kemi nderin t'ju paraqesim bashkangjitur kopjen e testamentit të Konstantin Zhapës nga Labova si dhe një kopje të mirëbërsve t'jerë na Gjinokastra

të përcjelluna në letren Nr. 3509/18 më 6/8/1923 të prefekturës së Gjinokastrës e cila gjith n'atë shkresë thotë edhe se për veç këtyre është informue se jan lan prej:

Vangjel Zhape nga Labova 1.200 dhrami
Qirjako Llapës nga Dhrovjani 10.000 dhrami
Theodor Tatari nga Dhrovjani 570 dhrami
Spiro Xhaferi nga Dhrovjani 1000 dhrami
Dhospina Zisos Cuni nga Dhrovjani 440 dhrami
Petro Prackes nga Dhrovjani 30.000 dhrami
Dhimitri Elimit nga Livina 8.500 dhrami

Nga të cilët përveç dyve të fundit (se të 20.000 dhramit janë lënë Element në Kat. Dhrovjan dhe të 8.500 jan lën për shkollat e Livinës) shumat e tjera jan lënë për shkollat e katundit Dhrovjan dhe janë të depozitueme në Bankën Kombëtare të Greqisë, prej të cilave vetëm interesin kan të drejtë të heqin shkollat dhe elementi ne fjalë dhe jo kapitalin, me përjashtim të shumës së Vangjel Zhapës, q'i dërgohet shkollave të Dhrovjanit të Sipërm e të Poshtëm, çdo mot prej Komisionit "Zhapios" me qendër n'Athinë.

Ngjithës po ju paraqesim dhe një listë të mirëbërsve të Korcës e cila përmban shumat e depozueme në bankën nacionale të Greqisë.

Prefektura e Korcës me shkruen se testamentet e tyre ndodhen në Mitropolinë e atjeshme por se jan të shkruem në gjuhën greqishte...

Ministri i Brendshëm Rauf Fico.

AQSH, Kryeministria, fondi 149, viti 1936, dosja V-217.

Ministria e Punëve të Brendshme i dërgon Kryeministrisë mendimin mbi vobegësinë, 8/5/1936

Kjo Ministrie ka konstatue se vobegësia në Shqipni ekziston në një shkallë të gjanë dhe lypsia sidomos asht përhapë tepër.

Për fat të keq në vendin t'onë jo vetëm mungojnë gado krejt Institutet e bamirsis, por c'ka asht ma keq edhe ndjenja e bamirsis në shkallën e duhun mungon në vendin t'onë. Ndoshta nder lypsa gjenden edhe asi parasitësh që për përtacësi e kan ba ves lypsin, por në shumicë pleqët, plakat, sakatët, qorrat, grat'e veja me femij te vegjël etj. i shtyn nevoja e madhe.

Prandaj me qëllim që të gjendej posibiliteti i krijimit të një Instituti Bamirës siç kishte me qenë ngrehja e një azili pleqësh, plakash, sakatësh e të verbrish, Ministri formoj një komision që të studjonte mundësinë e krijimit të fondeve të duhuna për këtë qëllim, i cili elaboroj raportin që këtu bashkangjesim.

I kujtojmë asajë P.T. Kryeministrije se, edhe Vetë N.M. Tij Mbreti asht denjue t'interesohej për një qëllim të tillë me urdhrin Mbretnuer Nr. 374 datë 5.8.1935 drejtue asajë P.T. Kryeministrije...

a. Burime të para**a.1. Burime Arkivore**

Arkivi Qëndror i Shtetit (AQSh):

- Fondi: Shoqëri Shqiptare në Egjipt, nr. 97.
- Fondi: Arqipeshkvia e Shkodrës, nr. 132.
- Fondi: Urdhri Françeskan, nr. 133.
- Fondi: Urdhri Jezuit, nr. 134.
- Fondi: Mitropolia e Korçës, nr. 141.
- Fondi: Kryesia e Këshillit të Ministrave, nr. 149.
- Fondi: Ministria e Oborrit Mbretëror, nr. 150.
- Fondi: Ministria e Punëve të Jashtme, nr. 151.
- Fondi: Ministria e Punëve të Brendshme, nr. 152.
- Fondi: Ministria e Drejtësisë, nr. 155.
- Fondi: Mëkëmbësia e Përgjithshme, nr. 161.
- Fondi: Legata Italiane, nr. 163.
- Fondi: Ministria e Arsimit, nr. 195.
- Fondi: Drejtoria e Përgjithshme e Shëndetësisë, nr. 202.
- Fondi: Kryqi i Kuq Shqiptar, nr. 203.
- Fondi: Milicia Fashiste, nr. 214.
- Fondi: Prefektura e Elbasanit, nr. 217.
- Fondi: Prefektura e Korçës, nr. 317.
- Fondi: Firma Tregtare Idhomene Kosturi, nr. 424.
- Fondi: Koleksioni i Partive, Organizatave dhe Shoqërive, nr. 447.
- Fondi: Komuniteti Mysliman, nr. 482.
- Fondi: Komuniteti Bektashi, nr. 483.
- Fondi: Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar, nr. 489.
- Fondi: Këshilli i Ministrave, nr. 490.

a.2. Dokumenta të Botuara

- *Fletorja Zyrtare*, 1922–1939.
- *Kodet e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*. Tiranë: Byroja Politike pranë Këshillit të Ministrave, 1982.
- *Ligje, Dekret–Ligje e Rregullore e vjetit* 1928, vëll. 5. Tiranë: Botimet e Këshillit të Shtetit, 1939.
- *Ligje, Dekret–Ligje e Rregullore e vjetit* 1928, vëll. 5bis. Tiranë: Botimet e Këshillit të Shtetit, 1940.
- *Ligje, Dekret–Ligje e Rregullore e vjetit* 1929, vëll. 6. Tiranë: Botimet e Këshillit të Shtetit, 1940.

- *Ligje, Dekret–Ligje e Rregullore*, vëll. 8. Tiranë: Këshilli i Lartë, 1942.
- Pela, Mihallaq, dhe Pepo, Petraq. *Kanunorë të shoqërive shqiptare [1870–1936]*, vëll. I. Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 2007.
- Pepo, Petraq. *Materiale Dokumentare për Shqipërinë Juglindore të Shekullit XVIII–Fillimi i Shekullit XX (Kodiku i Korës dhe Selasforit)*, vëll. I & 2, Tiranë: Akademia e Shkencave të RPSSH, 1981.
- *Shoqëritë patriotike shqiptare jashtë atdheut për arsimin dhe kulturën kombëtare [1879 – 1912]*. Tiranë: 8 Nëntori, 1987.
- Zamputi, Injac. *Regjistri i Kadastrës dhe i konçesioneve për rrethin e Shkodrës 1416–1417*. Tiranë: Akademia e Shkencave të RPSSH, 1977.

b. Burime të Dyta

b.1. Organe të Shtypit të Shkruar

Dielli, Jet e re, Koha, Mbleta, Posta e Korçës, Shqipëri’ e re, Shqipëtari i Amerikës, Zëri i Popullit

b.2. Libra, Monografi dhe artikuj

1. Abazi, Abdul. “*Fushata e çamëve*”. *Dielli*, nr. 2683, 1 mars 1924.
2. Baze, Ermal. *Qyteti i Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV*. Disertacion për gradën Doktor, Universiteti i Tiranës, 2010.
3. Colton, Joel, dhe Palmer, Robert Roswell. *A History of the modern World*, New York: Alfred A. Knopf, 1983.
4. Clayer, Nathalie. *Në fillimiet e nacionalizmit shqiptar. Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*. Tiranë: Përpjekja, 2009.
5. Çabej, Eqrem. *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit*. Tiranë: Çabej, 1994.
6. Demi, Idriz, dhe Sejko, Hysni. “Mbledhja e shoqërisë “Çamëria”. *Dielli*, nr. 2675, 9 shkurt 1924.
7. Dervishi, Kastriot. *Historia e Shtetit Shqiptar 1912–2005*. Tiranë: 55, 2006.
8. Falli, Helidhona. “Drejtorit gazetës ‘Shqipëtari i Amerikës’ Këtu”. *Shqipëtari i Amerikës*, nr. 33, 2 qershor 1923.
9. Falli, Helidhona. “Lajmërim”. *Shqipëtari i Amerikës*, nr. 42, 11 gusht 1923.
10. Duka, Valentina. *Histori e Shqipërisë 1912–2000*. Tiranë: Kristalina–KH, 2008.
11. Duka, Valentina. “Lëvizja kombëtare në gjirin e diasporës shqiptare”. *Çështje të historisë bashkohore të shqiptarëve*, botuar nga Duka Valentina, Tiranë: ShBLU, 2008.
12. Duka, Valentina. “Rrethanat që çuan në themelimin e ‘Vatrës’”. *Çështje të historisë bashkohore të shqiptarëve*, botuar nga Duka Valentina, Tiranë: ShBLU, 2008.
13. *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave të RPSSH, 1980.

14. Goga, Iljaz. *Mirëbërës shqiptarë të arsimit*. Tiranë: Albin, 2003.
15. Guxhamana, Kristo. "Mbledhja e Shoqërisë 'Vëllazëria Mirëbërëse' në Berat". *Shqipëtar i Amerikës*, nr. 20, 3 mars 1923.
16. Gjerasi, Pirro. *Jetimoret e Shqipërisë*. Tiranë: FLESH, 1999.
17. Hila, Qirjako. *Vangjel Zhapa*. Tiranë: Iliria, 2003.
18. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë: Toena, 2002.
19. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Tiranë: Toena, 2005.
20. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Tiranë: Toena, 2009.
21. Hobsbawm, Eric. *The age of revolution*. New York: Vintage Books, 1996.
22. Hobsbawm, Eric, dhe Ranger, Terence. *The invention of tradition*. New York: Cambridge University Press, 2010.
23. Hoxha, Artan R. "Kontributi i historisë gojore mbi çështjen e mbrojtjes së hebrenjë në Shqipëri gjatë Holokaustit". *Studime Universitare*, 2009 : 24.
24. Hoxha, Artan R. "The Power of Knowledge: State, Religion and Education in the Process of Nation-Building in Albania Between the Two World Wars". Kumtesë e mbajtur në konferencën "Charting the Nation Between State and Society", University of Columbia, New York, 14–17 prill 2011.
25. Jelavich, Charles & Barbara. *Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit 1804–1920*. Tiranë: Dituria, 2004.
26. Kagan, Donald, dhe Ozment, Steven, dhe Turner, Frank M. *The Western Heritage*, vëll. II, New Jersey: Prentice Hall, 1998.
27. Plasari, Aurel. *Fenomeni Voskopjë*. Tiranë: Phoenix & ShLK, 2000.
28. Pulaha, Selami. "Qytetet shqiptare nën regjimin feudal ushtarak osman gjatë shekujve XV–XVI". *Monumentet* nr. 1, 1984.
29. Puto, Arben. *Shqipëria Politike 1912–1939*. Tiranë: Toena, 2009.
30. Thëngjilli, Petrika. *Historia e Popullit Shqiptar 395–1875*. Tiranë: ShBLU, 1999.
31. Skëndi, Stavro. *Zgjimi kombëtar shqiptar*. Tiranë: Phoenix & ShLK, 2000.
32. Stavrianos, Leften S. "The influence of the West on the Balkans". në *The Balkans in Transition*, botuar nga Charles and Barbara Jelavich. Los Angeles: University of California Press, 1963.
33. Shkodra, Zija. *Esnafet shqiptarë*. Tiranë: Akademia e RPSSH, 1973.
34. Shkodra, Zija. *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*. Tiranë: Akademia e RPSSH, 1984.

**Partnerët Shqipëri,
Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti**

Rruga: "Muhamet Gjollesha",
Pall. 16/1, Hyrja 1, Ap.9, Tiranë
Kutia Postare 2418/1

Tel: +355 4 2254881

Faks: +355 4 2254883

E-mail: partners@partnersalbania.org

Website: www.partnersalbania.org

ISBN 978-9928-4025-7-8



9 789928 402578